



Buletini i Austria Praemix

Kategoria: Gjedhë

Përmbajtja:

1.KETOZA SUBKLINIKE.....	2
2.MËNYRA E TË USHQYERIT, KONTROLLI I PARAMETRAVE TË METABOLIZMIT DHE TRAJTIMI I VIÇAVE TË SAPOLINDUR ME DIARRE	5
3. SËMUNDJA MORTELLARO = DERMATITISDIGITALIS (DD)	8
4.GRIPI I GJEDHIT PARANDALIMI ME VAKSINA	10
5.RËNDËSIA E FURNIZIMIT ME UJË TE GJEDHI	12
6.MBARËSHTIMI I VIÇAVE.....	14
7.VIÇAT E SHËNDETSHËM KËRKOJNË MENAXHIM TË MIRË	17
8.OBJEKTIVAT NË RRITJEN E VIÇAVE	19
9.MASTITI -NJË SËMUNDJE MULTIFAKTORIALE	21
10.PARANDALIMI I SËMUNDJEVE TE VIÇAT FILLON QË ME DHËNIEN E KULLOSHTRËS	25
11.TRETJA NË RUMEN TE RIPËRTYPËSIT	26
12.MORTELLARO TREGUES I QUMËSHTIT	29
13.VIÇA TË PËRGATITUR MIRË PËRSTINËN EFTOHTË TË DIMRIT	31
14.MUNGESA E SELENIT	32
15.MBARËSHTIMI I VIÇAVE.....	33
16.TË PISH ME FAZA TË SHKURTRA	36
17.DIARREJA E VIÇIT MUND TË PREKË TËGJITHË TUFËN.....	38
18.SHMANGNI STRESIN NGA TEMPERATURAT E LARTAGJATË TRANSPORTIT TË KAFSHËVE	40
19.SI MUND TË NDIHMOJË MAJAJA ME STRESIN NGA TEMPERATURAT E LARTA?	41
20.STRATEGJITË MË TË MIRA KUNDËR STRESIT NGA TEMPERATURAT E LARTA.....	42
21.TEMPERATURAT E LARTA STRES PËR LOPËT E QUMËSHTIT.....	44
22.STRESI NGA NXEHTËSIA TE LOPËT E QUMËSHTIT	46
23.KONCEPTI MBIUSHQIMIN OPTIMAL PËR VIÇAT.....	47
24.OPTIMIZIMI I USHQIMIT	49
25.RRITJA E VIÇAVE	51
26.HEQJA E BRIRËVE TE VIÇAT.....	53
27.PLANI I PIRJES TE VIÇAT E QUMËSHTIT DERI NË SHKËPUTJE.....	55
28.KULLOSHTRA PËR VIÇA TË SHËNDETSHËM.....	56
29.CILËSIA E KULLOSHTRËS ËSHTË VENDIMTARE	57
30.KËSHTU PËRFITOHET NGA RRITJA E VIÇAVE TË VEGJËL.....	59
31.PËRPUNIMI I QUMËSHTIT NË FERMË	61
32.VIÇA TË PËRGATITUR MIRË PËR STINËN E FTOHTË TË DIMRIT	63
33.EVITIMI I HUMBJEVE TË VIÇAVE	65
34.AD LIBITUM PËR VIÇA TË SHËNDETSHËM	68
35.SËMUNDJET QË SHKAKTOJNË HUMBJE TË VIÇAVE - PARANDALIMI DHE KONTROLLI.....	70

1. KETOZA SUBKLINIKE

NË VËMENDJE TË VETERINERËVE DHE MBARËSHTUESVE TË GJEDHIT!

Nevojat energjike të një lope pas pjelljes dyfishohen brenda vetëm pak ditësh. Në të njëjtën kohë lopa nuk është ende në gjendje të marrë sasinë e mjaftueshme të ushqimit. Bilanci energjitik gjatë kësaj kohe është negativ.



Si pasojë, e vetmja mundësi që ka lopa për t'a plotësuar mungesën e energjisë është nëpërmjet mobilizimit të indeve dhjamore. Disa lopë fillojnë edhe para pjelljes me tretjen e rezervave dhjamore. Kjo mund të vëzhgohet nëpërmjet rritjes së përqendrimit të acideve yndyrore të lira në gjak, si rrjedhim i tretjes së indeve dhjamore.

Por metabolizmi i lopës nuk mund ta përpunojë menjëherë tepricën e yndyrave të lira. Në këtë mënyrë një pjesë e mirë e yndyrave depozitohen në mëlçinë e lopës. Si pasojë e furnizimit të mangët me energji dhe fluksit masiv të yndyrave të lira, mëlçia nuk është në gjendje t'i metabolizojë. Mëlçia dhjamoret dhe funksionaliteti i saj dëmtohet rëndë.

Organizmi ka nevojë për glukozë për të tretur dhe përpunuar acidet yndyrore. Në rastin e pamjaftueshmërisë së glukozës, si pasojë e mangësisë energjike, në gjak grumbullohen ketone të dëmshme si aceton, acid acetik, acidi betahidroksi butirik (BHB).

Prania e BHB në gjak mund të provohet nëpërmjet një testi të shpejtë duke përdorur disa pika gjak. Në këtë mënyrë mund t'i shërbejë fermerit si një diagnozë e shpejtë për të parë nëse ka të bëjë me një ketozë subklinike ose akute.

Duke qënë se shumica e lopëve të prekura nuk tregojnë shenja të një sëmundjeje të metabolizmit, dallimi i saj nëpërmjet sjelljes së lopëve është i vështirë. Një ulje e lehtë e prodhimit të qumështit shpesh mbetet pa u vënë re. Por, rritja e përmbajtjes së yndyrës në qumësht dhe e raportit yndyrë-proteinë mund të shërbejnë si pika referimi. Në rastin e ketozës krahas rritjes së yndyrave kemi edhe ulje të proteinave në përmbajtjen e qumështit. Nuk duhet harruar se parandalimi është gjithmonë më mirë se trajtimi.

MËNYRAT E TESTIMIT

Kafshët me sëmundje subklinike nuk mund të dallohen nga fermeri vetëm nëpërmjet vëzhgimit. Si mjete ndihmëse shërbejnë testet e qumështit, gjakut dhe urinës.

QUMËSHTI

Marrja e provës është e thjeshtë. Qumështi dhe shiriti testues duhet të temperohen dhe të zhvillohet testi. Rezultatet mund të zbulohen nëpërmjet një shkalle të ngjyrave. Në testin e qumështit nuk gjykohen vlera të sakta, por vetëm ndryshimi i ngjyrës së indikatorit. Rezultatet influencohen në mënyrë serioze nga përmbajtja e lartë e qelizave somatike në qumësht ose ushqimi me silazhe të prishura. Rezultatet e testit shpesh nuk janë mjaftueshëm të qarta.

URINA

Urina mund të merret si në mënyrë spontane ashtu edhe me ndihmën e një kateteri. Marrja spontane e urinës nuk është praktike në stallat e mëdha. Natyrisht është e rëndësishme të pastrohet vulva e lopës dhe të përdoren materiale higjienike për të shmangur infeksionet e kanalit urinar. Edhe në testin e urinës rezultatet mund të lexohen në shkallën e ngjyrave. Matja e përmbajtjes së ketozës me anë të këtij testi kërkon relativisht shumë kohë në rastin që kemi të bëjmë me shumë kafshë. Si pasojë, këto teste gjejnë pak përdorim në praktikë.

GJAKU – ANALIZA LABORATORIKE

Analiza e gjakut është metoda më e saktë, por edhe më e shtrenjtë. Gjaku ka avantazhin, që përveç ketoneve mund të analizohen edhe parametra të tjerë si yndyrnat e lira, lëndët minerale dhe enzimat e mëlçisë. Rezultatet e analizës së gjakut jepen në vlera numerike dhe tregojnë në mënyrë të qartë dhe të matshme gjendjen e kafshës. Por për marrjen e provës së gjakut nevojitet ndihma e veterinerit.

Testi i shpejtë i gjakut

Për zbulimin e shpejtë të ketozës subklinike është i përshtatshëm përdorimi i pajisjeve të testimit të shpejtë, të cilat përdoren për matjen e yndyrave në gjak. Me anë të këtyre pajisjeve mund të merret një rezultat brenda pak sekondave vetëm me një pikë gjak.

Zhvillimi i testit të shpejtë të gjakut

Në këtë test nuk bëhet fjalë për marrjen klasike të provës së gjakut me shiringë nga ana e veterinerit. Për testin e shpejtë mjafton një shpim i lehtë i lëkurës për marrjen e një pike gjaku dhe mund të bëhet në çdo kohë nga vetë fermeri.

Në rast se testi tregon shenjat e fillimit të ketozës nuk mjafton vetëm ndryshimi i dietës ushqimore, por nevojitet edhe ndihma e veterinerit për trajtimin profesional të kafshës. Nuk duhet harruar që çdo test i shpejtë na jep një ide të gjendjes shëndetësore të lopës, por në asnjë rast nuk mund të zëvendësojë analizat laboratorike në përpilimin e një diagnoze përfundimtare.

Zhvillimi i këtyre testeve ndihmon në zbatimin e masave monitoruese. Një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet fermerit dhe veterinerit është shumë i rëndësishëm. Rezultatet e testeve të shpejta shërbejnë si një informacion paraprak tepër i vlefshëm për veterinerin.

Testi në vulvë, vesh, bisht

Marrja e një pike gjaku nga buzët e vulvës është një metodë e re që është testuar nga veterinerët e Univesitetit të Mjekësisë Veterinare në Vienë, Austri.

Vulva e pastruar mirë shpohet lehtë me anë të një gjilpëre. Pastaj një pikë gjaku përthithet nga shiriti i aparatit testues. Pas vetëm pak minutash rezultati i testit mund të lexohet në aparat.

Enët sipërfaqësore të gjakut në vesh janë shumë të përshtatshme për testin e shpejtë të gjakut.

Pjesa e poshtme e bishtit është gjithashtu një mundësi e mirë për marrjen e gjakut. Por në këtë rast është i rëndësishëm një pastrim i mirë i sipërfaqes përpara shpimit.

SHMANGIA E KETozës

Duke qenë se mangësia energjike është në thelb të problemit, është e rëndësishme që strategjia ushqimore të bazohet në rendimentin dhe tiparet ripërtypse të lopës.

Veçanërisht duhet shmangur dhjamosja në muajt e fundit të laktacionit. Drejt fundit të fazës së mbarsjes këshillohet zbatimi i një racioni ushqimor tranzitor me një rritje të ngadaltë dhe të moderuar të përmbajtjes energjike.

Përgjithësisht pranë kohës së pjelljes lopët kanë edhe probleme të tjera si pjellje problematike, sëmundjet e thundrave etj. Të gjitha këto kanë efekt negativ në oreksine kafshës dhe është e nevojshme që çdo rast të trajtohet në mënyrë specifike.

Një masë tjetër që duhet marrë është sigurimi i mundësisë për lëvizje, sepse rritja e aktivitetit fizik e lehtëson shpërbërjen e trupave ketonikë.

Në parim të gjitha lopët në javët e para pas pjelljes duhet të kontrollohen për ketozë në intervale javore.

MENAXHIMI I TUFËS

Masat që duhen ndërmarrë:

- ♦ Mbikqyrja e gjendjes trupore BCS (Body Condition Score) veçanërisht në fund të laktacionit. BCS duhet të jetë 3,5 për Holstein dhe 4,0 për Simental.
- ♦ Zbatimi i profilaksisë për ethet e qumështit
- ♦ Sigurimi i marrjes së ujit pas pjelljes.
- ♦ Mbikqyrja intensive dhe matja e temperaturës në javët e para të laktacionit.

MBAJTJA NË STALLË

- ♦ Ndërrimi i rrallë i vendqëndrimit. Lopa nuk duhet të ndërrojë vendin më shpesh se një herë në javë.
- ♦ Lopa duhet të ketë akses të mjaftueshëm ndaj ushqimit, veçanërisht në periudhën para dhe pas pjelljes.

USHQIMI

Mënyra më e suksesshme për luftimin e ketozës (subklinike) është nëpërmjet një menaxhimi optimal të ushqimit.

- Furnizimi me ushqim cilësor dhe shmangia e ushqimeve ketogjene.
- Furnizimi i lopëve me ujë të freskët dhe të pastër.
- Përshtatja e ushqimit me nevojat e kafshës, duke marrë parasysh edhe fazat e laktacionit dhe të tharjes.
- Shmangia e rënies në peshë në fazën e tharjes.
- Përdorimi i Propilenglikolit dhe Glicerinës si shtesë ushqimore



Përmbledhje

- Nevojat energjike të lopës dyfishohen brenda pak ditëve nga pjellja.
- Bilanci energjitik gjatë kësaj kohe është negativ.
- Aktivitetet rreth kohës së pjelljes ndikojnë në sëmundjet e metabolizmit.
- Ekzistojnë disa metoda matëse për zbulimin e ketozës subklinike.
- Aparatet e testit të shpejtë të gjakut japin një rezultat të vlefshëm që bën të mundur trajtimin e shpejtë të gjendjes së kafshës.
- Rezultatet e aparateve matës duhen interpretuar në mënyrë të saktë.
- Propilenglikoli është vërtetuar si një substancë e vlefshme në trajtimin e ketozës subklinike.
- Për trajtimin e Ketozave subklinike janë të nevojshme të merren masa në menaxhimin e tufës, mbajtjen në stallë dhe ushqimit.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

2.MËNYRA E TË USHQYERIT, KONTROLLI I PARAMETRAVE TË METABOLIZMIT DHE TRAJTIMI I VIÇAVE TË SAPOLINDUR ME DIARRE

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Kristian Maka



Diarreja, një nga shkaqet kryesore që sjell humbjet më të mëdha në viçat e sapolindur.

Dëshironi të informoheni mbi shkaqet, faktorët që ndikojnë në diarrenë e viçave të sapolindur dhe praktikat më të mira të trajtimit të saj?!

Këto i mësoni nga AUSTRIA PRAEMIX, në bashkëpunim me Schaumann-Agri-International, sjell rregullisht specialistë nga Austria për seminare dhe këshillime për fermat në Shqipëri.

AUSTRIA PRAEMIX ofron përzierje vitaminash dhe lëndë minerale, të cilat përzihen me koncentratet për të gjithë kategoritë e kafshëve dhe furnizon një pjesë të mirë të fermave, të cilat e prodhojnë vetë përzierjen e koncentreve. Kategoritë kryesore janë (1) gjedhët, (2) derrat, (3) shpendët

Diarreja mund të prekë viçat e sapolindur në javën e parë, të dytë deri në javën e tretë të lindjes. Për shkak të diarresë viçi dehidratohet, humbet lëngje, elektrolite dhe lëndë ushqyese.

Humbja ditore e lëngjeve gjatë diarresë të shkallës së mesme shkon në 8-10% të peshës trupore (afërsisht 3-4 litra të një viçi me peshë 40 kg), në rastet e diarresë të një shkalle më të rëndë këto humbje shkojnë deri në 20% të peshës trupore.

DOBËSIMI SI PASOJË E DIETËS

Simptomat më të zakonshme të diarresë për shkak të humbjes së lëndës rezervë janë:

1. Dehidratimi

- ♦ Testi i elasticitetit të lëkurës (kthim në pozicion fillestar për më shumë se 2 sec)
- ♦ Bulbi i syrit varet
- ♦ Qëndrim shtrirë pa lëvizur

2. Rritja e nivelit të aciditetit në gjak (acidoza)

Më poshtë do të gjeni arsyet e këtij fenomeni, që është një problem jo pak serioz për viçat e sapolindur.

MOS E NDËRPRISNI QUMËSHITIN

Praktikat e aplikuara në të kaluarën i referohen metodave të ndërprerjes së qumështit dhe zëvendësimit të tij me elektrolite dhe glukozë.

Fatkeqësisht kjo praktikë vazhdon të aplikohet edhe sot.

Në ditët e sotme kjo metodë nuk mund të aplikohet më, duke ditur se nuk mbështetet as shkencërisht.

Një nga arsyet është mosplotësimi i nevojave energjitike të viçave me diarre vetëm nga elektrolitët.

Viçat e sapolindur të cilët nuk ushqehen me qumësht shfaqin humbje të mëdha peshe, duke qënë kështu më të ekspozuar ndaj sëmundjeve të tjera. Është pikërisht ky status që çon në ngordhje të viçave.

NGORDHJET E VIÇAVE PËR SHKAK TË URISË DHE MUNGESËS SË ENERGJISË

Në praktikë shpesh herë kërkohet të verifikohen patogjenët, për ngordhjen e viçave të sapolindur por harrohet se situata mund të ketë ardhur si pasojë e urisë dhe mungesës energjitike në racion.

Bazuar në një histori dhe përvojë suksesi, AUSTRIA PRAEMIX rekomandon:

Elektrolitët duhet t'i jepen viçave, vetëm si pije midis vakteve me qumësht (sipas planit të pirjes në tabelën eparaqitur).

PLANI I PIRJES DHE TRAJTIMI

Thelbësore për trajtimin e viçave me diarre janë të vlefshme të njëjtat principe si te foshnjat e sëmura me diarre. Për shumë arsye një mjekim absolut "kundër diarresë" nuk ekziston.

Disa nga masat më të efektshme janë:

- Mbulimi i nevojave për lëndë ushqimore dhe energji
- Zëvendësimi i humbjeve të lëngjeve dhe elektroliteve
- Balancimi i aciditetit në gjak

MBULIMI I NEVOJAVE PËR ENERGJI

Për sa kohë që viçat pijnë qumësht (kjo ndodh gati gjithmonë në fillim të diarresë), duhet që nevojat për lëndë ushqyese dhe energji të mbulohen nga një racion i plotë qumështi. Nevoja ditore është rreth 12% e peshës trupore të viçit. Për të garantuar një funksionalitet sa më të mirë të aparatit tretës dhe proceseve të fermentimit duhet që viçat të ushqehen shpesh dhe në sasi të vogla qumështi (sasia e plotë ditore e qumështit duhet të ndahet në 3 vakte, sipas planit të pirjes në tabelën e paraqitur). Vlen të theksohet se viçave me diarre duhet t'u jepet një racion qumështi i plotë në të njëjtën mënyrësi viçave të shëndetshëm.

Sipas praktikave më të mira, vazhdimësia dhe mosndërprerja e qumështit jep rezultate të kënaqshme.

Janë marrë në studim viça me diarre që ushqehen me qumësht të plotë (sipas planit të pirjes në tabelën e paraqitur) dhe viça me diarre që u është ndërprerë qumështi.

Nga ky studim janë nxjerrë konkluzionet e mëposhtme:

- Kohëzgjatje e njëjtë e diarresë - mesa duket kjo vërteton që ushqyerja me qumësht të viçat me diarre nuk është e dëmshme.
- Viçat me diarre që u ushqyen me racion të plotë të qumështit, 3 herë në ditë, shtuan peshë (600 gram), ndërsa viçat të cilët u ushqyen vetëm me elektrolite u dobësuan.

Plani i pirjes për viçat e sapolindur me diarre, sipas tabelës së paraqitur, ka rezultuar i suksesshëm.

Plani i pirjes për viçat e sapolindur me diarre (pesha trupore e viçit: 40-50 kg)

Në mëngjes Paradite (2)	1,5-2 litra qumësht (1) 1-1,5 litra elektrolit (3)
Në drekë Pasdite (2)	1,5-2 litra qumësht (1) 1-1,5 litra elektrolit (3)
Në darkë Në darkë vonë (2)	1,5-2 litra qumësht (1) 1-2 litra elektrolit (3)

•

- **Nevoja ditore për qumësht: 12% e peshës trupore**

Koha midis vakteve të ushqyerjes me qumësht duhet

- **të jetë afërsisht 2 orë**

Elektrolitet treten në ujë të ngrohtë dhe viçit i jepen nëpërmjet kovave me biberon.

2.2 ZËVENDËSIMI I HUMBJEVE TË LËNGJEVE TË TRUPIT

Humbjet e lëngjeve të trupit si pasojë e diarresë duhet të zëvendësohen me shtesë elektrolitesh, të cilat u jepenviçave në mes të vakteve të ushqyerjes me qumësht me një distancë prej afërsisht 2 orësh (sipas planit të pirjes në tabelën e paraqitur). Në varësi të shkallës së diarresë viçave ju jepet 3 herë në ditë nga 1 deri në 2 litra elektrolit në një kovë me biberon. Elektrolitet treten në ujë të ngrohtë, në temperaturë normale.

Përdorimi i elektroliteve me ndërprerje të qumështit, siç praktikohet shpesh, nuk është i mjaftueshëm, sepse nuk siguron kushte të përshtatshme në organizëm për të ulur nivelin e aciditetit në gjak.

Fermerëve u rekomandohet plani e pirjes dhe në pamundësi të zbatimit rigoroz të tij, atëherë dhënia e elektroliteve duhet të jetë domosdoshmërisht minimumi 2 herë në ditë midis 2 vakteve.

Humbja ditore e lëngjeve gjatë diarresë të shkallës së mesme shkon në 8-10% të peshës trupore (afërsisht 3-4 litra të një viç me peshë 40 kg). Kjo është dhe sasia ditore e elektrolitit që i duhet dhënë viçave dhe duhet ndarë në 3 vakte në ditë.

Duke ndjekur dhe respektuar rekomandimin e planit të pirjes, shmanget kalvari i pasojave të mëtejshme dhe trajtimeve më komplekse.

Përshkallëzimi i diarresë, si pasojë e uljes së konsumit të qumështit të viçat e sapolindur çon në aplikimin e infuzioneve:

- Në praktikë, në shumicën e rasteve kjo realizohet në formën e një infuzioni të shpejtë venoz.
- Infuzioni i vazhdueshëm mund të shpëtojë viçat që shfaqin shenja rënduara të dehidratimit dhe acidozës në gjak.

Elektrolitet duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Ato duhen të kenë një përbërje të thjeshtë. Për tretjen e elektroliteve, ashtu siç ndodh te foshnjat me diarre, edhe në rastin e viçave duhet të ndiqen rekomandimet e OBSH (Organizata Botërore e Shëndetit) (3,5 g NaCl; 2,5 g NaHCO₃; 1,5 g KCl dhe 20 g glukozë për 1 litër ujë). Sa më shumë të devijohet nga receta e rekomanduar nga OBSH, aq më e papërshtatshme është marrja e elektroliteve.
- Përbërësit e elektroliteve duhet të deklarohen qartë, jo vetëm në emërtim, por edhe në sasi/përqindje. Raporti i përbërësve të tretur në një litër tretësirë duhet të paraqitet, në mënyrë që të bëhet diferencimi i vlerave të rekomanduara nga OBSH.
- Elektrolitet duhet të jenë të thjeshta për t'u përdorur. Paketimi në sasi të vogla është më i përshtatshëm se paketimi në sasi të mëdha.
- Manuali i përdorimit duhet patjetër të përmbajë efektet anësore (helmimi nga një koncentrim i tepërti përbërësve në elektrolit).
- Elektrolitet duhet të kenë një përmbajtje bazike, sepse fermerët tentojnë të blejnë ato me përbërje të komplikuar dhe të shtrenjta, efektet e të cilave shpesh nuk janë të vërtetuara shkencërisht.

- Në të ardhmen elektrolitet duhet të emërtohen si "pije të ndërmjetme" ose "elektrolite". Emërtimet si "dietë apo lëngje zëvendësues të qumështit" janë të gabuara.



Përmbledhje mbi përdorimin e elektrolitëve të viçat me diarre:

- Përdorimi i elektroliteve si mundësi e kompesimit të lëngjeve të humbura, shpëton jetë.
- Viçave mund t'u jepen elektrolite edhe kur nuk kanë shenja diarreje.
- Përdorimi i elektroliteve me ndërprerje të qumështit, nuk është i mjaftueshëm, sepse nuk siguron nevojat ditore të viçave për lëndë ushqyese dhe energji.
- Elektrolitet duhet të përgatiten sipas udhëzimeve të prodhuesit, sepse ekziston rreziku i helmimit nga përbërësit e tretur.
- Nuk duhet përzihen me qumësht, sepse mund të ndikojnë negativisht te proceset e fermentimit dhe në fazat e tjera të tretjes.
- Elektrolitet duhet të kenë një përmbajtje bazike.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

3. SËMUNDJA MORTELLARO = DERMATITISDIGITALIS (DD)

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioneri i Austria Praemix shpk

Mortellaro (DD) është përshkruar shkencërisht në vitin 1974 në Italinga Cheli dhe Mortellaro dhe u diagnostikua në vitin 1980 nga shkencarët amerikanë. Ndërkohë që shumë "sëmundje klasike" mund të shërohen, madje edhe të zhidhen, janë shtuar disa sëmundje të tjera, të cilat kanë sjellë humbje të mëdha financiare. Këtu përfshihen Paratuberculosis, Leptospirosis, por edhe Dermatitis Digitalis (shkurt "DD" - sëmundja Mortellaro). Pas Austrisë, sëmundja u përhap nga importet e vçit nga perëndimi dhe vazhdon të përhapet që nga vitet 1990.

MORTELLARO (DD) - ÇFARË ËSHTË KJO?

Mortellaro (DD) - është një çrregullim shumëi dhimbshëm i lëkurës në këmbët e bagëtive, ku veçanërisht është prekur kavilja dhe pjesa ndërmjet dy thundrave. Në këtë pjesë të thundrës ndodh shpesh që të ketë një infeksion në pjesën sipërfaqësore në formën e luleshtrydhes shiko fig. 1.



Fig. 1: Thundër e infektuar në fazën fillestare

Kjo sëmundje në fazën fillestare shfaqet si mpirje e thundrës dhe në fazën e dytë shfaqet si acarim ose infektim i thundrave. Kur kjo sëmundje kthehet në një sëmundje kronike krijon flucka ose infektim deri në prishjen e lëkurës (Fig. 2).

Tipike është era që vjen nga DD, një përzierje mes të ëmblës dhe thartirës, kështu që mund të nuhaten kafshëte sëmura nga era e keqe nga distanca. Shkak për DD janë bakteret anaerobe (rriten nga mungesa e oksigjenit), të quajtur spirochete, të cilat ndryshojnë vetëm pak nga agjentët shkaktarë të sifilizit te njerëzit.



Fig. 2: Thundër e infektuar, sëmundje kronike

Shkalla e sëmundjes (10% deri në 85% e kafshëve janë me sëmundje akute) dhe ecuria e saj në kafshë të veçanta varet nga higjena, të ushqyerit, stresi, etj. Prandaj, ne flasim për faktorë të sëmundjes.

Infeksioni futet zakonisht nëpërmjet blerjes së kafshëve nga tufat e infektuara, por mund edhe të futet në stalla nga çizme të pista, automjetet, mjetet e stallës etj. Koha e infektimit deri në shpërthimin e DD në tufë zakonisht është rreth një muaj. Nëse sëmundja trajtohet siç duhet, ajo shërohet shpejt, por shpërthen në më shumë segjysmën e kafshëve brenda tre deri në katër muaj, në mënyrë të ngjashme me herpesin te njerëzit. Trupi e ka të vështirë, për fat të keq, të krijojë imunitet të rëndësishëm kundër sëmundjes.

Infeksioni gjithashtu nuk është i dallueshëm përmes analizës së gjakut dhe nuk mund të trajtohet mirë me injeksion antibiotikësh. Një karakteristikë e rëndësishme e kësaj sëmundjeje është fakti se sëmundja edhe nëse është zhidur në kushte praktike, në kafshë të veçanta nuk mund të shërohet përgjithmonë.

SI TRAJTOHET?

Trajtimi i kafshëve të sëmura fillon me kujdes funksional të këmbës, për të siguruar ngritjen e shputës dhe për të siguruar nxjerrje të infeksionit nga thundra.

Pikat e DD më pas pastrohen dhe mbahen të thata, trajtohen me antibiotikë, xhel të përshtatshëm ose zgjidhet zakonisht një kombinim bazë me përbërës bakrin ose zinkun. (Fig.3)

Ky trajtim lokal duhet të përsëritet në dy ditët në vijim. Brenda këtyre ditëve, DD përthahet, është pa dhimbje dhe shërohet, por përsëritet zakonisht pas disa muajsh sërisht. Kohët e fundit është raportuar edhe një trajtim i suksesshëm me adeziv të veçantë.



Fig. 3: Mjekim i thundrës



Procedura që duhen ndjekur:

- Kujdesi i thundrës në intervale prej katër muajsh.
- Kalimi i thundrave në vaskë në mënyrë që të pastrohet pjesa ndërmjet thundrave, dy herë në javë (në dimër gjithashtu mundësohet dalja në dëborë).
- Pastrimi i përditshëm i thundrës; për të përmirësuar komoditetin e lopës, pastrim ditor i shtratit dhe cilësia e ajrit.
- Trajtimi i të gjitha rasteve të DD akute.

SI MUND TË PARANDALOHET DD?

Kushtet higjienike stallore janë mjaft të rëndësishme, sepse nga mungesa e okshigjenit krijohet mjedisi i përshtatshëm për zhvillimin e spirochete anaerobe. Duke mirëmbajtur stallën parandalohet përhapja e baktereve në 10 deri 15%. Rreth 60% të baktereve që mund të gjenden në stallë janë bakteret të ndryshme nga ato të Mortellaors.

Spraji, vaska e dezinfektimit ose shkuma kanë kuptim vetëm nëse masat e mësipërme janë kryer në mënyrë rigorozë. Disa nga substancat e përdorura janë ose kancerogjene (formalinë) ose dëmtojnë mjedisin (bakri). Pa efekte anësore janë alkalinet (pH 12), pluhur gëlqereje epërdorur si një banjë pluhur ose mbeturinat shtesë në dhomëzat e stallave që ulin ngarkesën mikrobike dhe kështu sjellin efekte pozitive në sasinë e DD dhe të Mastitisit.

ÇFARË DËMI EKONOMIK SHKAKTON DD?

Rëndësia ekonomike e DD e përlogaritur ndërkombëtarisht është rreth 150 € dëmtim/humbje. Kostot reflektohen te humbja qumështit, të dhëna më të varfëra të pjellorisë, shpenzimet e trajtimit dhe veçanërisht kostot e zëvendësimit për bagëtitë e reja. Komplikime të mëdha bën DD nëse me "problemin normal të thundrës" lëkura e lopës sulmohet nga spirochete. Nëse këto pjesë të trupit nuk trajtohen me kujdes maksimal, atëherë këto defekte nuk janë më të rikuperueshme, sepse zhvillimi i thundrës në këtë rast është shumë i prekur dhe pjesët e shëndetshme të saj janë në minorancë.

Në stallat ku është e pranishme DD, ka edhe shpesh një normë të lartë të inflamacionit të lëkurës në rajonin e gjirit, e cila shtrihet gjatë dhe ka simptoma të ngjashme të tilla si DD. Gjiri është pothuajse saktësisht në të njëjtën gjendje si kurse kohët e fundit ishin këmbët. Midis pjesëve të gjirit, mes kofshëve dhe gjirit apo lëkurës së barkut dhe gjirit gjithashtu mbizotërojnë kushte anaerobe dhe sugjeron se patogjeni DD bën kërdinë edhe në lëkurën e gjirit.

ÇFARË DUHET MARRË PARASYSH KUR BLEJMË NJË KAFSHË?

Nga praktika dhe përvoja austriake, para se të blihen kafshë për fermën duhen patur parasysh këto pika nga pesonat:

- Të kërkojnë nga shitësi një konfirmim me shkrim se origjina e kafshëve është e lirë nga DD. Nëse shitësi refuzon ta bëjë këtë ju duhet të bleni një kafshë tjetër!
- Kafsha e blerë duhet të futet 4 javë në karantinë, të ketë kujdes thundrën dhe të vlerësohet lëkura në zonën në fjalë disa herë derisa të jetë larë tërësisht.

Në hyrje të stallës duhet të vendoset një govatë me ujë dhe dezinfektues për të pastruar këpucët e të gjithë personave që hyjnë në stallë.

PËRFUNDIMI

DD kushton çdo vit në Austri miliona euro. Këto para mungojnë nga arkat e fermerëve tonë. Nëse kjo sëmundje nuk luftohet në mënyrë efektive, humbja që rezulton prej saj do jetë gjithnjë në rritje në fermat e qumështit.

A është situata e ngjashme në Shqipëri?

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

4.GRIPI I GJEDHIT PARANDALIMI ME VAKSINA

Përpunuar nga Jon Zeneli



FAKTORË TË NDRYSHËM

Në luftën kundër gripit duhet të mbështetemi te medikamentet dhe jo vetëm. Masa po aq të rëndësishme janë edhe diagnostikimi i duhur, identifikimi i hershëm si dhe masat parandaluese. Një nga studimet e Kompanisë Schaumann është fokusuar në vaksinimin e gripit, duke e cilësuar si një masë parandaluese optimale.

Menaxhimi eficient i gripit, i cili përfshin edhe masat profilaktike dhe metafilaktike në mënyrë të rregullt dhe të planifikuar, mbron tufën kundrejt dëmtimeve të përhershme të mushkërisë, të cilat kanë një ndikim të jashtëzakonshëm në rendimentin e kafshës. Kështu mund të shmangen humbjet e mëdha financiare në fermë. Meqë sëmundja e një kafshe të vetme përhapet shumë shpejt në të gjithë tufën, është shumë e rëndësishme që kafshët e sëmura të trajtohen menjëherë dhe ato që janë ende të shëndetshme, të trajtohen me antibiotikë parandalues (metafilaktike) me efekt afatgjatë.

MENAXHIMI STRATEGJIK I VAKSINAVE PËR TË MBROJTUR TUFËN NGA FILLIMI

Gripi i gjedhit nuk është problem vetëm për një viç, por për të gjithë tufën. Vaksinimi në kohë i kafshëve redukton presionin e infeksionit dhe rrit mbrojtjen e gjithë tufës duke krijuar një gjendje homogjene imuniteti në fermë.

Në këtë mënyrë mund të reduktohen kostot e trajtimit mjekësor, sidomos gjatë periudhave sensitive, si faza e shkëputjes nga të ushqyerit me qumësht nga lopa, zhvendosja brenda fermës, transporti ose gjatë periudhës së ftohtë të vitit. Vaksinimi i hershëm i viçave mbi 8 ditësh, si dhe i lopëve në fazën e fundit të barsmërisë ose i kafshëve të remontit, është veçanërisht i rëndësishëm, pasi viçat fitojnë menjëherë një imunitet pasiv me anë të kulloshtrës së lopës së vaksinuar, përpara se të krijojnë vetë një imunitet aktiv. Maksimumi 2 javë pas përfundimit të imunizimit bazë arrihet një imunitet humoral maksimal kundrejt BRSV (virusi sincitialrespirator) virusit Parainfluenza-3 dhe Mannheimia Haemolytica serotipi A1 dhe A6.

VAKSINIMI I VIÇAVE DHE LOPËVE

Lopët e sapo pjella mund të mbrojnë viçat e tyre nga infeksionet në mënyrë efektive me anë të antitropave të tyre. Kjo vlen edhe për patogjenin kryesor të bronkopneumonisë enzootike – gripi i gjedhit.

Vaksinimi i lopëve në fazën e fundit të barsmërisë, përforcon mbrojtjen ekzistuese imunitare dhe siguron transferimin e antitropave nga lopa te viçi, duke qënë kështu pjesë e mbrojtjes së përgjithshme të gjithë tufës. Por jo të gjitha fermat, e zbatojnë rregullisht këtë masë parandaluese kaq të thjeshtë.

ANTITRUPAT E LOPËS MËMË MBROJNË VIÇAT

Rëndësia e imunitetit pasiv të viçave përmes antitropave që gjenden në kulloshtrë mund të vihet re tek infeksioni i BRSV: antitrupat pasivë të marrë përmes qumështit të lopës nuk mund të parandalojnë infektimin dhe përhapjen e virusit BRS, por të paktën mund të ofrojnë një mbrojtje të pjesshme ndaj simptomave klinike.

Kështu, është vënë re se viçat me antitropa nga ana e lopës, preken më rrallë nga virusi BRS dhe e kalojnë më lehtë. Sa më shumë antitropa mëmësore të maten në serum të viçave, aq më të lehta dhe të rralla janë sëmundjet e sistemit respirativ.

Në një studim për virusin BRS janë krahasuar 3 grupe viçash. Një grup ishte ushqyer me kulloshtër dhe u infektua me BRSV. Dy grupet e tjera nuk ishin ushqyer me kulloshtër, njëri u infektua dhe grupi i fundit u la i pa infektuar për kontroll. Imuniteti pasiv përmes antittrupave të kulloshtërës bëri që te këta viça virusi të ishte më i lehtë se sa tek ata pa mbrojtje.

Koncepti i vaksinimit pak para lindjes për të stimuluar imunitetin mëmësor deri tani ka qënë shumë i suksesshëm për të parandaluar diarrenë tek viçat e porsa lindur.

Ndërsa për parandalimin e pneumonisë enzootike të viçave përmes imunitetit mëmësor nuk ka mjaftueshëm studime shkencore. Studimet për infektimin me BRSV të viçave dhe studime të tjera aktuale, tregojnë rëndësinë e vaksinimit të lopëve në fazën e fundit të barsmërisë dhe të remontëve ndaj patogjenëve të bronkopneumonisë enzootike.

VAKSINIMI SEZONAL

Bronkopneumonia enzootike mund të ndodhë në çdo periudhë të vitit, por më shpesh gjatë periudhës më të ftohtë. Kështu, çdo vjeshtë shumë kafshë bien pre e kësaj sëmundjeje. Por kjo nuk ka pse të jetë kështu, pasi ekzistojnë masa të qëllimshme profilakse (parandaluese), në rradhë të parë vaksinimi sa më i shpejtë i të gjitha kafshëve që mund të vaksinohen në tufë.

Vaksinat mbrojtëse parandaluese rrisin imunitetin e kafshëve të vaksinuara, i ndihmojnë ato të luftojnë patogjenët me sukses, ulin shpeshtësinë dhe vështirësinë e sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes si dhe humbjet financiare.

Gjithsesi, fatkeqësisht ekziston një "virus neglizhence" i cili prek çdo vit fermerët duke i dhënë mundësi gripit të përhapet në të gjithë tufën. Dhe në qoftë se BP enzootike arrin të prekë gjithë tufën, fermerët përballen me probleme si humbje të mëdha të mbarështimit, dëme të përhershme të mushkërive, rritje e ngadalësuar, rritja e moshës së barsmërisë dhe rënie e rendimentit të prodhimit të qumështit.

Pra, merrini masat parandaluese në kohë! Informacione të tjera në lidhje me këtë, mund t'ju japë veterineri.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

Franz Riegler

Ekspert i të ushqyerit dhe bashkë-
themelues i Austria Praemix Albania.



5.RËNDËSIA E FURNIZIMIT ME UJË TE GJEDHI

"ASKUJT NUK I SHKON MENDJA TE MUNGESA E UJIT"

Intervistë me Z. Franz Riegler, Këshillues i Schaumann në Austri dhe Aksioner i
AUSTRIA Praemix shpk.

Përpunuar nga Rexhep Peposhi

**NJË KONTROLL RUTINË NË LABORATOR PËR FUNKSIONIMIN E
METABOLIZMIT, SHPESH HERË TREGON EDHE MUNGESËN E UJIT. NE
PYETËM Z. FRANZ RIEGLER PËR SHKAQET E KËSAJ.**

1- Ju përballeni çdo ditë me probleme të ndryshme të metabolizmit të lopëve të qumështit. Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë te këto probleme?

Riegler: Të ushqyerit e kafshëve në ferma është shumë sfidues. Fermerët duhet të përkushtohen së tepërmi ndaj planeve të të ushqyerit, racioneve ushqimore dhe cilësisë së ushqimeve. Sidoqoftë, shpesh vihet re se fokusi kryesor nuk shkon te sasia e duhur e ujit që nevojitet në ditë. Kjo sasi luan një rol jetësor në prodhimin e qumështit, balancën e temperaturës së trupit, si edhe në funksione të tjera metabolike të lopëve të qumështit.

Te lopët, që nuk kanë konsumuar ujë mjaftueshëm, do të shihet një ekskretim më i pakët i urinës dhe një rritje në përqëndrimin e uresë.

2- Kjo që sapo përmendët dëshkohet në rezultatet e analizave laboratorike?

Riegler: Rezultatet e analizave laboratorike japin vlera të një përqëndrimi të lartë të uresë. Kur bëhet fjalë për kontrollin e një lope të vetme, atëherë me shumë mundësi shkak është një sëmundje akute e kafshës - më pas shihet se si kjo ndikon në një shkallë më të përgjithshme në fermë.

Ajo që na bën më shumë përshtypje është shpeshësia e përballjes me këto situata.

3- Përse kjo gjë ju bën veçanërisht kaq shumë përshtypje?

Riegler: Në kuadër të inspektimit veterinar të menaxhimit profesional të tufave të lopëve, në ditët e sotme ka shumë përpjekje intensive, për të arritur performanca të larta të metabolizmit.

Duke synuar këto performanca, kemi më shumë mundësi për të marrë masa. Gjatëkontrollit për efektshmërinë e funksioneve metabolike merren mostra urine dhe gjaku nga 5-10 lopë normale, të shëndetshme, për çdo stad prodhimi. Shokues është fakti, që rezultatet tregojnë pothuajse gjithmonë një rritje të përqëndrimit të uresë, edhe pse ky nuk është qëllimi fillestar i analizës së kërkuar nga fermeri apo veterineri.

4- Cili mendoni se është shkak që fshihet pas kësaj?

Riegler: Nëse kafshët nuk kanë marrë sasinë e duhur të ujit, ato konsumojnë më pak ushqim dhe aktiviteti i tyre bie dukshëm. Për çdo kg lëndë të thatë, lopa ka nevojë për rreth 4 - 5 litër ujë. Pra, uji është më i rëndësishëm se sa mendohet zakonisht.

5- A shfaqet njësoj mungesa e ujit në të gjitha stadet e prodhimit?

Riegler: Sipas të dhënave tona, çdo fazë e prodhimit është e prekur, por besojmë semungesa e ujit është e theksuar veçanërisht në periudhën e tharjes.

6- Si e shpjegoni ju këtë?

Riegler: Për këtë duhet të bëhet një inspektim i fermës. Shpesh herë veterinerët konfirmojnë dyshimet e tyre për një furnizim të pamjaftueshëm me ujë në fermë. Shkaqe të tjera mund të jenë:

- ♦ Numri i pirëseve të ujit jo i mjaftueshëm krahasuar me numrin e krerëve të tufës në një fermë.
- ♦ Vendndodhja e gabuar në stallë e pirëseve të ujit.
- ♦ Pirëse që nuk funksionojnë siç duhet
- ♦ Lloj i gabuar i pirëses
- ♦ Prurje insuficiente e ujit
- ♦ Pirëse të papastruara.
- ♦ Ujë me baktere.

Lopët në periudhën e tharjes duket se janë më të prekurat nga kjo. Ndoshta kjo ka të bëjë me faktin se shpesh herë ato vendosen përkohësisht në zona të stallës të papërshtatshme për të pirë ujë duke bërë veçimin nga pjesa tjetër e tufës që mund të jenë në laktacion.

Si përfundim, fermeri dhe veterineri duhet t'i kërkojnë së bashku shkaqet. Ne si këshillues specialistë mund t'ju japim vetëm një shtysë. Vetëm kështu mund të shmangen plotësisht problemet me furnizimin e ujit në stallë.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

6.MBARËSHTIMI I VIÇAVE

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Rexhep Peposhi




Rentabiliteti i fermave përcaktohet nga rendimenti i qumështit dhe nga mbarështimi i viçave, sidomos kur kemi të bëjmë me tufa me potencial të lartë gjenetik, rezultatet e fermave janë akoma më të mëdha. Prandaj, mbarështimit të viçave duhet t'i jepet një vëmendje e veçantë. Pas konstatimeve të ekspertëve të ekonomisë, humbja nga mbarështimi i viçave rezulton akoma më shumë se 10%, si pasojë përbën një humbje të konsiderueshme për çdo fermë. Si arsye kryesore mund të përmendim problemet me sistemin e tretjes, respektivisht nga diarreja. Sipas studimit të Prof. Heckert nga Universiteti i Berlinit, ka shumë faktorë që lidhen me diarrenë. Figura 1 tregon shumë mirë që shkaktarët e diarresë janë viruse të ndryshme. Në qoftë se nuk ndërmerren masa rigoroze profilaktike ndaj viruseve, ato krijojnë ambient të përshtatshëm për bakterie të ndryshme të cilat përkeqësojnë më tej shëndetin e viçave. Në vazhdim përshkruhen disa masa të cilat do të fortësojnë gjëndjeshëndetësore të viçave.

Të parandalosh sëmundjen (me kosto më të ulët) është më mirë se të trajtosh sëmundjen prezente te viçat.

Shëndeti i mirë i viçit fillon që tek ushqyerja e lopës që në fillimet e barsmërisë. Të ushqyerit e lopëve me racione ushqimore me mungesë vitaminash, shkakton te viçat me vitalitet dobët dhe sistem imunitar të dobët. Në kushte të tilla ndikohet negativisht cilësia e kulloshtrës.

Nga ana tjetër, një ushqyerje intensive sjell dhjamosje të lopëve në tharje dhe si rrjedhojë kemi probleme gjatë pjelljes, dobësim të sistemit imunitar të viçave, shpesh herë e shoqëruar me ngordhje të viçave. Për këtë fazë rekomandohet që lopët barsë të trajtohen me një recetë të përpiluar në bazë të rendimentit dhe të konsumojnë sasinë e caktuar të vitaminave (Beta-Carotin, vitamina E etj). Në këtë fazë aplikimi i përzierjes me lëndë minerale speciale si RINDAVIT 2000 VK dhe implementimi i Beta- Carotinit me CAROVIT janë optimale. Përdorimi i tyre përforcon sistemin imunitar të fetusit, ndikon nëshëndetin e gjirit si dhe përmirëson cilësinë e kulloshtrës.

Fig.1 Diarrea te viçat- Shkaqet



Fillimi i kulloshtrës që në momentet e para të pas lindjes. Dhënia e kulloshtrës menjëherë pas lindjes ka prioritet maksimal pasi përbërja e saj ndryshon brenda disa orëve (Fig. 2). Në këto momente bie aftësia përthithëse e sistemit të tretjes kundrejt imunoglobulinave, që përmban kulloshtra. Janë pikërisht këto imunoglobulina (IgA, IgM), të cilat janë përgjegjëse për nivelin e antitropave në serumine gjakut.

Ky proces është jetik, sepse organizmi i porsalindur nuk merr dot antitruapat e nevojshme dhe shfaqen problematika me imunitetin. Rekomandohet dhënia e menjëhershme e kulloshtrës, sepse ndikon në nivelin e antitruapave në serumin e gjakut dhe kështu direkt në shëndetin e viçave.

Dihet që cilësia e kulloshtrës tek lopët e reja është më e ulët sesa ajo e lopëve të vjetra, prandaj rekomandohet që të ngrihet kulloshtra e tepërt e lopëve të vjetra dhe të shkrihet në momentin që nevojitet, me qëllim që viçat të konsumojnë një kulloshtrë sa më cilësore. Rekomandohet që të ngrihet vetëm kulloshtra e mjeljes së parë dhe më pas të shkrihet me banjë mari, në mënyrë që mos të dëmtohen antitruapat. Kulloshtra e ngrirë mund të ruhet deri në një vit.

Fig. 2: Ndryshimet në përbërjen e kulloshtrës pas pjelljes

Orë pas pjelljes		0	12	24	48	120
Substancë e thatë	%	37	14,5	12,8	11,9	12,7
Proteinë	%	17,6	6,0	4,5	3,9	3,9
Albuminë dhe Globulinë	%	11,3	3,0	1,5	1,0	0,9
Yndyrna	%	5,1	3,8	3,4	2,8	3,8
Sheqer	%	2,1	3,5	4,2	4,4	4,4
Vitaminë A	I.E/kg	11596	7760	4299	2138	692
Vitaminë B2	mg/kg	6,9	3,4	2,4	2,2	1,8

Përmirësimi i cilësisë së kulloshtrës nëpërmjet KALBI-FERM

KALBI-FERM përmban probiotikun Provita LE si dhe vitaminat A, E, C dhe Beta – Carotin të cilat përmirësojnë sistemin imunitar të viçat e porsalindur.

Përmirësimi i vlerave të qumështit të plotë me KALBI PHOSPHORAL SL

Zëvendësimi i qumështit me KALBI PHOSPHORAL SL, garanton një tretje stabile dhe rritje të shpejtë të viçit. KALBI PHOSPHORAL SL përveç se përmban disa vitamina speciale, ka edhe probiotikun "Provita LE" të konceptuar nga SCHAUMANN. Testet në institut dhe në praktikë tregojnë ndikim pozitiv në shumimin e mikrobeve në stomak, të cilat kanë funksion stabilizues të sistemit të tretës. Nga rezultatet e kërkimit vërehet një ndikim pozitiv në zhvillimin e rendimentit. Kjo mund të shihet nga rritja e konsumit të ushqimit për viça dhe ushqimit voluminoz, të cilat sjellin rritjen e konsumit ditor dhe si pasojë rritjen më të shpejtë të viçit.

Për problemet me sistemin e tretjes rekomandohet të përdoret KALBI START SUPER dhe KALBI-LYT

Në rastet e shfaqjes së problemeve me tretjen, në formën e diarresë, rekomandohet veprim i menjëhershëm. Ndërprerja ose reduktimi i dhënies së qumështit të plotë dhe aplikimi i KALBI-LYT i cili përmban elektrolite që ndikojnë në stabilizimin e sistemit tretës në pak ditë.

Në rastin kur çrregullimi interstinal zgjat për një kohë të gjatë është e nevojshme të njoftohet veterineri.

Me produktin e ri të SCHAUMANN, KALBI START SUPER, mbarështimi i viçave bëhet edhe më i sigurt. Përveç vitaminave dhe probiotikut Provita LE, produkti përmban mikroelementë, të cilat mbrojnë mikrobakteriet e rëndësishme në sistemin e tretjes. Ky produkt mund të përdoret në situata stresi (ndërrim stalle, transportim) dhe parandalon problemet në sistemin e tretjes si dhe përshpejton fazën e rigjenerimit të zorrës pas diarresë.

Përmbledhje

Pas të ushqyerit të lopëve barsë duhet ti kushtohet shumë rëndësi konsumit të mjaftueshëm të kulloshtrës dhe kështu vitaminave të nevojshme për viçat. Me produktin KALBI START SUPER, kompania SCHAUMANN kompletton konceptin e saj për mbarështimin e viçave. (Dr. Johann Hammerer).

Fig. 3: Ndikimi nga konsumi i kulloshtrës në mbarështimin e viçave deri në ditën e 90-të

Konsumi i kulloshtrës (l/ditë)	Antitruapat në serum (g/l)	Rritja deri në ditën e 90 (g/ditë)
më pak se 1,5	6,2	618
1,5-1,9	7,8	585
2,0-2,4	9,7	687
2,5-2,9	9,8	698
3,0-3,4	11,9	694
mbi 3,4	12,8	679

DLZ, 10/98 (Dr. Losand, Dr. Sanfleber, Dummersdorf)

Të ndihesh mirë në Iglu

Ajrosje e mirë, higjenë dhe shtrojë e freskët në stallë nëpërmjet sistemit Iglu forcojnë sistemin imunitar të viçave të rinj nga sëmundjet e ndryshme.

Drita e mjaftueshme ka një ndikim shumë pozitiv tek shëndeti i viçit. Rrezet e diellit të cilat përmbajnë nivel të lartë të rrezeve ultraviolette kanë efekt në shkatërrimin e bakterieve dhe vitaminës D. Prandaj vendi më i mirë në stallë i takon bokseve të viçave, nuk rekomandohet në afërsi të impiantit të mjeljes sepse nga prania e avujve rrit rrezikun ndaj infeksioneve.

Gjithmonë e më shumë komplekset blegtorale aplikojnë mbarështimin e viçave në qiell të hapur me sistemet Iglu. Këto të fundit duhet të pozicionohen në atë mënyrë që çdo viç të shtrihet, të rrijë shtrirë, të ngrihet përsëri dhe të mund të pastrohet. Vendi ku shtrihet viçi duhet të jetë i izoluar në mënyrë që ngrohtësia të ruhet aty si dhe viçi mos të rrëshkasë. Gjithashtu uji duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga viçat, jo vetëm kur viçat të jenë sëmurë ose në periudha të nxehta. Temperatura e ajrit në stallën e viçave duhet të jetë 5°C deri 20°C, jashtë Iglus nuk është problem në qoftë se temperatura është më e ulët.

Duhet të kemi kujdes nga erërat e forta. Në sistemet Iglu mund të mbahen viçat në qiell të hapur që nga momenti kur lëkura e tyre është tharë.

Kur ka probleme me sëmundjet në stallë rekomandohet mbajtja e viçave jashtë saj. Bokset për viça mund të ndërtohen edhe nga vetë fermeri. Sistemet Iglu mund të blihen te shitësit dhe janë bokse të vogla me material plastik, pamja optike është e ndryshme nga secili prodhues. Të dy sistemet duhet të pastrohen lehtë, të kenë ajrosje të mjaftueshme dhe duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme për mbarështimin e viçave. Në komplekset e mëdha blegtorale, viçat mund të mbahen në grupe me sistemin Iglu ose në bokse për viça.



Rrezet e diellit, optimale për mbarështimin e viçave

Sidomos në dimër rrezet e diellit duhet të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Në verë nuk duhet të kemi bllokim të nxehtësisë, prandaj në raste të tilla është i nevojshëm pozicionimi i sistemeve Iglu në hije. Për t'i bërë ballë erës dhe temperaturave të ulta si dhe për të ruajtur temperaturën optimale trupore të viçave është e nevojshme që Iglu të pozicionohen në një vend që të jenë mbrojtur nga era. Tre anët e çadrës të mbyllura dhe hyrja e pozicionuar nga drejtimi i kundërt me erën krijojnë kushtet optimale për mbarështimin e viçave. Bokset dhe sistemet Iglu që vendosen jashtë duhet të pozicionohen, në mënyrë që mos të pengohet pastrimi i herëpashershëm i tyre.

Kur vjen periudha tjetër për mbarështimin e viçave, sistemet Iglu duhet të pastrohen me pompë me presion dhe më pas të dezinfektohen. Ajrosja optimale është e domosdoshme, sistemet Iglu duhet të ketë hapësira të caktuara në mënyrë që ajri të qarkullojë lirshëm në to. Kashta në tokë ka funksion izolues, dhe shërben për të mbajtur ngrohtë viçin brenda sistemit Iglu. Nëpërmjet sistemit të rregullimit të temperaturës, viçi mund të mbajë vet temperaturën e trupit konstante. Kontrolli i viçave në Iglu është shumë i domosdoshëm, në mënyrë që viçat e pafuqishëm dhe të sëmurë të trajtohen sa më shpejtë dhe në qoftë se është e nevojshme viçi i sëmurë të transportohet në një vend më të ngrohtë (me llambë ngrohëse).

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

7.VIÇAT E SHËNDETSHËM KËRKOJNË MENAXHIM TË MIRË

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Rexhep Peposhi



Fabrikat e përpunimit të qumështit në Austri po bëhen gjithmonë e më të mëdha por fuqia puntorenë këto fabrika jo. Për të menaxhuar tufë me lopë qumështi, nevojitet shumë kohë, vëmendje dhe njohuri. Si pasojë, për mëshqerrat dhe viçat ngelet shumë pak kohë. Veçanërisht për viçat duhet të tregohet kujdesje e veçantë. Por si duhet të menaxhohet situata pikërisht në Shqipëri?

Fakt është që një në dhjetë viça në Austri ngordhin. Shkaqet kryesore janë: diarreja e viçave, viruset rota, korona, kriptosporidit ose koksidet si dhe sëmundjet e aparatit respirator (grip, pneumoni). Sëmundjet e viçave janë faktorë sëmundjesh për gjedhin e rritur. Kjo do të thotë që ka shumë faktorë përgjegjës që shkaktojnë diarre ose gripin e gjedhit. Mikrobet patogjene gjenden në çdo stallë. Përhapja e një sëmundjeje varet nga përqëndrimi i mikrobeve dhe nga rezistenca e viçave.

Ulja e përqëndrimit të mikrobeve patogjene

Për të mbajtur përqëndrimin e mikrobeve patogjene sa më të ulët, viçat duhet të mbahen në ajër të pastër. Ngarkesa bakteriale në stalla është shumë e madhe për shkak të numrit të madh të kafshëve në hapësirë të vogël.

Bokset e lindjes dhe bokset e viçave duhet të pastrohen rregullisht dhe të dezinfektohen nga mikrobet (koksidet, kriptosporidit, viruset rota dhe korona). Bokset e pastruara (të dezinfektuara) duan kohë të mjaftueshme të thahen siç duhet dhe të qëndrojnë për një kohë të gjatë bosh. Bokset e viçave vendosen në diell sepse rrezet UVngordhin mikrobet patogjene. Edhe në dimër, kur pastrimi me ujë me presion është i vështirë, bokset mund të pastrohen pjesërisht dhe të vendosen për disa ditë në ajër të pastër në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa bakteriale.



Problematike janë bokset e drurit. Këto janë më të vështira për t'u pastruar dhe dezinfektuar për shkak të sipërfaqesë tyre të ashpër. Veçanërisht vështirësi hasen kur bëhet luftimi i kriptosporideve ose kokcideve. Bokset ose iglotme sipërfaqe të lëmuar (plastike, me pllaka tallashi të presuara) në këtë rast kanë përparësi. Në sipërfaqet e lëmuara dezinfektimi i mikrobeve bëhet më me lehtësi.

Forcimi i sistemit imunitar të viçave

Rezistenca e viçit është vendimtare nëse shpërthen ose jo një sëmundje. Kjo fillon që para lindjes. Lopa duhet të jetë në gjendje fizike të mirë dhe të jetë e furnizuar me lëndë minerale (vitamin E dhe selen). Edhe lindja duhet të bëhet pa nevojën e ndihmës së tërheqjes . Për të arritur higjenë dëshiruar nuk mjafton vetëm pastrimi i bokseve, por edhe koha e nevojshme e qëndrimit bosh. Kushti më i mirë për viçin është furnizimi i mjaftueshëm me kullashtër. Menjëherë pas lindjes, viçi duhet të konsumojë 2 litër kullashtër dhe 1-2 litër nga mjelja e kullashtërës së parë në vaktin e dytë, afërsisht 3-6 orë më vonë. Gjithashtu është e rëndësishme që viçi menjëherë pas lindjes të vendoset në një mjedis të pastër, mundësisht në një iglo ose në një boks të lëvizshëm me mure të lëmuara. Iglo duhet të vendoset në një vend të mbrojtur nga era dhe shiu dhe të jetë i shtruar me një shtresë kashte të trashë dhe të thatë.

Në dimër, në orët e para pas lindjes, në bokse të vendosen tavane ose llamba infra të kuqe në mënyrë që viçi të jetë ngrohtë derisa është ende i njomë.

Bokset e veçanta nuk duhet të vendosen në stallë pasi përqëndrimi i mikrobeve është shumë i lartë për shkak të mbetjeve nga lindja. Viçat nuk duhet të ekspozohen ndaj rrymave të ajrit. Për këtë vijnë në ndihmë dërrasat që vendosen në pjesën e pasme të boksit, të cilat parandalojnë futjen e ajrit të ftohtë në bokse. Gjithashtu një batanije do t'i mbante ngrohtë në ditët e para të lindjes.

Kujdes me sasinë ditore të qumështit në ditët e para

Për shkak të kequshqyerjes, si ofrimi i një sasive të madhe qumështi në vakt, shpesh herë shkaktohet diarre. Me përjashtim të kulloshtrës e cila i ofrohet viçit në ditën e parë pa limit, një viç nuk duhet të konsumojë më shumë se 1,5 litra qumësht në vakt. Prandaj janë të nevojshme tre vakte në ditë. Në fund të javës së parë sasia e qumështit rritet deri në 2,5 litër për vakt dhe kështuvazhdon të rritet. Pas javës së dytë viçit duhet t'i ofrohet koncentrat, kashtë dhe ujë.

Në fermat me probleme të përsëritura duhet të gjendetshkaku me ndihmën e veterinerit dhe një këshilltari të Drejtorisë së Bujqësisë, gjithashtu duhet të konceptohet një program mirëmbajtjeje. Një skemë e mirëfilltë rritjeje dhe asistence në rritjen e viçave është marrë nga shoqatae mbarshtuesve të viçave të Austrisë së Sipërme, gjithashtu e gjeni edhe te Austria Praemix.

Tab.1: Plani i pirjes në javën e parë të jetës.

Mosha në ditë	Sasia në l/vakt	Vaktet
1	0,75 deri 1	3
2 deri 3	1 deri 1,5	3
4 deri 7	2 deri 2,5	2

Tab 2: Plani ushqimor për javën e 2-të deri në javën e 8-të të jetës.

Javët e para të jetës	Qumësht lope ose pluhur L/ditë	Ushqim koncentrat kg/ditë	Jonxhë cilësore	Ujë
2	6			
3	7			
4	8			
5	8			
6	7			
7	6			
8	4			

Sasia sipas dëshirës!

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

8.OBJEKTIVAT NË RITJEN E VIÇAVE

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Rexhep Peposhi




- ◆ Menaxhim optimal i kulloshtrës
- ◆ Rritje e shpejtë për ripërtypësit.
- ◆ Optimizim i kostove të rritjes.
- ◆ Shmangie e humbjeve të viçave.

Rritja e viçave fillon me përgatitjen e planit të ndërzimit

- ◆ Gjenetikat prindërore ndikojnë në pjellje dhe në zhvillimin e viçit.
- ◆ Të bëhet përzgjedhja korrekte e demit.
- ◆ Lopa të përgatitet mirë për pjellje.
- ◆ Të ofrohet ushqimi për performancë të lartë dhe ushqim për shkëputje.
- ◆ Të bëhet përgatitja për procesin e pjelljes.
- ◆ Pjellja të bëhet në një mjedis të pastër dhe të ofrohet ndihmë gjatë këtij procesi.

Zhvillimi i viçit në barkun e lopës



Dallimi i shenjave të fillimit të pjelljes dhe interpretimi i saktë i tyre

- ◆ Të shënohet në kalendarin e fermës çdo moment i rëndësishëm i vijueshmërisë së kafshës.
- ◆ Lopët duhet të kalojnë periudhën e tharjes në kohën e duhur.
- ◆ Të dhënat në kompjuterin e stallës të jenë të aktualizuara (nëse ka një të tillë në dispozicion).
- ◆ Informacione të sakta të paraqitura në tabelat e vendosura në stallë.

Pjellja duhet të kryhet në kushte higjienike

- ◆ Përgatitja e martenitetit për pjellje dhe pajisja me kashtë si shtrojë.
- ◆ Ofrimi i suportit gjatë pjelljes, kur nevojitet. Përdorimi i litarëve tërheqës të sterilizuar, ose një vinç mekanik tërheqës për ndihmë në raste pjelljeje të vështira.
- ◆ Kordoni i kërthizës të pastrohet me alkool ose jod.
- ◆ Të përgatiten kova me ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë.
- ◆ Ndhimja e tërheqjes bëhet vetëm 1 deri në 2 orë pas plasjes së qeses amiotike.
- ◆ Para së të përdoret ndihma me tërheqje, të kontrollohet pozicioni i viçit me duar të pastra ose më mirë akoma me doreza veterinare.
- ◆ Të pozicionohet me kokë dhe këmbë në dalje, të tërhiqet vetëm në intervalet e kontraktimeve.

Masat që duhen marrë pas pjelljes:

- ◆ Të bëhet fshirja dhe tharja e viçit.
- ◆ Lëpirja e lopës stimulon qarkullimin e gjakut të viçit, një ndihmesë e rëndësishme për vitalitetin e viçit.

- ◆ Dezinfektimi i kërkthzës me spray blu, jod dhe alkool.
- ◆ Freskimi i kokës së viçit me ujë.
- ◆ Të pastrohen dhe të thahen sekrecionet e gojës dhe të hundës.
- ◆ Kulloshtra vlen si ushqim ashtu edhe si mbrojtje. Viçi duhet të konsumojë kulloshtrë menjëherë brenda 3 orëve pas lindjes për të forcuar sistemin imunitar dhe sidomos për t' u mbrojtur nga mikrobet patogjene.
- ◆ Mbetjet e plaçentës duhet të largohen plotësisht pas 4-18 orësh.

Një plan i mundshëm i rritjes së viçave, kur viçat do të mbahen për remont:

Nga dita 1–3	Të ofrohet kulloshtrë të paktën 3 herë në ditë.
--------------	---

Deri në ditën e 7	Të rritet sasia konsumit të qumështit në rreth 6 l/ditë ose viçi të pijë nga lopa.
-------------------	--

Vëzhgime të sakta

Java e 2-të	6-8 l qumësht /ditë Të fillohet me koncentrat të freskët për viça – çdo ditë.
-------------	--

Java e 3-të	6-8 l qumësht /ditë Koncentrat për viça të freskët / sanë cilësore – çdo ditë.
-------------	---

Java e 4-të	6-8 l qumësht /ditë Koncentrat dhe sanë gjithmonë të freskët.
-------------	--

Java e 5-të	6-8 l qumësht /ditë Koncentrat dhe sanë, mundësisht silazh cilësor të freskët.
-------------	---

Java e 6-të	6-8 l qumësht /ditë Koncentrat, sanë dhe silazh cilësor gjithmonë të freskët.
-------------	--

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

9.MASTITI -NJË SËMUNDJE MULTIFAKTORIALE

Përpunuar nga Kristian Maka

Hulumtimi i shkaktarit të mastitit nuk duhet të kufizohet vetëm në procesin e mjeljes...

Një kusht i detyrueshëm për trajtimin afatgjatë dhe të suksesshëm të mastitit është analiza gjithpërfshirëse dhe e detajuar për të eliminuar të gjitha mangësitë e mundshme.

Numri i lartë i qelizave somatike dhe inflamacioni i vazhdueshëm i gjirit janë për fat të keq një pjesë e përditshmërisë së shumë fermave. Mastiti nuk është një "sëmundje profesionale" e pashmangshme te lopët, por mund të vendoset nën kontroll dhe në tufat me probleme të mëdha të numrit të qelizave somatike. Si fillim, e rëndësishme është të gjenden shkaqet dhe shkaktarët.

Mjelja nuk është gjithçka...

Ambjenti ku rrinë lopët duhet analizuar periodikisht Meqënëse shkaqet e infeksioneve të gjirit janë jashtëzakonisht të ndryshme, mastiti është cilësuar si një „sëmundje multifaktoriale“.

Zakonisht numri i lartë i qelizave somatike është lidhur gjithmonë me sistemin e mjeljes. Nuk është çudi:pothuajse asgjë nuk ka një efekt kaq të drejtpërdrejtë në strukturën e indit të gjirit se sa mjelja disa herë në ditë. Megjithatë përfundimi se shkaktari kryesor është procesi i mjeljes nuk është i mjaftueshëm. Të ushqyerit, uji dhe kërkesat e mirëmbajtjes së stallës duhen të kontrollohëntërisht, sepse problematikat më të vogla që mund të hasen ndikojnë në shëndetin e gjirit po aq shumë sa edhe gabimet në teknikat e mjeljes.

Në rritjen e papritur të numrit të qelizave somatike ndikojnë silazhi pak i prishur, acidoza e lehtë e rumenit si dhe sasia e pamjaftueshme ose cilësia jo e mirë e ujit të pijshëm. E njëjta gjë vlen edhe për higjienën e dobët të stallës, e cila është shkaktare e rritjes së rrezikut nga infeksionet.

Në analizën e përcaktimit të shkakut duhet të përfshihen cilësia e ushqimit, kushtet fizike të lopës, rezultatet e provës së qumështit, ajrosja, drita, dhe pastërtia nëstallë. Përveç këtyre, duhet patur parasysh mungesa e profesionalitetit në teknikat dhe proceset e mjeljes. Mes faktorëve të ndryshëm dhe ndërveprimeve komplekse është shumë e vështirë të përcaktohet një shkaktar i vetëm.



Fig. 1: Hiperkeratoza: shenja të dukshme të stresit të tepruar të indeve dhe fillimit të mastitit.

Po cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në shfaqjen e sëmundjeve të gjirit gjatë procesit të mjeljes?

Gjendja e keqe e thithave: Kritike këtu janë forcimi i pjesës së sipërme të thithave dhe në veçanti dëmet e dukshme tek indet në formën e të ashtuquajturës hiperkeratozë (unaza të bardha dhe shpesh të çara të indit të gjirit në afërsi të majës së thithës). Të dyja janë të lidhura ngushtë me reduktimin e barrierave ndaj infeksioneve, duke favorizuar shfaqjen e mastitit.

Një arsye për këtë janë gominat e dëmtuara të makinerisë së mjeljes, të cilat nuk mbyllin plotësisht midis proceseve të mjeljes dhe mikrobet mund të depërtojnë lehtësisht në kanalet e qumështit.

Në rastin e hiperkeratozës, mikrobet dhe papastërtitë e mbledhura e bëjnë pastrimin thithës pothuajse të pamundur duke shkaktuar edhe tkurrjen e kanaleve të thithave. Prandaj edhe rasti më i lehtë i hiperkeratozës rrit mundësinë e shfaqjes së mastitit me 20-40%. Si pasojë për hiperkeratozën nuk ekziston një prag tolerance i qartë. Po kështu edhe thënia që hiperkeratozat janë "reagime të pashmangshme dhe të natyrshme nga përdorimi i makinerive të mjeljes" është e gabuar.

Zbraza e paplotë e gjirit: Pothuajse çdo fermer e di se një mjelje e mirë parandalon infeksionet e gjirit dhe përshpejton aftësitë shëruese kundrejt sëmundjeve ekzistuese. Ky vëzhgim është shkencërisht i vërtetuar dhe bazohet në faktin që me pjesën e mbetur të qumështit ngelen lëndë ushqyese dhe në disa raste patogenë të caktuar. Prandaj, shkencëtarët këshillojnë të kufizohen sasi të mbetura të qumështit në rreth 300 ml / lopë, pasi një mjelje e mirë ndikon pozitivisht mbi persistencën dhe kështu në prodhimin e qumështit.

Transmetimi i patogjenëve: Para dhe gjatë mjeljes, mikrobet patogjene transmetohen në mënyrë të përsëritur midis gjirit të lopës dhe lopëve të tjera të tufës. Përhapja e infeksioneve ekzistuese të gjirit brenda tufës pengon rehabilitimin e tufave të sëmura. Arsyet qëndrojnë vetëmte pajisjet e mjeljes të papastruara, por edhe te mangësitë në rutinën e mjeljes.

KONTROLLI I DETAJUAR I KONDICIONIT TË GJIRIT

Për shkak të korrelacioneve të mësipërme, para së gjithave duhet të inspektohet shumë afër thitha gjatë procesit të mjeljes. Ndër të tjera, kur lopa hyn në dhomën e mjeljes duhet kontrolluar nëse thitha është e papastër apo e lagësht. Ky është një tregues i qartë i mungesës së higjienës së stallës. Pastrimi i thithave para mjeljes është thelbësor. Një lopë e shëndetshme dallohet në bazë të majës së thithave, të cilat duhet të jenë të buta dhe pa hiperkeratozë.



Fig. 2: Shumica e gjinjëve pas mjeljes janë ende të fryrë dhe të fortë, që tregojnë nxjerrje jo të plotë të qumështit

ka kuptim të specifikohet sa përqind e thithës mund të ketë dëmtim të indeve, sepse thithat e forta dhe hiperkeratozat janë shpesh të dëmshme, por gjithmonë të shmangshme.

Për më tepër, sjellja e kafshëve duhet të përfshihet në analizë. Duhe patur kujdes kur lopët nuk janë të qeta (për këte jo gjithmonë janë përgjegjëse mizat). Sidomos në fermat me kullotje, gjatë verës, ka gjithmonë probleme. Kujdes duhet patur edhe gjatë dimrit, sepse nëse lopët nuk janë të qeta, gjithashtu rezulton se pas mjeljes fundet ethithave janë të shtypura, të çngjyrosura apo kanë formuar unaza, atëherë kemi të bëjmë me një mjelje agresive dhe rrezikim të shëndetit të gjirit.

KONTROLLIMI I SHKALLËS SË MJELJES

Sigurohuni që gjatë kontrollit, gjiri pas mjeljes të jetë i butë. Nëse janë shumë të mëdhenj, jo të butë ose të fryrë, ekziston mundësia e nxjerrjes jo të plotë të qumështit. Një tjetër tregues i përbashkët i zbrazjes jo të plotë janë edhe rrjedhjet e qumështit pas mjeljes. Me teknikat e duhura dhe me rutinën e duhur mund të përftohen rreth 300-500g qumësht për lopë. Mund të përftohen nga 100 g (për gjinj të njëtrajtshëm dhe kompakt) deri në 2 kg qumësht.

Sipas studimeve, në vitin 2009 lopët me "performancë të lartë" kanë pasur një rritje shumë të vogël të "post-mjeljes" në krahasim me vitet 1990. Në përputhje me rrethanat, në 38% të gjirit ka "sasi të mbetura të qumështit" prej më shumë se 500 g, pavarësisht nga shpeshtësia e mjeljes (dy ose tri herë në ditë). Duhet patur parasysh se për shëndetin e gjirit dhe prodhimin të qumështit janë të rëndësishme sasia e mbetur deri në 300 g për lopë si dhe teknikat e mjeljes.

TEKNIKAT E MJELJES

Për të patur një analizë sa më të qartë të shkaqeve të sëmundjes së gjirit, duhet kryer një kontroll i plotë i teknologjisë së mjeljes. Një teknikë e mirë mjeljeje kërkonjo vetëm pajisjet e duhura matëse, por edhe njohuri të gjera të specializuara që shkojnë përtej trajnimit të zakonshëm të teknikëve të pajisjeve mjelëse.

Në fillim bëhet një kontroll i pajisjes së mjeljes sipas përcaktimeve të ISO 6690. Përveç pulsatorëve duhen testuar normat e rrjedhës së ajrit dhe kushtet e vakumit në tubacionet e mjeljes. Nëse një impiant mjeljeje e kalon këtë provë do të thotë se ajo është në gjendje shumë mirë, por nuk do të thotë që ende nuk ka ndonjë problem ose kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në shfaqjen e mastitit.

Së pari kufijtë e standardit përfaqësojnë vetëm kërkesat minimale, të cilat janë shpesh herë të pamjaftueshme. Dhe së dyti, shumë parametra të rëndësishëm në një ekzaminim të tillë standard ende nuk janë hetuar. Kështu, në provat për vakumin është vetëm sistemi i përgjithshëm në ciklin e thatë, por nuk e shqyrton vakumin në rrjedhën e qumështit. Megjithatë, sipas ISO testimi është i nevojshëm, pasi ai provon funksionet themelore të sistemit të mjeljes.

NJË KONTRROLL I PLOTË I IMPLEMENTIMIT TË SISTEMIT TË MJELJES KONSISTON NË:

- ♦ Kushtet higjienike: Linjat e qumështit dhe vakumit si dhe pajisjet e mjeljes duhet të jenë plotësisht të pastra dhe pa erë para mjeljes. Pajisjet e mjeljes nuk duhet të jenë të kontaminuara nga jashtë.
- ♦ Veshjet: Në vecanti gominat, si dhe tubat e qumështit duhet të kontrollohen për çarje apo deformime.
- ♦ Makineritë stimuluese: Këto duhet të punojnë me një kohë të limituar dhe gjatë stimulimit në sasi shume të vogla. Vetëm atëherë, bashkë me qirimimin e dëshiruar të oksitoksinës, kemi një arritje të "ajrosjes së thithës" (zgjerimi i kanaleve të qumështit dhe fryrjes së thithave).
- ♦ Kupat e mjeljes: Kupa e mjeljes duhet të vendoset poshtë gjirit, në të kundërt thithat do të përthyhen dhe do të provokohet hyrja e ajrit. Kjo rezulton në një dëmtim në rrjedhjen e qumështit dhe rrezik të transmetimit të patogjenëve.



- ♦ Vakumi i thithës: Gjatë fazave të thithjes, vakumi duhet të jetë kryesisht i pavarur nga rrjedhja e qumështit dhe për lopët duhet të jetë rreth 38-40 kPa. Vlerat më të ulëta zvogëlojnë shpejtësinë e mjeljes, rezultati: derdhja e qumështit ndodh në gjinjtë e mbushur shumë (p.sh. lopët të cilat milen „vetëm“ dy herë në ditë) për shkak të kohëzgjatjes së veprimit të oksitocinës të kufizuar dhe jo të plotë. Një vakum shumë i lartë, dëmton indet thithëse dhe rrit "post- mjeljen", pra sasinë e "qumështit të mbetur" në sternate gjirit. Në fazën e shkarkimit vakumi thithës duhet të reduktohet në mënyrë selektive nën 20 kPa, sepse thithja e vazhdueshme e bërë nga pajisjet standarde ngarkon indet e thithës si dhe ndikon në ndjeshmëri dhe dëmtimi i indeve.
- ♦ Gominat: Përmasat e tyre duhet të përputhen me madhësinë e thithave të tufës sepse përmasa shumë të ngushta ose shumë të shkurtra pengojnë rrjedhjen e qumështit. Gominat duhen kontrolluar nëse kanë fleksibilitetin e duhur për trashësinë e thithave dhe nëse zgjatja e materialit është e mjaftueshme për hapje të shpejtë dhe masazhimin e nevojshëm të thithës.
- ♦ Heqja e aparatit të mjeljes: Procesi duhet të jetë i zhvilluar sic duhet dhe hermetik. Mjelja e verbër (epakontrolluar) është një nga shkaqet kryesore të kushteve të këqia të thithave. Inspektimi vizual është më i rëndësishëm se kufijtë e vënë në makineritë e mjeljes. Duke humbur peshë më shpejt p.sh. gjatë një rrjedhjeje qumështi prej 500g në vend të 200-300 g/min. Në të njëjtën kohë rriten dhe sasinë e mbledhura të qumështit. Si qëllim duhet të jetë mjelja e butë në mënyrë që gjithçka të shkojë pa shqetësime.

Për gjëndjen shëndetësore jo normale të gjirit është shkaktare jo vetëm teknologjia e mjeljes, por edhe përdorimi i saj në mënyrën e duhur. Kryesore është njëhigjienë e mirë si p.sh. larja e duarve përpara procesit të mjeljes, përdorimi i dorezave (nga duart mikrobet arrijnë tek thitha), mjelja e parë (e pasur me mikrobe), depozitat e qumështit dhe një larje dhe dezinfektimi i gjirit me copa të pastra, të lagështa, të vecanta për çdo lopë.

Më pas duhet kontrolluar nëse gjiri është përmirësuar, me përjashtim të rasteve të makinerive stimuluese. Kur lopët të jenë gati për mjelje, pajisjet duhen vendosur në mënyrën e duhur pa patur hyrje të ajrit. Në fund të procesit të mjeljes duhet kontrolluar pjesa e mbetur e qumështit. Në rast të heqjes manuale, hyrja e ajrit duhet të shmanget. Pas heqjes së pajisjes, është e rëndësishme pastrimi dhe dezinfektimi, të paktën pas mjeljes së lopëve me sëmundje akute ose kronike të gjirit. Praktika e spërkatjes duhet të praktikohet pothuajse kudo, duhet të përdoren mjete që e mirëmbajnë gjirin dhe nuk e thajnë shumë. Kritike janë shpesh produktet që përmbajnë jod me një përmbajtje shumë të vogël zbutësish (p.sh. glicerina). Lani ose spërkatni kupat e thithjes me një dezinfektant që vepron menjëherë.



DEFEKTE TË PËRGJITHËSISH TË RIPARUESHME

Analizimi i mirë dhe i plotë është i dobishëm vetëm nëse mangësitë e identifikuar korrigjohen vazhdimisht dhe plotësisht. Masat individuale nuk kanë sukses, nëse mangësi të tjera të ngjashme vazhdojnë të jenë prezente. P.sh. edhe pse gominat e papërshtatshme ndryshohen dhe rrjedha ndërpritet, hiperkeratozat do të vazhdojnë të jenë prezente, në qoftë se gjinjtë gjatë fazës së çlirimit janë ende të ekspozuar ndaj një thithjeje të vazhdueshme.

Eliminimi i të gjitha mangësive dhe problemeve është një parakusht i domosdoshëm për një përmirësim të qëndrueshem të shëndetit të gjirit.

Përvec kësaj, kërkohet një trajtim sistematik të gjinjve të sëmurë si dhe identifikimin e patogjenit që ka shkaktuar sëmundjen në mënyrë që të kontrollohet (ekzaminime bakteriologjike). Pas trajtimit, sukcesi i tyre është që të testohet dhe të lidhet me një shtesë ose përsëritje. Nëse trajtimi është i pasuksesshëm, lopët e sipërmendura duhen hequr sa më parë nga tufa, duke përfshirë dhe atotë cilat janë klasifikuar me një sëmundje kronike të gjirit.

PËRFUNDIMI

Meqenëse sëmundjet e gjirit shkaktohen nga një sërë faktorësh të ndryshëm, është i nevojshëm kontrolli pas mjeljes i gjirit të lopës, kontrolli i pajisjeve dhe impianteve të gjirit.

Duhet t'i kushtohet vëmendje higjienës dhe mirëmbajtjes së stallës, të ushqyerit dhe ujit.

Pas mjeljes kryesore është që mos të ketë qumësht të mbetur në gji (maksimumi 300g) dhe indi i gjirit të mos dëmtohet, në mënyrë që gjiri të jetë i butë dhe pa hiperkeratozë.

E rëndësishme është edhe njohuria profesionale që duhet të kenë personat që kryejnë procesin e mjeljes.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

10. PARANDALIMI I SËMUNDJEVE TE VIÇAT FILLON QË ME DHËNIEN E KULLOSHTRËS

Përpunuar nga Kristian Maka

Kujdesi i duhur ndaj viçave, që në lindje, është hapi i parë për një mbarështim të suksesshëm.

Veterineri Mag. Kritzinger nga SCHAUMANN Austrithekson dhënie e qumështit në kohën e duhur për një fillim të duhur jete. Brenda 2 orëve duhet që viçat të konsumojnë rreth 3-4 litra qumësht.

Cilësinë e kulloshtres nuk e dallon nga ngjyra, por nga qëndrueshmëria dhe jo çdo lopë ka gjithnjë një cilësi të mirë të kulloshtres. Për këtë duhet gjithmonë paraprakisht të ketë rezervë nga lopët, që kanë patur cilësi të lartë të kulloshtres. Diarreja, sipas Kritzinger, është ndër problemet e para madhore te viçat. Identifikimi në kohë, dhënia e elektrolitëve si pije midisvakteve me qumësht janë masa të rëndësishme për ndalimin e diarresë te viçat. Ai sugjeron planin e mëposhtëm të ushqyerjes, i rekomandueshëm për viçat me diarre.

Diarreja te viçat me moshë më të madhe (mbi 2 javë) lidhet me faktorë patogjenë specifikë, si koksidia. Këtu është shumë e rëndësishme procesi idezinfektimit. Për të luftuar koksidian ekzistojnë mjete të posaçme dezinfektuese.

Racioni me lëndët e thata për viçat

Këshilltari i SCHAUMANN dhe Austria Praemix shpk, Ing. Franz Riegler tregon mbi eksperiencën e tij nëpërdorimin e lëndës së thatë për viçat.

MOS PËRZIENI APO HOLLONI QUMËSHITIN!

Zakonisht zhvillimi në kohën e duhur i rumenit është treguesi më i mirë për majmëri dhe mbarështim. Nëpërmjet përdorimit të koncentratit të viçave ose TMR e viçave me 25% përmbajtje bar nxitet pozitivisht zhvillimi i rumenit. Franz Riegler parashtron avantazhet e Kälber- TMR në fermën e tij, përkatësisht procesin konkret të përzierjes, magazinimit dhe ushqyerjes. Me një përzierje prej 800 kg sanë dhe 40 kg melasë, ai mund të ushqejë viçat e tij për 2 muaj. Ai e ka përdorur që prej gjashtë muajsh këtë përzierje dhe është shumë i kënaqur me zhvillimin dhe rendimentin e viçave.



Plani për viçat me diarre

Në mëngjes 1,5 – 2 litër qumësht

Paradite 1 - 1,5 litër elektrolit

Në drekë 1,5 – 2 litër qumësht

Pasdite 1 - 1,5 litër elektrolit

Në darkë 1,5 - 2 litër qumësht

Në darkë vonë 1 - 1,5 litër elektrolit

Për më shumë informacion:

11. TRETJA NË RUMEN TE RIPËRTYPËSIT

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioneri i Austria Praemixshpk Përpunuar nga Kristian Maka




Fig. 1: Proteina krudo në rumen

Duke u bazuar në mënyrën e funksionimit të rumenit dalim në këto konkluzione:

- Energjia e mjaftueshme e marrë nga ushqimi është e nevojshme për tretjen e proteinave në rumen.
- Një racion për lopët e qumështi duhet të ketë një balancë ndërmjet përmbajtjes së energjisë dhe proteinave. Ushqimi energjik dhe proteinik duhet të jetë i balancuar.
- Tepërcat proteinike çojnë në mbingarkesë të mëlçisë dhe probleme të ardhjes në afsh.
- Vlera e pH në rumen nuk duhet të jetë shumë e ulët (idealja 6,5).
- E rëndësishme është prodhimi i mjaftueshëm i pështymës, e cila është e varur nga ripërthypja dhe nga struktura e ushqimit.
- Fibër (XF) në racion ushqimor: 18-22% XF lëndë e thatë në racion ushqimor nga të cilat 2/3 është e mirëstrukturuar (bar i prerë trashë)
- Përbërja e racionit të lopës në laktacion duhet orientuar në prodhimin e sasisë të qumështit.
- Lopët nuk duhet të humbin peshë në fillimin e laktacionit.
- Lopët, në fund të laktacionit dhe në periudhën e tharjes, nuk duhet të dhjamosen.
-

Sa më i lartë të jetë rendimenti i qumështit i një lope, aq më shumë sasi ushqimore dhe ushqim cilësor duhet të konsumojë. Lopët në tharje duhet të konsumojnë pak silazh misri dhe aspak koncentrat.

Përmbajtja e vlerave ushqyese të barit në masën e thatë:

900g masë e thatë	125-130g protein krudo (XP)
240- 280g fibër	5,7 MJ Nel (energji)

Njësitë ushqyese për llogaritjen e racionit ushqimor:

Energji: MJ Nel Mega Xhaul - qumështi nga energjia neto e racionit ushqimor

Proteina:

- nXP - proteina e disponueshme në zorrën e hollë
- gRP - proteinë krudo në gram
- RNB - bilanci i azotit në rumen

Fibër krudo: RFA ose XF

Çertifikatë analize

Lëndët ushqyese: (g/kg)	FM	TM
Masë e thatë	985	1000
TM	o.B.	o.B.
Protein krudo	o.B.	o.B.
XP	o.B.	o.B.
Protein krudo e përdorshme	o.B.	o.B.
nXP	o.B.	o.B.
Protein e papërpunuar XP o.B	o.B.	o.B.
UDP	o.B.	o.B.
Bilanz i N në rumen	o.B.	o.B.
RNB	o.B.	o.B.
Yndyrë krudo*	o.B.	o.B.
XL	o.B.	o.B.
Fibër	o.B.	o.B.
XF	o.B.	o.B.
Substancë e strukturuar (Shuma)		
NDF		
Celulozë dhe lignin		
ADF		
Lignin		
ADL		
Substanca pa N		
XX		
Amidon		
XS		
Sheqer		
XZ		
Hi		
XA		
Tretja e lëndës organike, %		o.B.
dOM		
Energjia e disponueshme, MJ	o.B.	o.B.
ME		
Energji neto, MJ	o.B.	o.B.
NEL		

Mikroelementë: (g/kg)	FM	TM
Kalcium Ca: P = 15,25: 1	6,1	6,2
Ca	0,4	0,4
Fosfor	1,7	1,7
P	0,7	0,7
Magnez	337,0	342,1
Mg		

Elementët gjurmë: (mg/kg)	FM	TM
Hekur	o.B.	o.B.
Fe	o.B.	o.B.
Mangan	o.B.	o.B.
Mn	o.B.	o.B.
Zink		
Zn		
Bakër		
Cu		
Kalium K:Na = 0,0 :1		
K		
Natrium		
Na		

Vlera e sasisë ushqimore: përbërësit për çdo kg ushqim të freskët

Vlera e lëndës së thatë: përbërësit për çdo kg ushqim të thatë
(për krahasimin e ushqimit të kafshëve)

o.B. : pa rezultat (përbërësit nuk janë ekzaminuar)

* : Yndyrë krudo në ushqimin e gatshëm me acide shpërbërëse

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

12.MORTELLARO TREGUES I QUMËSHITIT

Përpunuar nga Kristian Maka

Nëse lopa çalon dhe performanca e saj bie ...

Mortellaro ka shenja shumë tipike. Ai prek kryesisht hapësirën interdigitale, këndin e pasëm të thundrës, pjesën e përparme ose bririn e thundrës. Shenjat klinike të sëmundjes shprehen me ndryshime në formacionin e thundrës, inflamacion të lëkurës, kryesisht në pjesën e pasme të thundrës. Pjesa e prekur e lëkurës në hapësirën ndërgrishtore me madhësi fillimisht disa milimetra deri në disa centimetra shprehet me degjenerim yndyror dhe nekrozë.

Vetëm pas pastrimit të plotë të zonave të dyshuara për infeksion, mund të identifikohen siç duhet pjesët e prekura. Pasi bëhet pastrimi i zonës së dëmtuar, fillojnë dhe dallohen zonat me sipërfaqe të irrituar, të kuqërremta, të inflamuar në formë luleshtrydhe (sëmundja e luleshtrydhes). Përveç këtyre shenjave klasike të sëmundjes, një shenjë tjetër është një formë e përhapur e ngjashme me lythat. Lopët që vuajnë nga Dermatiti Digital dhe kanë shenja çalimi të rënduar si pasojë e dhimbjes, duhen ekzaminuar dhe trajtuar.



CILËT JANË SHKAKTARËT E SËMUNDJES?

Ekzistojnë shkaqe të ndryshme të sëmundjes. Mikrobet janë të pranishme në sipërfaqen e lëkures ose në inde. Ato japin efektin e tyre kur lëkura është e paprekur ose e sapo dëmtuar nga mikrobet e pranishme. Ky ind përmban spirochetet. Këto janë baktere në formë helike, lëvizëse në mënyrë aktive. Në 90% treponemat përfaqësojnë pjesën më të madhe të patogjenëve të zbulueshëm si shkaktarë të Mortellaros. Prej tyre, tashmë janë identifikuar më shumë se 30 lloje të ndryshme, të cilat janë patogjene në shkallë të ndryshme. Këto baktere zhvillohen në lëkurë me një sipërfaqe të dëmtuar më parë dhe më pas mund të depërtojnë thellë në inde. Kështu që ato mbrohen relativisht nga masat e trajtimit sipërfaqësor të thundrave.

NGA GJENEZA E LINDJES SË SËMUNDJES DERI TE SHFAQJA E SAJ DHE EVIDENTIMI

Pasi infeksioni është prezent në stallë, përhapja e tij shpesh varet nga kushtet e mbarështimit, veçanërisht nga higjiena e stallës. Frekuenca e shfaqjes së sëmundjes varion nga një kafshë deri në më shumë se 50% të tufësë infektuar.

Shtimi i tufave është shpesh një detyrë e vështirë për fermerët. Diversiteti i madh i shkaqeve të shfaqjes së Mortellaros, favorizon përhapjen e saj. Kujdesi periodik, trajtimi i duhur, kushtet optimale të stallës (hapësira, drita, ajri, dyshemeja e stallës dhe higjiena e shtretërve) dhe të ushqyerit janë faktorët kryesorë që ndikojnë te Mortellaro.

KUJDESI EFEKTIV INDIVIDUAL PËR SECILËN KAFSHË

Sëmundja mund të mbahet nën kontroll nga një trajtim i shpejtë dhe efektiv për secilën kafshë. Për trajtimin individual të kafshëve, plaga duhet të pastrohet me letër të thjeshtë për pastrim ose me ujë të rrjedhshëm e më pas lihet të thahet.

Përdorimi i spray antibiotik ka avantazhe, sepse bën trajtim të thjeshtë dhe të shpejtë, me zero mbetje në qumësht, por antibiotiku në formë spray nuk arrin të eliminojë bakteret në indet e thella. Ky trajtim çon në një rritje të periudhës së eliminimit të sëmundjes. Fazat akute të sëmundjes mund të zhvillohen përsëri në çdo kohë. Rastet në shkallë të gjerë dhe kronike mund të trajtohen relativisht me sukses me pastën e aplikuar në hapësirën interdigitale me acid salicilik, siç është Novaderma.



Me këtë terapi arrihen që të asgjësohen dhe patogjenët në indet më të thella. Veshja e plagës nga jashtë është gjithashtu e efektshme. Aplikohet në leziona dhe fiksohet me fashë për dhjetë ditë. Avantazhi është një shërim i plotë dhe pa mbetje antibiotiku në qumësht.

Terapia e injektimit me antibiotikë është pak efektive, e shtrenjtë dhe duhet të kryhet mjaft gjatë për të parandaluar rezistencën mikrobiale në varësi të medikamenteve. Gjithashtu duhet marrë parasysh edhe periudha gjatë së cilës qumështi nuk mund të përdoret për shkak të mbetjeve të antibiotikut.

Përdorimi i xhelit me CU dhe Zn si Hoof- Gel, Claw-TopGel ka rezultuar gjithashtu i suksesshëm në praktikën e kujdesit të thundrave.

PARANDALIMI PËRMES MASAVE SPECIFIKE

Meqenëse sëmundja Mortellaro është një sëmundje e lëkurës, mbajtja e shëndetshme e lëkurës është primare. Higjiena, një objektivi i synuar dhe parandalimi i përsëritur, janë zakonisht më të rëndësishme sesa përdorimi i ilaçeve. Në çdo rast, veproni shpejt dhe përdorni vetëm metoda të testuara. Ndoshta duhet të mësojmë të jetojmë me sëmundjen e luleshtrydheve. Qëllimi duhet të jetë kontrolli më i mirë i mundshëm.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

13.VIÇA TË PËRGATITUR MIRË PËR STINËN E FTOHTË TË DIMRIT

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Jon Zeneli

Në fermat e prodhimit të qumështit, sëmundjet dhe humbjet e viçave ndikojnë negativisht në ekonominë e tyre. Kostot e larta për medikamente, kontrollet mjekësore dhe shpenzimet për përkujdesje çojnë në humbje të konsiderueshme financiare.

Edhe pse shkalla e sëmundshmërisë në muajt e ftohtë dhe të lagësht të dimrit rritet, kjo nuk do të thotë se është shkaku i vetëm i sëmundjes së viçave. Sëmundjet tipike sezonale janë ato të frymëmarrjes, sidomos gripi i gjedhit. Gripi është një faktor dytësor dhe prek më së shumti viçat e dobët dhe të prekur nga diarreja e hershme.


Shëndeti i mirë i zorrëve

Shëndeti i mirë i zorrëve është konsideruar si një themel i rëndësishëm për rritjen e suksesshme të viçave. Produkte me faktorin SSR (siguri/ shëndet/ rritje), të programit për viçat të Schaumann, mbështesin shëndetin e aparatit tre tës. Schaumann ofron një gamë të gjerë produktesh si zëvendësues të qumështit, komponentë dhe produkte speciale të cilat kanë si synim përmirësimin e shëndetit të zorrëve që në fazat më të hershme të jetës. Gripi i gjedhit shpesh herë shfaqet në moshën nga 4 deri në 8 javë. Në këtë periudhë viçat përballen me „Sistem imunitar të ulët“ (Fig. 1) e cila bëhet më e dukshme nëse janë bërë gabime në fazën e të ushqyerit me kullostër.

Furnizimi me kullostër me sasinë, cilësinë dhe kohën e duhur, është themeli bazë për rezistencën e viçit. Kulloshtra me një cilësi të mirë, përftohet vetëm nga lopët të cilat gjatë periudhës së tharjes janë ushqyer në mënyrë optimale. Përbajtja e imunglobulinës në kullostër dhe furnizimi i menjëhershëm pas lindjes me vitaminë A, përmirësohet ndjeshëm përdorimin e produktit Kalbi Vital dhe Kalbi Farm. Pas fazës së ushqyerjes me kullostër, pasurimi i qumështit në ditët e para me imunglobulin me veprim lokal, mund të sigurohet nëpërmjet produktit Kalbi-Start Super. Gjithashtu mund të përdoret dhe një zëvendësues qumështi si Kalbi Milch Plus Protect, me përbajtje të probiotikut Provita LE.

Plotësimi me energji

Gjatë ushqyerjes së viçave në stinën e dimrit shpesh herë anashkalohet fakti se temperaturat e ulëta rrisin kërkesën për energji. Nevoja për rregullimin e temperaturës mund të shkojë deri në 35%.



Zëvendësuesit e qumështit si Kalbi Milch Classic ose Kalbi Milch Plus Protect janë vetëm dy nga mundësitë e shumta që ofrohen për të përmbushur kërkesat në këtë situatë. Një rritje e sasisë nga 125 g zëvendësues qumështi/litër në 150 g/litër ose ushqime të lëngshme shtesë, mund të mbulojë nevojat shtesë të viçit.

Zëvendësuesit e qumështit me faktorin SSR përmbajnë kombinime të substancave aktive, të cilat mbështesin veçanërisht shëndetin e zorrëve. Probiotiku Provita LE, komponent me përbajtje fibrash speciale dhe acide yndyrore speciale, janë kombinime të testuara prej vitesh.

T'i kushtohet vëmendje klimës në stallë

Përveç motit të ftohtë, viçat përballen me kushte të tjera të këqija a si rryma e lartë e ajrit me nivele të larta të lagështisë. Situa të n e përkeqësojnë rrymat e ajrit në stalla me ventilim të gabuar ose mbyllja e të gjitha dyerve dhe dritareve, rritja e nivelit të gazra vetë dëmshme dhe lagështia e ajrit.

Mikrobet patogjene gjejnë kushte të përshtatshme për të dëmtuar viçat e pambrojtur. Gjatë stinës së dimrit duhet të merren masa të veçanta për procesin e rritjes. Ruajta e ambientit të thatë, të pastër, ruajtja nga korentet e ajrit, ja në disa nga pikat kyçe që duhet t'i kushtohet vëmendje në këtë periudhë delikate për viçin.

Këto janë vetëm disa nga sfidat që përballen fermerët në stinën e dimrit dhe që mund të kompensohen nga viçat e shëndetshëm deri në një gradë të caktuar. Produktet e Schaumann ndikojnë pozitivisht në shmangien e diarresë në viçat e vegjël dhe ndihmojnë fermerin të rrisë viça të shëndetshëm.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk
Tel: +355 (0)68 402 6311
e-mail: agri@ap.com.al
Website: www.ap.com.al

14. MUNGESA E SELENIT

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Jon Zeneli

Cili është suplementi më i mirë për t'a shmangur?

Mungesa e selenit mund t'i sëmurë shumë kafshët, prandaj duhet treguar kujdes ndaj formave të ndryshme të selenit. Lopët mund t'i përthithin dhe shfrytëzojnë ato në mënyra të ndryshme.

Ashtu si fosforin dhe magnezin, edhe selenin e gjejmë në formë organike dhe inorganike. Format inorganike përfaqësohen nga seleniti i natriumi (Na₂SeO₃) dhe selenati i natriumi (Na₂SeO₄), si edhe forma e selenit organik (procesi i fermentimit të "Sakarose Ceravitaë").

Është e rëndësishme që fermeri të dijë se cilat nga këto forma janë më efektive. Në treg ekzistojnë përzjerjemineralesh, si dhe suplemente me një nga këto forma ose edhe me kombinimin e të trejave, si rezultat i përdorimit të ndryshëm.

Për shembull, seleniti i natriumit reduktohet në rumen dhe kafsha mund të përthithë vetëm 50% të sasisë së marrë, pjesa tjetër eliminohet me jashtëqitjen. Nga ana tjetër, seleniti i natriumit me mbrojtje ndaj rumenit, del i pandryshuar nga rumeni dhe mund të përthithet nga zorra e hollë.

Edhe seleni organik në formën e majasë mund t'a kalojë këtë vështirësi dhe ka gjithashtu efekte shtesë, pasi seleni në sasi të lartë transferohet nëpërmjet placentës te viçi i palindur dhe mund të merret më vonë edhe nëpërmjet qumështit.

Studim me tre grupe

Në një studim në terren në kuadër të një teme diplome në universitetin e Hohenheim-it, u studiua ndikimi dhënies së selenit tek lopët e qumështit në rrethin e Ansbach (D).

Eksperimenti zgjati nga data 1 Dhjetor 2011 deri në 15 Mars 2012 dhe filloi me një fazë sinkronizimi, gjatë së cilës të gjitha fermat përdorën vetëm selenit natriumi si burimin e vetëm të selenit. Më pas 15 tufat u ndanë në 3 grupe, Grupi 1 "inorganik"- selenit natriumi, Grupi 2 "inorganik"- selenit natriumi me mbrojtje ndaj rumenit dhe Grupi 3 "organik"- maja seleni Sel-Plex® (Alltech). Sasia standardee suplementit ishte 0,3 mg selen për çdo kg racion të përzjerë, dhe sasia e suplementit u përcaktua në përputhje me racionin përkatës së bashku me ushqimin me minerale. Ajo që përbënte interes për këtë studim, ishte përmbajtja e selenit në mostrat e gjakut dhe të qumështit, si dhe aktiviteti i enzimës (Glutathione Peroxidase GSHPx) në gjak nga 10 kafshë për çdo fermë nga fillimi deri në fund të studimit.

Majaja e selenit shfaq përmbajtjet më të larta.

Analiza e të dhënave në përfundim të këtij studimi tregon ndryshime domethënëse ndërmjet këtyre tre suplementeve (shih tabelën). Midis dy suplementeve inorganike kishte ndryshime të dukshme: tek seleniti i natriumit me mbrojtje ndaj rumenit u vu re një sasi më e madhe e selenit në gjakun e plotë dhe në plazmën e gjakut, si dhe një aktivitet i lartë i enzimës në krahasim me selenitin e natriumit. Suplementi organik shfaqti sasi më të larta tek të gjithë parametrat e matur në krahasim me variantet inorganike të selenit, pasi rritja e vlerave në gjak, plazmë dhe qumësht ishte shumë e lartë. Përveç kësaj, megjithëse fermat pjesëmarrëse kishin arritur një status të lartë të selenit që para studimit, ndryshimet midis suplementeve të selenit ishin të dukshme.

Vlerat mesatare dhe rëndësia statistike e parametrevë të studuar duke krahasuar tre grupe të trajtuara.				
Burimi i selenit	Përmbajtja e selenit në gjakun e plotë [µg/l]	Përmbajtja e selenit në plazmë [µg/l]	Aktiviteti i GSHPx U/g Hb]	Përmbajtja e selenit në qumësht [µg/l]
Inorganik: Selenit natriumi	189,8	73,9	279,8	0,0265
Inorganik: Selenit natriumi me mbrojtje ndaj rumenit (Sil Sel 1%, HGS)	231,6	88,6	311,6	0,0270
Organik: Maja seleni (Sel-Pflex®, Alltech)	255,3	107,9	321,6	0,0545

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

15.MBARËSHTIMI I VIÇAVE

Përpunuar nga Rexhep Peposhi



Shpesh dëgjohej nga fermerët e qumështit të ankohen, se në fermat e tyre lindin më shumë viça meshkuj se viça femra, të cilat lakmohen për remontimin e tufës.

Deri tani nuk mund të qartësohet, se pse është ndërruar raporti gjinor në këtë lloj ekstremi. Për këtë situatë ka një indikacion, se mungesa e gjurmëve të një elementi Mangan (Mn) shkakton problemin e moslindjes së viçave femra; ky element mund të ketë një rol të rëndësishëm. Tek tufat që përballen në situatën me mungesë Mangani ka ndër të tjera një rritje në lindshmërinë e viçave meshkuj (me 75%). Konteksti i saktë fiziologjik mbi këtë fakt nuk është ende i qartë, sidomos pasi pak ferma rrisin dema në ditët e sotme. Megjithatë dihet, se mungesa e manganit tek kafshët femra përgjithësisht çon në çrregullimin e pjellorisë – ndeshen shpesh afshe të fshehura, përqindje të ulëta të fekondimit, aborte, ciste ovarian dhe endometrite. Për më tepër, shpesh herë lindin viça të ngordhur, ose viça me jetëgjatësi të ulët me gjymtyrë dhe tendinatë shkurtuara.

Mungesat e theksuara të manganit mund të reduktohen ndër të tjera nëpërmjet ushqimeve që përmbajnë sasi tëduhura minerale. Shpesh mungesa të theksuara sekondare janë shkaktare të problemit. Një mungesë sekondare mund të jetë gjithashtu nga furnizimi i pamjaftueshëm i tokës me mangan, për shkak të rritjes së pH, ulet absorbimi i manganit nga bima, si pasojë mangani nuk është më i disponueshëm për bimën. Në këtë rast duhen përdorur plehra kimike me bazë acidike. Për më tepër, dihet se absorbimi i manganit të kafsha përkeqësohet në varësi të raportit të gjerë të kalçium / fosforit në racion (më shumë në racionin e lëndës së thatë).

Sidoqoftë, duhet patur parasysh dhe furnizimi me ujë të pastër, këshillojnë ekspertët. Në qoftë se furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nëpërmjet një burimi të përbashkët apo një pusi privat, zakonisht uji i pusit ka dhe përmbajtje të lartë të hekurit, nga ana tjetër hekuri është një antagonist i manganit. Edhe në furnizimin optimal, sipas kërkesave tëorganizimit me mangan, në ushqim mund të shfaqen mungesa sekondare mangani si shkak i ndërveprimit hekur- mangan.

Nëse ky raport anormal gjinor i viçave të sapolindur, në kohët e fundit, vjen si rezultat i mungesës së manganit, kjo gjë duhet të verifikohet dhe analizohet nga veterineri nëpërmjet analizave laboratorike.

Kalcinosa, një problem i furnizimit me lëndë minerale?

Kushtet me të cilat po përballlet prodhimi i produkteve blegtorale, i detyrojnë fermerët që të shfrytëzojnë të gjitha burimet e mundshme në fermë, për të ulur në vazhdim kostot e prodhimit/kg të qumështit. Përveç rritjes sërendimentit të prodhimit të qumështit ose shfrytëzimit të kapacitetit gjenetik duhet të merren të gjitha masat që lopët të ushqehen në mënyrë të shëndetshme dhe produktive. Sëmundjet sjellin uljen e rendimentit dhe rritjen e kostove e kështu shkaktojnë dëm ekonomik.

Një nga sëmundjet që shfaqet shpesh në disa vende është Kalcinosa. Kjo sëmundje, e cila kur nuk trajtohet në kohë, çon në një ulje të rendimentit dhe deri në therrje të sforcuar, dhe pasoja është dëm i konsiderueshëm ekonomik. Në artikullin në vijim do të jepen informacione më të detajuara mbi këtë sëmundje.

SHKAQET:

Kalcinosa shkaktohet nga përmbajtja e lartë me tërshërë në ushqimin voluminoz (foragjere). Tërshëra kultivohet më së shumti në lartësitë nga 700 deri në 800 m mbi nivelin e detit, për këtë arsye fermat, që janë të vendosura në këtë lartësi, u duhet të luftojnë më shumë me problemin e kalcinosës. Në parim tërshëra është një foragjere me shumë vlerë. Ajo parapëlqen toka të pasura, mesatarisht të lagështa, e të pasura me gurgëlqeror. Disavantazhi i tërshërës qëndron në faktin se përmban një substancë të ngjashme me vitaminën D, që çon në një disbalancë; përkatësisht në prishjen e balancës së lëndëve minerale.

Kështu, mineralet Kalcium (Ca), Fosfor (P) dhe Magnezium (Mg) absorbohen në masë të madhe, dhe nxjerrja e tyre nga organizmi kufizohet vetëm nëpërmjet fekaleve dhe urinës. Në varësi të sasisë dhe kohëzgjatjes së ushqyerjes, mund kalohej në shkallë të ndryshme të kalçifikimit.

Së pari dhe më kryesoret janë kockat dhe kyçet, por preken edhe enët e gjakut, si dhe organet si: zemra, mëlçia, veshkat dhe mushkrittë, që do të thotë kalimi në një kalçifikim masiv i organizmit.

Kafshët bien në peshë, kanë një pamje të dobësuar dhe pak oreks. Lëvizjet e tyre bëhen më të rënda, ngritja në këmbë zgjat më shumë dhe shkakton dhimbje, gjë që dallohet tek një kuriz i harkuar. Në vazhdim kafsha dobësohet edhe më shumë dhe prodhimitaria e qumështit bie me shpejtësi. Në këtë fazë marrja e medikamenteve nuk çon në një zgjidhje të problemit, kështu që kafsha duhet të therret.




Fig.1 Lopë e prekur me Kalcinosë.

Masat ndaj Kalcinosës

Madje edhe nga një racion me 10 % tërshërë mund të shkaktohet Kalcinosë në rast tejzgjatjeje të përdorimit të ushqimit. Në një përqindje më të lartë duhet të llogaritet një shpërthim masiv i sëmundjes brenda një kohe shumë të shkurtër. Duke qenë se gjethet e tërshërës kanë një efekt më të lartë kalçinogjen se kërcelli, nëpërmjet kositjes së vonë reduktohet gjithashtu rreziku i sëmundjes. Nga ana tjetër, një masë e tillë mund të aplikohet vetëm për një periudhë të shkurtër. Për të ekuilibruar përqindjen e tërshërës me kullota, duhet të kujdesemi për intensitetin e shfrytëzimit të tyre, i kombinuar me një plehërim optimal, përndryshe rezultojnë kullota me përbërje të reduktuar të tërshërës.

Efekti kalçinogjen i tërshërës bie gjatë konservimit, për këtë arsye kullotat e pasura me tërshërë duhet patjetër të silazhohen ose të përdoren si sanë. Përdorimi në gjendje të gjelbër, ose shfrytëzimi i kullotave është kategorikisht i përjashtuar.

Një tjetër mënyrë për të kufizuar konsumimin e tërshërës është nëpërmjet rritjes së përqindjes së koncentratës. Në këndvështrimin e furnizimit me mikroelementë duhet të përdoren përzierje me përqindje të ulët me Ca dhe P, si dhe të vitaminës D. Por nuk mund të pretendohet se një përdorim specifik i mikroelementeve do të parandalonte problemin ose të shëronte sëmundjen. I rëndësishëm është fakti se 1 kg tërshërë tejkalon dyfish nevojën e përditshme të një lope me vitaminë D. Për këtë arsye duhet të merren, mbi të gjitha, masa afatgjata kutivimi (rinovimi i kullotave nëpërmjet ri-mbjelljes ose pasurimit të vazhdueshëm me farë kultivimi) në mënyrë që të mbahet nën kontroll problemi i tërshërës.



Ndikimi i plehërimit dhe intensiteti i përdorimit të tërshërës te kullotat shumëvjeçare (n. Buchgraber und Pötsch, 1994)

Përmbledhje

Problemi i kalçinosës mund të zgjidhet nëpërmjet masave të kultivimit dhe teknikave të të ushqyerit. Me rëndësi është një intensiteti i përdorimit i përshtatshëm në përputhje me plehërimin, gjë e cila nuk është e mundur të aplikohet në ferma bio-organike ekstensive. Një përdorim si silazh ose sanë paraqet me pak rrezik të sëmundjes në vetëvete, se sa të ushqyerit si masë e njomë apo kullotë.

Kalçinosa- Cila është zgjidhja?

- Kalçinosa mund të shkaktohet nga përqindja e lartë e tërshërës në racion.
- Ca, P dhe Mg depozitohen në trup, ku më së shumti prekin gjymtyrët dhe enët e gjakut, si dhe zemrën, mushkrintë, mëlçinë dhe veshkat.
- Kafshët dobësohen, në vijim kanë një rënie masive të performancës – si pasojë këto kafshë përfundojnë në therrje të sforcuar.

- ♦ Përqindja e tërshërës duhet reduktuar nëpërmjet masave agronomike.
- ♦ Shfrytëzimi me intensitet të lartë të kullotës redukton përqindjen e tërshërës.
- ♦ Rezervat e pasura me tërshërë duhet të përpunohen në silazhe ose sane.
- ♦ Reduktimi i përmbajtjes së lartë të tërshërës në racion nëpërmjet rritjes së përdorimit të koncentratës.
- ♦ Racioni ushqimor në përputhshmëri me kërkesat e nevojshme për rendiment.
- ♦ Përdorimi i përzierjeve me përqindje të lartë të lëndëve minerale me përmbajtje të ulët Ca dhe P.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

16.TË PISH ME FAZA TË SHKURTRA

Përpunuar nga Rexhep Peposhi

Një zgjidhje e duhur për të rritur viçat është që të përkujdesesh për ata në mënyrë që të jenë jetëgjatë dhe të fortë. Në praktikë diçka mund të çalojë, pasi marrja e qumështit në vitet e fundit ka pasur një dobi të lartë.

Për të dhënë kujdesin e nevojshëm në pirjen e qumështit duhet që qumështi të zëvendësohet me atë të duhurin (MAT). Programi për dhënien e qumështit të viçat është i një cilësie të lartë MAT, duke i dhënë masën e duhur për një pirje intensive, të shkurtër në marrjen e përditshme të qumështit. Në këtë mënyrë bëhet e mundur marrja e ushqimit në sasi të mëdha e të hershme dhe është më e mundshme që të fillojë përtpjen me ritme të qëndrueshme.

Për një përkujdesje të nevojshme të viçit i duhet një zëvendësim i qumështit të duhur. Sa më i vogël të jetë në moshë viçi, aq më e mirë duhet të jetë përmbajtja në komponent dhe tretshmëria e qumështit pluhur. Për shkëputjen sa më të shpejtë të viçit nga qumështi pluhur, faktori i cilësisë është i rëndësishëm.

Metoda e shkëputjes së shenjtë nga qumështi

Përpara implementimit të kësaj qasjeje, marrja e ushqimit sa më shpejt është e mundur që të zhvillojë aparatën tretës. Së pari në këtë mënyrë garantohet që viçi pas javës të tetë të ketë qëndrueshmëri, pa patur probleme, e të ketë një rritje të qëndrueshme. Programi i qumështit për viçat Kalbi Milch CM ofron një cilësi optimale për një proces pirës të shkurtër dhe efektiv. Të dy produktet përmbajnë probiotik, Probiotiku LE kthehet në një mbrojtje shtesë tek viçit kundër bakteries E Coli (sëmundjes së diareisë). Qumështi i viçit AMS është me 45% pluhur qumësht të skremuar dhe origjina e burimit proteinik vjen nga burime shtazore. Tek të gjithë viçat e sapolindur është aplikuar kjo qasje, e në këtë mënyrë është parë një rezultat i suksesshëm.

Intensiteti i pirjes

Qëllimi i dhënies së qumështit në orare apo faza të caktuara ka si qëllim një shtim peshe maksimale. Kjo është baza për një ecuri të mirë, përafërsisht 15 muajsh, një peshë rreth 400 kg e cila është dhe pesha optimale përndërzim.

E rëndësishme është që përveç sasisë së duhur të qumështit pluhur, përgjatë fazës kryesore të pirjes (deri në fund të javës së 5-të) me 1 kg në ditë, duhet pasur kujdes edhe me dozimin e tij gjatë ofrimit tek viçi.

Një koncentrim prej 135 g qumësht pluhur për litër qumësht, është një masë e cila ka dalë nga vlerësimi i masës së thatë për litër qumësht lope. Masa 135 gr qumësht pluhur për litër qumësht të përgatitur është masa ideale. Përdorimi 160 gr për litër qumësht të përgatitur është provuarefektive mbas javës së 5-të të jetës, në këtë mënyrë shkëpusim viçin me 8 javë nga procesi i pirjes së qumështit. Kjo qasje është implementuar edhe në praktikë. Në Hülsenberg, në qendrën e hulumtimit Schaumann, ka vite që aplikohet.

Fillimi i përdorimit të koncentratit

Një shtim peshe maksimale (në 700 g në ditë) përgjatë periudhës së pirjes, bëhet vetëm duke plotësuar nevojat energjitike dhe proteinave, kjo arrihet vetëm nëse deri në fund të javës së 3-të të jetës aplikohet 6 litra qumësht lope ose 1 kg qumësht pluhur në ditë. Periudha e duhur e aplikimit të koncentratit është e rëndësishme për viçin. Për një zvillimin e rumenit është esencial përdorimi i koncentratit, i cili nëpërmjet reaksionit kimik prodhon acid prodioni dhe butirat. Në disa ferma të suksesshme po përdoret një praktikë me koncentrat të përgatitur nga Schaumann + ushqim voluminozi thatë i përgatitur nga Schaumann. Duke përdorur një ushqim me masë të thatëtë lartë, arrijmë të kemi një higjienë optimale dhe rrisim konsumin e ushqimit. Nga testimet e shumta të bëra në qendrën shkencore GUT Hülsenberg është vërtetuar një sukses i padiskutuar në mënyrën e rritjes së viçave. TMR- e thatë, TMR-ALFA me komponentë cilësorë në përmbajtje të koncentratit, e pasur me vitamina plus mikro dhe makroelementë, si dhe jonxhë cilësore të prerë imët, garanton një start të mirë të viçit në koncentrat. TMR ALFA duhet t'i ofrohet viçave sa më shpejt me parimin (të hanë sa të duan) dhe duhet të ndërpritet gradualisht duke zëvendësuar me koncentrat të përgatitur vetë gjatë periudhës së shkëputjes nga qumështi (8-9 javëshe). Një program dhe kombinim sa më të mirë e gjeni më poshtë.

Informacione shtesë apo mënyra mbi aplikimet mund t'i gjeni pranë këshilluesve të Austria Praemix shpk.

1 Pirja - dhe planifikimi i ushqimit për vëcat që rriten në fermë



Rritje e yndyrës tek qumështi

Problemet me rumenin ndikojnë në përmbajtjen e yndyrës në qumësht. Eksperienca e përdorimit të Rindamin BP katërguar që produkti jep rezultate pozitive, si substancë buferike që është.

Shpesh herë prodhuesit e qumështit e kanë të kufizuar mundësinë e të prodhimit të qumështit pasi hasin vështirësi të ndryshme. Për këtë arsye mundohen të prodhojnë qumësht cilësor në përmbajtje për të fituar të ardhura sa më shumë. Kjo varet 80 % nga përmbajtja e qumështit. Përbërësit e qumështit kanë shumë ndikim. Përveç një racioni ushqimor të balancuar, ndikojnë menaxhimi, gjenetika dhe mënyra e mbarështimit. Pavarësisht kujdesit të madh të fermerit, shpesh herë kemi të bëjmë me një luhajtje të përmbajtjes së qumështit në komponentë. Bazuar në shembullin e mëposhtëm, Rindamin BP ka treguar që ndikon pozitivisht në stabilitetin dhe zgjidhjen e problemeve.

Shembuj nga praktika:

-Një fermë me 350 lopë dhe me rendiment 8.600 kg qumësht kishte një situatë ushqimi të ndërlikuar. Përmbajtja e yndyrës së qumështit kishte rënë në mënyrë të ndjeshme dhe asnjë nga masat e marra nuk përmirësonte situatën. Bazë e problematikës ishte silazhi me cilësi të dobët, i cili kishte rritje të temperaturës dhe si pasojë kishte humbur në cilësi.


Duke e përdorur me 200 g Rindamin BP u mundësua që yndyra të rritej 0,1 – 0,15 %. Për më tepër, nga një vëzhgimi bërë, pati një përmirësim të situatës metabolike të lopës, dhe gjithashtu një rritje të rendimentit të qumështit, pa ndryshuar asgjë në komponentë.

-Në një fermë me silazh bari u rezultuan: 550 lopë me prodhimtari me 9.600 litra ishin në një gjendje të keqe pas një vere të nxehtë. Pas përdorimit të silazhit të ri u ul yndyra në qumësht në 3,5 – 3-6 %. Me gjithë masat e marra nuk kishte ndonjë arritje të dukshme. Nëpërdorimin e Rindamin BP me 150 g (grupi i dytë i laktacionit) deri në 250 g (grupi i parë i laktacionit) solli një sukses të dukshëm.

Përmbajtja e yndyrës rritet brenda 14 ditëve në 4%. Më vonë u bë matja e silazhit dhe u konstatua një përmbajtje prej 10% e acidit laktik në silazh. Kjo bëri që vlera e pH në rumen të ulej.

Nga substancat buferike efektive u bë i mundur balancimi i pH në rumen dhe në këtë mënyrë edhe përmirësimi i përmbajtjes së yndyrës.

Ky shembull tregon që Rindamin BP nuk mund të përdoret vetëm në verë për të shmangur acidozën por edhe në situata të tjera Rindamin BP është stabilizator i rumenit. Ai mund të përdoret gjithashtu si masë profilaktike në racion ushqimor për probleme të ndryshme të rumenit.



Zhvillimi i yndyrës dhe proteinës në qumësht, mbas përdorimit të RINDAMIN BP.

PËRMBLEDHJE

Për një cilësi të mirë të qumështit dhe një performancë të lartë në prodhim kërkohet një furnizim i mirë në lëndë ushqyese dhe burime energjitike nga një racion ushqimor i mirë balancuar. Rindamin BP ka treguar që në situata të veçanta problematikash të racionit ushqimor apo cilësi të dobëta të lëndëve ushqyese, mund të shmangë problemet në rumen dhe të rrisë vlerat në përmbajtjen e qumështit.

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

17. DIARRREJA E VIÇIT MUND TË PREKË TË GJITHË TUFËN

Përpunuar nga Rexhep Peposhi

Diarreja mund të prekë viçat e çdo moshe. Viçat e vegjël (me moshë nga 3 deri 4 javësh) sëmuren më shumë nga kjo simptomë, e më pas të gjitha kafshët e fermës mund të preken prej saj.

Një trajtim jo i shpejtë dhe efektiv, do të sillte ngordhjen e viçave ose viça me një sistem imunitar të ulët dhe nuk do të merrnin veten plotësisht. Për një fermë me viça të prekur nga diarreja nuk është vetëm problemi i shpenzimeve të shtuara financiare dhe kohore për furnizimin e kafshëve të prekura, por edhe ngordhja e viçave të shëndetshëm mund të shkaktojë dëme serioze afatgjatë.

Informacion i përgjithshëm

Diarreja shkaktohet nga shumë faktorë, të ilustruar në (Tab. 1). Pjesa më e madhe e këtyre faktorëve janë faktorë menaxherialë, (që nuk kanë të bëjnë me bakteret apoviruset) që lidhen direkt me përgatitjen e lopës për pjellje, (periudha e tharjes, vaksinimi i lopës).

- Mjedis i sterilizuar gjatë pjelljes
- Suport maksimal i veterinerit
- Dhënia e shpejtë e kulloshtrës viçit të porsalindur (të paktën 2 x 2 litra për 12 orët e para të jetës)
- Ushqyerja optimale duhet të përmbajë qumësht, ujë, bar dhe ushqim për viçat

Faktorë jo infektues=Faktorë menaxherialë

Përgatitjen e lopës për pjellje

- vaksinimi i lopës (E.coli, Rota- korona)
- periudha e thatë (kulloshtra)

Pjellja

- ambjenti i pjelljes së viçave duhet të jetë i pastër dhe i sterilizuar
- ndihma gjatë pjelljes me mjete të sterilizuara
- për vicat me problem, të ndahet menjëherë nga nëna

Përkujdesja për kulloshtrën

Stalla

- bokse individuale të pastruara dhe të sterilizuara deri në 3 javët e para të jetës
- pastaj mbledhje deri në 6 viça në grup.

Ushqyerja mbas fazës së kulloshtrës

- masa e duhur e qumështit është 12 % e masës trupore e ndarë në disa vakte
- maksimumi i qumështit për vakt është 2.5 litra
- qumështi të jepet me NUggi (ndihmon në refleksat e kanalit të faringut)

Ushqyerja

Rëndësi ka uji i pastër, qumështi, bari i freksët

Faktorë infektues

Viruset

- Rota
- Korona

Bakteret

Variacionet e bakterit E.koli

Parazitët

Kriptospori

Gjatë menaxhimit gabojmë, si për shembull: mungesa e dhënies së kulloshtrës në kohën e duhur viçave të vegjël ose dhënia me vonesë e saj, mungesa e higjienës janë nxitësit patogjenë që shkaktojnë diarrenë. Shkaktarët më të zakonshëm që shkaktojnë diarrenë të vicat javët e para të jetës janë viruse (virusi Rota - Corona), bakteret (variacione të shumta të E. Coli) dhe parazitët (Kriptosporidet). Të gjithë këta janë shkaktarët më të pranishëm, që janë shfaqur në kombinime të shumta nëpër ferma. Këta shkaktarë transmetohen zakonisht nga kafshët vjetra të seleksionuara për skartim ose nga viçat e tjerë të sëmurë me diarre që ua transmetojnë viçave të rinj.

Zhvillimi

Integriteti i zorrës së hollë dhe të trashë është i rëndësishëm për një tretje të mirë dhe një jashtëqitje normale.

Cipa e mukozës së zorrëve është e përbërë nga vile të panumërta që nga njëra anë ndërtojnë substanca, të cilat zbërthejnë lëndët ushqyese dhe nga ana tjetër asimilojnë këto lëndë ushqyese në organizmin tretës.

Në zorrën e trashë, këto vile përthithin lëngjet dhe kjo sjell një trashje të jashtëqitjes. Ky ekuilibër do të prishej nëse funksioni i mukozës së zorrëve do të prekej ose kur përbërja e zorrëve do të ndryshonte jashtë vleve të zorrëve, si rrjedhojë do të ndodhte një përforsim të fluiditetit në vend të përthithjes.

Kur këta shkaktarë patogjenë të lartpërmendur gjenden në zorrët e viçave, na çojnë në mekanizma të ndryshëm të diarresë. Bakteri E.coli prodhon një lëndë (toksinë) e cila mbërrin në qelizat e mukozës të zorrëve dhe ndikon në rritjen e fluiditetit tek zorrët. Virusi Rota- Corona dhe paraziti Kriptosporid, shkatërrojnë qelizat e zorrëve që sjell një zvogëlim dhe një reduktim të fluiditetit dhe të aftësisë së ruajtjes së vlerave ushqyese të ushqimit të tretur nga vilet. Këto procese të çojnë në një ndryshim të qëndrueshmërisë dhe të përbërjes së përmbajtjes së zorrëve.

Pavarësisht shkakut, kur viçin e zë diarreja humb shumë lëngje dhe elektrolite. Për sa kohë që viçat pijnë qumësht (kjo ndodh gati gjithmonë në fillim të diarresë), duhet që nevojat për lëndë ushqyese dhe energji për ndërtimin e indeve, si për shembull muskujt, të mbulohen nga një racion i plotë qumështi.

Kur gjendja normale e kafshës së prekur përkeqësohet dhe marrja e lëngjeve bëhet e pamjaftueshme, do të shfaqet një deficit në lëngje dhe dukshëm viçi do të sëmuret. Një diarre e vazhdueshme ndikon në lodhje, sytë mbyllen dhe këtë e tregon një ecje e lodhur ose fakti që ka pak ose fare refleksin e gjirit. Viçat, me diarre të një shkalle më të lartë mund të humbin deri në 15% të peshës së tyre trupore, domethënë një viç prej 50 kg peshë mund të humbasë 7,5 L lëngje. Kafshët e tilla gjithmonë kanë nevojë për trajtim nga ana e veterinerit: humbjet e lëngjeve, elektroliteve dhe ndryshimet e aciditetit të gjakut (acidozës) mund të zgjidhen vetëm me infuzione. Ardhja në ndihmë tepër vonë, shkakton ngordhjen e viçave.

Masat parandaluese

Më poshtë do të gjeni informacion rreth praktikave më të mira të trajtimit të trajtimit të diarresë. Në parim problemet e diarresë do të adresohen në dy nivele. Në nivelin e parë duhet që të merren masat që viçi ta marrë veten që të mos bjerë pre e shkaktarëve të diarresë dhe së dyti të mbahen shkaktarët sa më larg.

Një mundësi tjetër e nënvlersuar dhe pamjaftueshmërisht e përdorur për forcimin dhe mbrojtjen e viçit është furnizimi me kulloshtrë. Kulloshtra përmban në oret e para të mjeljes një lëndë mbrojtëse kundër shkaktarëve të infeksioneve. Këto antitropa merren në 24 orët e para të jetës dhe ndikojnë direkt në zorrë dhe në gjak duke rritur imunitetin mbrojtës të viçit nga infeksionet deri sa t'i krijohet sistemi imunitar aktiv. Mbas 24 orëve të para të jetës, këto antitropa nuk mund të arrijnë më në gjakun e viçit, ndonëse mund të neutralizojnë disa shkaktarë të ndodhur në zorrë.

PARIMET E KULLOSHTRËS

Sasia

- Minimumi 4 L kulloshtrë gjatë 12 ditëve të para të jetës Për
- një vakt 2l kulloshtrë gjatë 2 orëve të para të jetës Për
- dy vakte 2l kushtër gjatë 6-8 orëve të para të jetës

Cilësia

- Provoni cilësinë e kulloshtrës me matësin e kulloshtrave
- Kulloshtrën me cilësi të lartë ngrijeni në porcione me 500ml
- 500 ml të kulloshtrës me cilësi mesatare bashkojeni me 500 ml të kulloshtrës me cilësi të lartë

Koha e duhur

- 1 vakt maksimumi 2 orë
- 2 vakte maksimumi 6-8 orë

Përzierja korrekte:

- Qumësht + kulloshtrë
- Temperatura deri në 38-39 gradë, të matet me termometër
- Kulloshtra e ngrirë shkrihet ngadalë me ujë të ngrohtë

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

18. SHMANGNI STRESIN NGA TEMPERATURAT E LARTA GJATË TRANSPORTIT TË KAFSHËVE

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Jon Zeneli



Vera ka ardhur dhe temperaturat e larta tashmë kanë mbërritur. Në temperatura të larta, ekziston një probabilitet shumë i lartë që transporti të ketë një ndikim negativ në integritetin fizik të kafshëve që transportohen. Prandaj, transportet në distancë të gjatë duhet të shmangen dhe udhëtimet e shkurtra duhet të bëhen gjatë natës.

Nëse pavarësisht nga temperaturat e larta transportet kryhen, duhet të merren masat e mëposhtme parandaluese për të shmangur stresin e nxehtësisë sa më shumë që të jetë e mundur dhe për të mbrojtur shëndetin e kafshëve.

13 këshilla për të shmangur stresin nga temperaturat e larta

1. Nëse gjatë transportit pritet që temperaturat të shkojnë mbi 35 °C, atëherë mos i transportoni kafshët.
2. Kafshët duhet të lëvizin sa më pak të jetë e mundur (gjatë ngarkimit, udhëtimit, etj.)
3. Inspektimi i shpeshtë i kafshëve për shenja të stresit nga vapa (p.sh. frymëmarrja me gojë të hapur, frymëmarrje e shpejtë, djersitje, qafa e shtrirë te gjedhët).
4. Sigurohuni që të gjitha kafshët të kenë akses pranë ujit të freskët.
5. Merrni me vete sisteme lëvizëse të pirjes për të lehtësuar aksesin e ujit për të gjitha kafshët.
6. Ulni densitetin e ngarkesës me të paktën 30%, veçanërisht në pjesët më të nxehta të automjetit (afër pjesës së përparme të kabinës dhe në kuvertën e sipërme). Sigurohuni që të gjitha kafshët të kenë hapësirë të mjaftueshme për të ekuilibruar nxehtësinë e trupit.

7. Mjetet transportuese duhet të kenë hapësirë dhe lartësi ndërmjet kafshëve dhe pjesës së tavanit për të maksimizuar qarkullimin dhe shkëmbimin e ajrit.

8. Transportet rekomandohen të kryhen natën, shmangni orët më të nxehta të ditës.

9. Gjithmonë parkoni në hije, idealisht në kënd të drejtë nga fryn era.

10. Gjithmonë ndizni ventilimin kur automjeti është i ndaluar.

11. Përdorni automjete me një mbulesë me ngjyrë të hapur për të shmangur grumbullimin e nxehtësisë (e detyrueshme për transporte mbi 8 orë).

12. Hartoni një plan emergjence për të gjitha transportet: çdo vonesë, bllokim trafiku, prishje e automjetit, etj. mund të ketë pasoja serioze (e detyrueshme për transporte mbi 8 orë).

13. Planifikim i kujdesshëm për të shmangur kohën shtesë të pritjes, p.sh. në kufij.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

19.SI MUND TË NDIHMOJË MAJAJA ME STRESIN NGA TEMPERATURAT E LARTA?

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Jon Zeneli

Këtë verë vala e të nxehtit erdhi shumë shpejt. Veçanërisht lopët vuajnë nga lagështia që krijohet nga vapa në stallë. Performanca e tyre e lartë metabolike në prodhimin e qumështit krijon shumë nxehtësi në stallë, e cila nuk mund të çlirohet në mënyrë adekuate në mjedis.

Efektet anësore

Konsumi i ushqimit zvogëlohet dhe lopët fillojnë ta zgjedhin ushqimin. Aktiviteti ripërtypës dhe konvertimi i ushqimit zvogëlohen, i cili nga ana tjetër sjell me vete një rrezik më të lartë të acidozës. Një ngërç në prodhimin e qumështit dhe numrin e lartë të qelizave somatike janë shenjat e para të këtij stresi, por efektet negative mund të vazhdojnë gjatë gjithë periudhës së prodhimit: problemet e pjellorisë, sëmundjet metabolike dhe mastiti nxiten nga çirimi i faktorëve inflamatorë.

Përveç kësaj, lopët qëndrojnë më shumë në këmbë, ndërkohë po të qëndronin të shtrira mund të rrezatohej më pak nxehtësi. Koha e zvogëluar e qëndrimit shtrirë çon në rritjen e problemeve të thundrave. Të gjithë këta faktorë sëbashku ulin përfitimet ekonomike.

Majaja stabilizon rumenin

Qelizat e majave në rumen përdorin oksigjenin e disponueshëm, i cili ka një efekt pozitiv në të gjithë përbërjen e florës anaerobe të rumenit. Ndërtuesit e acideve frenohen dhe promovohen bakteret që përdorin fibra. Tretja e rumenit stabilizohet dhe më shumë energji (bakteret prodhojnë acide yndyrore më të paqëndrueshme si acid acetik dhe propionik) është në dispozicion. Lopët ndihen më mirë, kanë më shumë oreks dhe niveli i stresit bie. Rënia e qumështit zbutet dhe efektet e tjera negative gjithashtu ulen.

Kjo funksionon më mirë nëse jepni maja në një dozë më të lartë (p.sh. RumenHefe Solan 644) para fillimit të periudhës së nxehtë.

Masa të mëtejshme kundër stresit nga temperaturat e larta

Kushtojini vëmendje ventilimit të mirë, krijoni hije, siguroni furnizimin me ujë të pijshëm të ftohtë, përdorni përbërës të ushqimit me cilësi të lartë, përzieni TMR mirë, hiqni ushqimin e mbetur (rrezik për prishje), mundësisht natën ose herët në mëngjes kur është akoma i freskët, jepini pjesën kryesore të ushqimit, jepini vetëm sasi të vogla gjatë ditës. Nëse lopët shfaqin simptoma të qarta të stresit nga nxehtësia, siç janë gulçimet ekstreme dhe jargëzimi i pështymës, atëherë mund t'i lagni lopët edhe me ujë për t'i freskuar.

Menaxhimi i mirë dhe i qëndrueshëm i ushqimit të kafshëve po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, në mënyrë që stresi tek lopët në verë të minimizohet dhe të shmanget ulja e prodhimit të qumështit.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

20. STRATEGJITË MË TË MIRA KUNDËR STRESIT NGA TEMPERATURAT E LARTA

Përpunuar nga Jon Zeneli

Nëse ju punoni në temperatura të larta, djersiteni. Nëse punoni në diell dhe ajri ka lagështirë të lartë, djersiteni edhe më shumë. E njëjta gjë i ndodh edhe lopëve. Rezultati është ulja e rendimentit. Çfarë ndihmon kundërstresit nga temperaturat e larta?

Stresi nga vapa gjatë verës përbën një sfidë të madhe për lopët qumështore me performancë të lartë. Për të parandaluar rëniet e mundshme të rendimentit për shkak të stresit nga temperaturat e larta ka disa strategji efektive. Shtesat efektive me yndyrë të mbrojtur, maja dhe substanca buferike veprojnë kundër stresit nga vapa. Komponentët formues dhe stabilizues të glukozës në racion mbrojnë lopën dhe ushqimin.

Në temperatura të larta, lagështi të lartë dhe performacë të lartë, "zona termo-neutrale" tejkalohet shumë shpejt. Ndodh i ashtuquajtur i stres nga nxehtësia. Studimet e fundit tregojnë se ky lloj stresi fillon në një temperaturë prej 22°C dhe lagështi mbi 45%. Një lopë me 18.5 kg qumësht rrit prodhimin e saj të nxehtësisë me 27.3% dhe një lopë me 31.6 kg qumësht me 48.5%, krahasuar me një lopë që nuk është në laktacion.

Çfarë ndodh në metabolizëm?

Lopët nën stresin e temperaturave të larta konsumojnë më pak ushqim dhe japin më pak qumësht, shpesh edhe me përbërës më të ulët. Bilanci energjetik negativ nxit probleme metabolike dhe përkeqëson performancën e pjellorisë.

Stresi ndikon në shëndetin e rumenit. Lopët përpiqen të kompensojnë pak nga nxehtësia duke gulçuar. Më shumë CO çlirohet në ajër, gjë që çon në humbjen e CO₂ në gjak. Sidoqoftë, në gjak ekziston një raport fiks midis bikarbonatit dhe CO për të ruajtur vlerën e pH. Për të ekuilibruar këtë raport, bikarbonati nxirret përmes veshkave. Ky bikarbonat tani mungon për të stabilizuar vlerën e pH në rumen. Përveç kësaj, lopa kur gulçon humbet pështymën, e cila nuk futet më në rumen. Gjithashtu, konsumi më i ulët i ushqimit do të thotë, që më pak ushqim ripërthet, gjë që zvogëlon më tej formimin e pështymës. Si pasojë, rritet rreziku i acidozës subklinike.

Kur është nxehtë rekomandohet që ta bëni racionin më pak të koncentruar. Disavantazhi i një furnizimi më të ulët me energji është i pranueshëm. Sidoqoftë, kjo bie në kundërshtim me kërkesat më të larta për energji, sepse lopët e stresuara nga temperaturat e larta kanë nevojë për më shumë glukozë. Më e rëndësishmja është propionati i formuar në rumen. Formimi i tij promovohet nga sasi më të larta të ushqimit të koncentruar. Sidoqoftë, kjo pastaj rrit rrezikun e acidozës. Prandaj, lopa dhe fermeri janë në dilemë. Por, si duhet vepruar në këto kushte?

Masat e të ushqyerit

Nga pikëpamja e të ushqyerit, ekzistojnë strategji të ndryshme për të parandaluar pasojat negative ose për t'i zbutur ato në mënyrë të konsiderueshme.

Strategjia 1

Minimizimi i acideve yndyrore me zinxhir të shkurtër, si p.sh acidi laktik.

Të ushqyerit me nivele të larta yndyrore

Yndyra ka tre përparësi: vlerë energjetike më të lartë se karbohidratet e siguruara nga drithërat dhe foragjeret. Yndyrnat e mbrojtura janë një nga burimet më të pasura të energjisë, burim i cili përfaqëson mundësinë më të mirë për të përmbushur kërkesat e energjisë që kanë gjedhët në përgjithësi. Përmbajtja e karbohidrateve mund të zvogëlohet, duke lehtësuar metabolizmin e rumenit. Yndyra e mbrojtur nuk shndërrohet kimikisht në acide yndyrore me zinxhir të shkurtër, për këtë arsye pH në rumen është i stabilizuar. Gjithashtu vlen të theksohet: duke qënë se yndyrnat e mbrojtura nuk metabolizohen, gjenerimi i nxehtësisë te gjedhët në periudhat me temperaturë të lartë është më i pakët.

Simptomat nga stresi	Shkaqet dhe pasojat	Këshilla praktike	Produkti
Rritja e frymëmarrjes, gulçim, djersitje e madhe	Vlera e pH në gjak dhe rumen ulet, kërkesa më të larta për ujë dhe energji për shkak të djersitjes	Siguroni ventilim optimal dhe një klimë të freskët në stallë, zbuteni vlerën e pH në rumen dhe gjak me aditivë	RINDA MIN BP Kombinimi i substancave buferike, shumë efektiv RINDAVIT ASS-CO Formulë speciale minerale me përbërësin aktiv ASS-CO FERM (maja)
Konsum më i lartë i ujit	Në 30°C lopët pinë deri në 7.5 litra ujë në orë	Siguroni që lopët të kenë akses në ujë të pijshëm të freskët, Vëzhgoni higjienën e ujit	SCHAUMADES CLEAN WS Dezinfektues special me shumë përbërës për ujë të pijshëm
Ulje e konsumit të ushqimit	Ulja e rendimentit të qumështit dhe përbërësve të qumështit, ringrohja e ushqimit	Rritni përqendrimin e energjisë me ushqime miqësore për rumenin, kufizoni përqindjen e karbohidrateve lehtësisht të tretshëm në racion, parandaloni ringrohjen e ushqimit, përmirësoni furnizimin me glukozë për kafshët	SCHAUMANN ENERGY Produkt me yndyrna ushqyese të qëndrueshme të rumenit për të zvogëluar rrezikun e acidozës dhe lehtësimine metabolizmit të energjisë SCHAUMASIL TMR Kombinime të ndryshme për stabilizim
Rritja e numrit të qelizave dhe temperaturës së trupit nga 39 °C në 40 °C	Humbja e mineraleve për shkak të djersitjes më të lartë, ulje e pjellorisë	Rritni furnizimin me ushqim të pasur me minerale dhe vitamina deri në 25%	RINDAVITAL TOP & RINDAVITAL PROTECT Stabilizojnë statusin imunitar dhe nxisin pjellorinë

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

21. TEMPERATURAT E LARTA STRES PËR LOPËT E QUMËSHTIT

Përpunuar nga Rexhep Peposhi .

Temperaturat e larta në verë shkatojnë tek lopët e qumështit një situatë të shtuar stresi. Respektimi i rregullave të thjeshta të mbarështimit dhe masave të caktuara në teknikat e të ushqyerit lehtësojnë prodhimtarinë dhe ulin rrezikun e pasojave negative në shëndet dhe rendiment.

Stresi manifestohet me reduktimin e konsumit të ushqimit duke zvogëluar kështu dhe prodhimin e qumështit. Përveç kësaj, përmbajtja e yndyrave dhe e proteinave në qumështit bie. Po ashtu, pasojat e temperaturës së lartë mund të jenë një gjëndje shëndetësore e përkeqësuar e gjirit dhe e shëndetit në përgjithësi.

Ujë i freskët dhe shumë ajër

Gjatë periudhës së nxehtë lopët kanë nevojë për më shumë ujë. Eksperimentet në Hülsenberg (laboratori kërkimor i Schaumann) kanë treguar se në një temperaturë ambienti prej afërsisht 10 gradë në muajin prill, një lopë qumështore me rendiment të lartë ka nevojë për 88 litërujë në ditë. Disa eksperimente gjatë verës së kaluar kanë treguar vlera mesatare prej 120 litër ujë në ditë. Kjo do të thotë që në sezonin e ngrohtë, lopëve duhet t'u jepet shumë ujë i freskët.

Gjithashtu një ventilim i mirë i stallës redukton stresin që shkaktohet nga nxehtësia. Prej disa vitesh përdoren ventilatorë të fuqishëm që vendosen në një distancë prej 15-20 metër. Një masë efektive në ditët e nxehta është edhe vendosja e ventilatorëve të shoqëruar me sistem uji, mundësisht me pika sa më të vogla, në mënyrë që të evitohet lagështira në koridoret e stallës.

Në kullota lopët kërkojnë instiktivisht vende me hije pemësh, kjo duhet të garantohet edhe në ambjentet e hapura nëpërmjet strehave mbrojtëse në stallat e hapura, duke evituar daljen vetëm në mëngjes dhe në darkë.

Përshtatja e racionit ushqimor

Në temperatura të larta lopët vuajnë shpesh nga acidoza dhe jane dy shkaqe kryesore . Shkaku i parë është ulja e konsumit të ushqimit te lopët gjatë këtyre temperaturave.Si pasojë ato konsumojnë më pak energji dhe lëndë ushqyese, duke u reflektuar në reduktimin e lëndëve ushqyese të qumështit. Rekomandimi për rritjen e nivelit të koncentratës çon në rritje të aciditetit në rumen.

Në këto kushte, pasojë tjetër është dhe dëmtimi i shëndetit të thundrave, por edhe i shëndetit të gjirit dhe pjellorisë. Studimet tregojnë se në rastet e aciditetit të tepërt në rumen, popullata mikrobike dëmtohet si pasojë e rritjes së nivelit të endotoksinave, të cilat nga njëra anë kanë njëndikim negativ në sistemin imunitar dhe psh. një efekt negativ në qarkullimin e gjakut në indin e lekurës dhe thundrave. Për këtë arsye rekomandohet aplikimi i racioneve të pasura me celulozë (10-11% celulozë e papërpunuar) si dhe rritjes së nivelit të energjisë nëpërmjet shtesës së yndyrave me efekt mbrojtës për rumenin (Schaumann Energy). Yndyra është shumë e pasur me energji dhe gjatë procesit të tretjes çiron më pak energji se tretja e karbohidrateve.

Shkaku i dytë i një mjedisi acid të metabolizmit qëndron edhe në reaktionin e natyrshëm të organizmit të lopëve, icili tenton të çlirojë nxehtësinë nëpërmjet djersitjes dhe gulçimit të vazhdueshëm, duke çliruar më shumë CO2 dhesi pasojë duke shkaktuar *alkalozë respiratore* (frymëmarrje të vështirë). Lopa shkarkon gjithmonë e më shumë bikarbonate nëpërmjet urinës dhe njëkohësisht reduktohen karbonatet që janë prezente si pasojë epështymës gjatë gulçimit.

Furnizimi i duhur me celulozë e neutralizon këtë proces, nxit ripërtpjen dhe stimulon sekrecionet e pështymës.Gjendja mund të lehtësohet me shtimin e substancave mbrojtëse ndaj ketozës (substancia buferike për rumenin).

Rëndësia e nivelit të ekuilibruar të elektroliteve

Proçesi i djersitjes shoqërohet me humbje të elektroliteve, si kaliumi dhe natriumi, të cilat duhet të zëvendësohen. Nga njëra anë raporti optimal midis kaliumit dhe natriumit, nga ana tjetër raporti midis klorit dhe sqfurit duhet të marrin vlera ndërmjet 250 dhe 350 mq/kg LTH.

Ky raport është konsideruar prej shumë vitesh në konceptimin e produkteve të SCHAUMANN, të tilla si: RINDAVIT ACTIV PLUS ose RINDAVIT LF AKTIV. Përdorimi i përbërësve aktivë në racionet ushqimore (sidomos në ato me përmbajtje misri), të cilat zakonisht përmbajnë pak kalium, mund të ndikojë pozitivisht në balancimin e kaliumit gjatë muajve të nxehtë të verës.

Schaumann në Hülsenberg dhe në Hungari ka testuar me sukses përzjerjet specifike të ushqimit të pajisur me mineralet e duhura.

Stresi që i shkaktohet lopës për shkak të të nxehtit nuk mund të eliminohet plotësisht, por duke ndërmarrë masat e përmendura më sipër, gjendja e lopës lehtësohet dukshëm, prandaj rekomandohet të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për të mbajtur një prodhimtari të lartë edhe gjatë muajve të verës.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

22. STRESI NGA NXEHTËSIA TE LOPËT E QUMËSHTIT

Përgatitur nga Franz Riegler, ekspert i të ushqyerit, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Jon Zeneli

Pse lopët e qumështit janë kaq të ndjeshme ndaj të nxehtit?

Gjatë prodhimit ditor të qumështit, te lopa ndodhin procese masive metabolike. 50 deri 60 kg lëndë e freskët konsumohet çdo ditë për të prodhuar 40 kg qumësht ose dhe më shumë. Me një performancë të tillë metabolike, gjenerohet shumë nxehtësi. Nëse për shkak të temperaturave të larta të ambientit, nxehtësia nuk mund të çlirohet mjaftueshëm, bagëtitë vuajnë nga stresi i nxehtësisë. Temperatura optimale për lopët qumështore shtrihet në diapazonin 7 °C deri 17 °C. Shenjat e para të stresit të nxehtësisë mund të vërehen në temperaturat mbi 20 °C. Përveç temperaturës së jashtme, lagështia e ajrit gjithashtu luan një rol vendimtar.

Si ta njohim fillimin e stresit të nxehtësisë?

Lopët për të çliruar nxehtësi përmes sipërfaqes së trupit qëndrojnë më gjatë në këmbë. Shpesh vërehet se shumëprej tyre qëndrojnë pranë portave ose dritareve. Në të njëjtën kohë, temperatura e rritur e trupit shpejton ritmin e frymëmarrjes. Stresi nga nxehtësia ka një efekt negativ në marrjen e ushqimit. Në temperatura të larta marrja e ushqimit mund të reduktohet deri në 20%. Kjo zakonisht sjell pasoja të tilla si p.sh. rënie të prodhimit të qumështit, reduktim i përbërësve të qumështit, mungesë energjie, çrregullime të pjellorisë, si dhe rritje të numrit të qelizave somatike ose infeksione të gjirit.

Ventilatorët dhe uji

Tashmë ka stalla në të cilat janë instaluar ventilatorë, të cilët kanë një ndikim pozitiv në ftohjen e ajrit, nëparandalimin e nxehtësisë së akumuluar si dhe në zvogëlimin e ndotjes nga amoniaku. Vendosja e saktë është thelbësore. Ajri i ftohtë i ventilatorit duhet të kalojë rreth 20 cm sipër lopës së shtrirë. Në vijim, bëhet një dallim midis ventilatorëve të tavanit dhe ventilatorëve boshtorë. Ventilatorët boshtorë realizojnë një ftohje më të mirë të ajrit të jashtëm. Dushet e lopëve duhet të instalohen vetëm në stenda me qarkullim të fortë të ajrit. Nëse ajri i lagësht nuk del nga hambari, lagështia e ajrit rritet dhe kjo ndikon në rritjen e stresit nga nxehtësia.

Çfarë duhet të merret parasysh në teknologjinë e ushqimit?

- ♦ Djersitja e lopëve në temperatura të larta, rezultojnë në çlirim të shtuar të mineraleve, prandaj marrja e mineraleve në muajt e verës duhet të rritet me rreth 15%.
- ♦ Lugu duhet të kontrollohet për ndonjë ngrohje të mundshme të ushqimit. Në rast ngrohjeje duhet të merren masat e duhura (përshpejtimi i ushqimit në silos, spërkatja e sipërfaqes me acid, ushqim më të shpeshtë).
- ♦ Përqëndrimi i energjisë në racionin ushqimor duhet të mbahet sa më i lartë në mënyrë që të kompensohet ulja e konsumit të ushqimit.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

23.KONCEPTI MBIUSHQIMIN OPTIMAL PËR VIÇAT

Përpunuar nga Jon Zeneli

USHQYERJA MODERNE E VIÇAVE

E përdorur nga SCHAUMANN me shumë sukses në shumë praktika

Qëllimet në mbarështimin e viçave

1. Viça të shëndetshëm nëpërmjet teknikave të mbarështimit dhe të ushqyerit në kushte optimale
2. Zhvillimi i ripërtpësve nëpërmjet nxitjes së hershme të funksionimit të rumenit
3. Mbarështim ekonomik nëpërmjet teknikave të përshtatshme të pirjes

Në lindje aparati tretës i viçit ka ndryshime të mëdha krahasuar me një ripërtpës të vjetër si në ndërtim, ashtu edhe në funksion. Me rritjen e moshës ndodhin ndryshime të rëndësishme në lidhje me kapacitetin, funksionin dhe ndërveprimin e organeve të ndryshme. Në këndvështrimin fiziologjik, procesi i të ushqyerit dhe i zhvillimit të viçave me objektiva të qarta, nga ushqimi i lëngshëm në koncentrat i transformon ata. Raporti i parastomakut me pjesët e tjera të aparatit tretës ditët e para është 75 me 25% dhe ky raport ndryshon brenda një viti nga 10 me 90%.



Qëllimi i këtij zhvillimi është kthimi i viçave në ripërtpës

Zhvillimi i aparatit tretës kushtëzohet shumë nga mënyra etë ushqyerit. Koncentratet me përmbajtje të lartë të karbohidrateve, amidonit (drithërat), ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e vileve në stomak. Nga gjendja e një indi të lëmuar të mureve të brendëshme të stomakut, nxitet formimi i vileve në formë gishtash nga acidet yndyrore (acid butirik dhe propionik) të cilët lëshohen nga drithërat. Vetëm kur këto vile zhvillohen mirë në formën e tyre të plotë, bëhet e mundur përthithja e energjisë nga ushqimetë tjera të thata (bari i thatë).

Tabela 1: Programi SCHAUMANN për viçat

Emri i produktit	Përbërësit	Përdorimi
KALBI-FERM	Magnez, Vitamina dhe PROVITALE	Rritja e forcës së mbrojtjes dhe trupit, redukton rrezikun nga diarreja, ndihmon në tretje
KALBI-START SUPER	Substanca mbrojtëse kundër baktereve, PROVITALE	Forcon sistemin imunitar, stabilizon florën e zorrëve
KALBI-LYT	Elektrolite, vitamina dhe medikamente kundër diarresë	Mbron elektrolitet nga dehidratimi, konservimi i duhur i energjisë në metabolizëm, rregullon tretjen
KALBI-PHOSPHORAL SL PRO	Yndyrna, vitamina, elemente të ndryshëm dhe PROVITALE	Përkujdesja e plotë ndihmon zhvillimin e hershëm të ripërtpjes, rrit konsumin e ushqimit
KALVICIN 2000 (ose KALVICIN PRO)	Minerale, vitamina, elemente të ndryshëm dhe maja (ose spore)	Përzjerja e mineraleve dhe substancave aktive për një ushqyerje pa probleme dhe një rritje sa më të mirë
KALBI-STARTER-2000	Proteina, minerale, vitamina, elemente të ndryshme, bakteriet e acidit laktik	Koncentrate me proteina për prodhimin e ushqimeve lehtësisht të tretshme për viçat
SCHAUMACID Drink	Kombinime acidesh	I shtohet shije qumështit të ftohtë dhe ujit të pijshëm

SCHAUMANN ofron për mbarështimin e viçave një program me produkte efikase sipas tabelës 1.

Furnizimi me ujë pijshëm luan një rol të rëndësishëm në rritje, përveç të ushqyerit me qumësht, Kälber start edhe bar të thatë. Viçi ka nevojë cdo ditë për rreth 10% ujë të masës së tij trupore. Një viç që peshon 40 kg duhet të konsumojë çdo ditë 4 litra ujë. Duke ditur që 1 litër qumësht përmban maksimumi vetëm 0,9 litra ujë (të paktën 100 g janë lëndë e thatë), mund të ndodhë që viçitë ketë mungesë të ujit të pijshëm, prandaj furnizimi me ujë është i rëndësishëm.

Tabela 2: Përbërja e Kälberstarter	
Përbërësit	Sasia ne %
Elb	49,5
Misër/Grurë	20,0
Farë liri	7,0
Sojë 44	19,0
KALVICIN 2000	4,0
SCHAUMACID	0,5
Gjithsej	100

Të ushqyerit në fermën Steininger

Ferma ka në dispozicion rreth 90 bokse për viça majmërie. Sipas fermës Steininger tregohet se si funksionon mbarështimi optimal i viçave.

Nga statistikat e viteve të kaluara ferma e fillonte majmërinë me një peshë mesatare prej 115 kg. Shtresa me kashtë në bokse aplikohet në sistemin stallor. Stalla pastrohet dhe dezinfektohet pas çdo faze (cikli). Në fazën e para majmerisë viçat qëndronin të paktën 6 javë dhe mëpas dërgoheshin në stallën e majmërisë.

Strategjia e të ushqyerit

- Java e parë e mbarështimit: KALBIMILCH A
- Duke filluar nga java e dytë e mbarështimit: KALBMILCH A + Kälberstarter + bar i thatë. Në tabelën2 është paraqitur përmbajtja e Kälberstarter për viçat. Një interes i vecantë i kushtohet cilësisë së Kälberstarter, si dhe strukturës së ushqimit (jo shumë e hollë). Nëpërmjet përdorimit të SCHAUMACID arrihet stabilizimi i ushqimit. Më tej Z. Steininger pohon që sasia e konsumit të ushqimit rritet, gjë e cila mbështet zhvillimin e shpejtë të mëtejshëm nga viç në ripertypës.
- Silazhi aplikohet vetëm atëherë kur sasia e konsumit të Kälberstarter ka arritur në 1 kg/viç në ditë. Të ushqyerit e kombinuar i silazhit dhe qumështit nuk aplikohet për arsye të rrezikut të lartë të diarresë. Si profilaksi kundër bakterieve "E. Coli" dhe efekt stabilizues për qumështin dhe ujin e pijshëm aplikohet fermentimi nëpërmjet Schaumacid Drink. Nëpërmjet adaptimit të recetave ushqimore sipas peshës mundësohen shtesa të përditshme nga 1.200 g deri në 1.330 g. Në të njëjtën kohë duhet të theksojmë që këto rritje janë realizuar pa rritur kostot.

Përmbledhje

Strategjia e duhur në të ushqyerin e viçave është çelësi i suksesit në vazhdimin për fazat e mëtejshme të rritjes dhe mbarështimit. Sa më shpejt të fillojë ushqyerja e viçave me koncentrate, aq më pak probleme do të kemi në rritje dhenë mbarështim. Kälberstarter është mënyra më e mirë për rritjen dhe mbarështimin e suksesshëm të viçave, sipas konceptit të të ushqyerit SCAUMANN.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

24.OPTIMIZIMI I USHQIMIT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Baza për mbarështimin e suksesshëm të viçave përcaktohet që në fazën e pirjes.

Përmbledhje e një referati gjatë një seminari për mbarështimin e gjedhit në Vjenë nga z. Olger Nanogjoka, drejtor i shitjeve pranë Austria Praemix, përfaqësuese e përgjithshme e kompanisë Schaumann për Shqipërinë dhe Kosovën.



Një rol të rëndësishëm luajnë edhe aspektet e mbarështimit dhe të menaxhimit të shëndetit, krahas ushqimit.

Shtimi i lartë në peshën ditore deri në 850 gr gjatë gjithë periudhës së rritjes së viçave është i domosdoshëm për të arritur një rritje maksimale të viçit dhe një moshë të hershme të pjellorisë.

Objektivat kryesorë të një rritjeje me rendimentet e duhura të viçave janë:

- Imunitet i mbrojtur me anë të të ushqyerit me kulloshtrës (minimizon humbjen në viça)
- Zhvillimi i shpejtë i rumenit (koha dhe sasia e pirjes)
- Kujdesi ndaj kualitetit të zëvendësuesve të qumështit
- Kosto të ulëta për rritjen me anë të ofrimit të koncentrateve të mjaftueshme dhe foragjereve të cilësisë më të mirë
- Pjelloria e hershme

Diarreja gjatë periudhës së pirjes sjell detyrimisht në një moszhvillim të kafshës.

Rekomandohet që viçave t'u sigurohet një sistem i mirëmbrojtur imun me anë të kulloshtrës, në mënyrë që të minimizohet rreziku i ndonje infeksioni. Dhënia e parë e kulloshtrës duhet bërë sa më shpejt pas lindjes, kontrolluar me anë të kovave dhe shisheve një deri në tre orë pas lindjes. Pirja e kulloshtrës së dytë duhet të vijojë gjashtë deri në nëntë orë pas lindjes.

Parimi: Sa më shumë kulloshtrës të konsumohet nga viçi, aq më i lartë është niveli mbrojtës i imunoglobulinës së viçit. Dhënia e parë për një viç prej 40 kg duhet të jetë minimalisht dy litra ose 5 % e peshës së lindjes.

Përdorimi i zëvendësuesve të qumështit dhe qumështit të plotë, është i lartë në shumë ferma. Në fillim duhet bërë suportimi i zhvillimit të rumenit, me anë të përdorimit të koncentrateve cilësore, lehtësisht të tretshme dhe ushqimit cilësor të strukturuar, të paktën që nga java e dytë e lindjes.

Sasia ditore e konsumit të qumështit nuk duhet të kalojë 6 litra, në mënyrë që viçi të konsumojë në sasi të mjaftueshme ushqimet e thata. Periudha e pirjes mund të zgjasë maksimumi deri në 10 javë.

Makineritë e pirjes përdoren gjithnjë e më shumë në mbarështimin e viçave, në mënyrë që viçat ta kenë të lehtë dhe të kontrolluar kalimin në fazën e shkeputjes. Ato iabëjnë më të lehtë punën fermerit, duke u mundësuar kohëtë lirë dhe për aktivitete të tjera. Alternativat e zbatimit dhe modelet janë të shumta.

Operimi i tyre bëhet sipas dëshirës dhe përdorimit të makinerive të thjeshta apo të avancuara. Përparësia e makinerive të thjeshta është një sistem i veçantë i automatizuar, i lidhur direkt me makinerinë për proceset kryesore të operimit. Ky sistem bën të mundur kontrollin e një sërë procesesh për planifikimin e ushqimit, recetave, në intervale kohore të caktuara. Shumë prej tyre mund të lidhen edhe me automate koncentrateve dhe programime kompiuterike, me skicime grafike. Operimi i sigurt dhe i saktë i impianteve, mundëson në stallë përdorimin e tyre pa problem.

Në sistemet e të ushqyerit në stallat e mëdha, identifikimi i secilit viç bëhet me anë të qaforeve apo matrikujve elektronike në vesh dhe ushqimi i tyre vijon sipas detyrave të fermerit. Çdo fermë e madhe ka mundësinë e përfitimit të një sërë zgjidhjesh për çdo fazë të rritjes së viçave.

Plani javor për mbarështimin e viçave

Të ushqyerit

Rritja e viçave të shëndetshëm shkon zakonisht deri në 12 javë.

Karakteristikat e planit të pirjes:

Për një rritje normale 12 javore, nevojiten 55 litra kulloshtër, respektivisht qumësht, 470 litra pirjeje me 60 kg zëvendësues qumështi, 80 deri në 110 kg suplemente dhe rreth 50 kg bar të thatë dhe kashtë.

Plani i pirjes dhe të ushqyerit:

Java 1: Nga dita e lindjes, deri në fund të javës së parë, viçi konsumon 3-4 litra kulloshtër, respektivisht qumësht në ditë.

Java 2: Gjatë javës së dytë, kulloshtër, respektivisht qumështi ofrohet pjesë-pjesë. Fillimisht viçi konsumon 6 litra kulloshtër. Kjo sasi reduktohet gjatë javës së dytë. Njëkohësisht, sasia e pirjes rritet nga 2 deri në 7 litra deri në fund të javës së dytë. Në një litër pirjeje hidhen 100 g zëvendësues qumështi. Gjatë javës së dytë fillon të ushqyrit me ushqim të koncentruar. Ofrohet ad libitium bar i thatë ose kashtë.

Java 3: Sasia e pirjes arrin 7 litra në ditë me 100 g MAT/litër. Suplementi ofrohet gjatë gjithë periudhës së rritjes, dmth deri në javën e 12-të nga 1.5 kg për çdo ditë. Viçat konsumojnë gjatë gjithë periudhës së rritjes kashtëad libitium.

Java 4: Sasia e pirjes shkon në 8 litra me 100 g MAT/litër.

Java 5-6: Sasia e pirjes vazhdon të jetë 8 litra. Koncentrimi i zëvendësuesve të qumështit shkon tani në 120 g/litër.

Java 7-10: Sasia e pirjes reduktohet në 6 litra (120 g MAT/litër).

Java 11: Viçat konsumojnë 4 litra në ditë (120 g MAT/Lit).

Java 12: Në javën e fundit, sasia e pirjes reduktohet nga 4 litra në 0 (120g MAT/Lit).

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

25. RITJA E VIÇAVE

E përmbledhur nga Franz Riegler, këshillues dhe aksioneri Austria Praemix Shpk. Përpunuar nga Rexhep Peposhi

Ndikimi i konsumit të sasisë së ulët të qumështit në rritje e viçave

Shfrytëzimi maksimal i potencialit gjenetik të viçave mund të përcaktohet, që në javët e para të jetës së tyre. Të ushqyerit duhet të konceptohet në atë mënyrë, që të garantohet një organizëm i shëndetshëm në vazhdimësi dhe të arrihet peshë optimale në çdo fazë të rritjes. Shpesh herë, këto objektiva nuk mund të arrihen, për arsye të konsumit të ulët të sasisë së qumështit.

Cilat janë sasi të nevojshme të qumështit? Në javët e para të jetës, viçat janë tërësisht të varur nga lëndët ushqyese të qumështit, i cili në mënyrë të natyrshme është i përshtatur për kërkesat e viçave të kësaj moshe. Të rëndësishme janë cilësia e lartë e proteinave dhe niveli i energjisë. Ushqime të tjera, si p.sh. koncentratet, konsumohen nga viçat akoma në sasi të vogla.

Plani i konsumit të qumështit të fermentuar

Sipas rekomandimeve të deritanishme, një konsum max. 6 litra në ditë, për periudhën e rritjes, nuk i përmbush ende nevojat e viçave në qumësht. Konsumi i sasive më të larta të qumështit përbën një problem për sistemin e tretjes, për shkak të praktikave të dhënies së qumështit dy herë në ditë. Pirja e sasive të larta (rreth 3 litra) të qumështit për çdo vakt, gjatë javëve të para të jetës, shkakton shpesh diarje, sidomos në rastet kur qumështi konsumohet shumë shpejt nga viçat.

Sasia e qumështit përcakton shtesën në peshë

Është e vërtetuar në praktikë që konsumi i sasive më të larta ditore të qumështit, rrit ndjeshëm shtesën ditore në peshë. Kushti kryesor është që sasia e qumështit të shpërndahet gjatë ditës në sasi të vogla, i cili mënjanon problemet me aparatit tretës. Pirja e qumështit jo me nxitim, përbën një element të rëndësishëm në shëndetin e viçave, pra më pak stres për organizmin dhe siguron mirëqënien e tyre.

Duke ju referuar studimeve të ndryshme europiane, shtesa të larta ditore në peshë, gjatë javëve të para të jetës çojnë në formim më intensiv të indit të gjëndrave të qumështit, fakt që ndikon pozitivisht në rendimente të larta qumështi për lopët qumështore.

Veç kësaj, viçat e shëndetshëm gëzojnë një status të qëndrueshëm shëndetësor të plotë më tepër dhe janë në gjendje të sigurojnë sasi të nevojshme të ushqimit edhe në fazat e mëvonëshme, kur aplikohet të ushqyerit në grup.

Rekomandim: Qumështi duhet fermentuar

Konsumi i lartë i sasisë së qumështit në ditë, kërkon një ndryshim në teknikën e dhënies së tij. Rekomandimi më i mirë është që nga dita e parë e jetës, e deri në javën e tretë, qumështi t'u jepet sipas dëshirës. Në mënyrë që të garantohet cilësia e qumështit, është e rekomandueshme fermentimi i tij. Këtu përjashtohet fermentimi i kulloshtrës. Nëpërmjet fermentimit të qumështit shmanget rreziku i aktivitetit të ngarkesës mikrobike, si p.sh. bakterieve E.coli, rritet tretshmëria e qumështit dhe është e mundur që të konsumohet edhe i ftohtë.

Fermentimi mund të realizohet me lëndë të ndryshmeacide. Më shpesh përdoren acidi formik, acidi propionik, ose acidi citrik. Gjithashtu ka dhe produkte të gatshme në formë të lëngshme ose pluhuri, të cilat mund të përdoren më lehtë. Për stabilizimin e qumështit duhet të aplikohet aq sasi acidi sa të mundësohet arritja e vlerës së pH-it 5,5. Një fermentim më i fortë do të reduktonte sasinë e konsumit të qumështit nga viçat dhe në gjendje të ngrohtëdo të ndodhte prishja e tij. Gjatë përdorimit të acidit formik është e nevojshme të përdoret 1 ml acid i paholluar. Kështu me një litër acid formik mund të fermentohen

1.000 l masa pirjeje për viçat. Duhet mbajtur parasysh që acidi i koncentruar, për arsye sigurie dhe manipulimi më të mirë, para përdorimit duhet holluar patjetër me ujë në raportin 1:9. Ky përdorim kërkon kujdes të veçantë.

Java	Qumësht l/Ditë	Ujë	Bar i thatë	Koncentrate
1-3	Pirje e lirë	Që nga java e dytë	Që nga java e dytë	Që nga java e dytë
4-6	6			
7-8	4			
9-10	2			
11	-			

Sa sasi qumështi duhet konsumuar?

Në mëngjes dhe në mbrëmje, qumështi duhet të përgatiteti freskët. Kovat pirëse duhet të pastrohen të paktën njëherë në ditë, përpara se viçave t'u lihet në dispozicion sasia e mjaftueshme e qumështit. Sasia varion në 6 litra, për gjysëm dite, e deri në 12 litra për një ditë. Viçat mund të pëijnë qumësht në sasi të vogla gjatë gjithë ditës. Për sakohë që në kovë ka qumësht, viçat nuk kanë etje të tepërt.

Viçat duhet të pijnë sa 20% e peshës së tyre trupore, pra rreth 8-12 litra qumësht në ditë. Rritja ditore në peshë mund të arrijë me këtë dozë deri në 1000 gram. Pas tre javësh të pirjes së lirë, sasia duhet të kufizohet deri në 6 litra në ditë, ndërkohë që qumështi duhet të vazhdojë të fermentohet. Në këtë fazë viçat duhet të fillojnë të hanë koncentrat dhe bar, për të kompensuar balancën e energjisë. Brenda një kohe të shkurtër, viçat do hanë sasi më të mëdha koncentrat sesa me metodën e deri tanishme të sasive të dhëna. Studimet kanë treguar që viçat në rritje hanë deri në 10 kg më shumë. Në fund të rritjes, viçat, për shkak të sasisë së lartë të pirjes në tre javët e para të jetës, dhe të marrjes të koncentratës së lartë, arrijnë në 20% më tepër peshë, se viçat e rritur me metodën e deritanishme. Sasia e konsumimit të qumështit duhet të jetë 6 litra çdo ditë, deri në javën e katërt të jetës së tyre. Gjatë qëndrimit jashtë dhe temperaturave të ulëta në dimër, jepen një, ose dy litra. Në këtë mënyrë garantohet përkujdesja e mjaftueshme për viçat. Fermat që kanë makineri, mund ta zvogëlojnë gradualisht sasinë e qumështit deri në javën e dhjetë. Në këtë mënyrë parandalohet ndonjë anomali e mundshme e rritjes, pas javës së tretë.

Konkluzione

Në javët e para të jetës, viçat duhet të rriten sa më mirë. Sasi tepër të vogla të konsumit të qumështit, nuk mjaftojnë për rritje optimale. Qumështi i fermentuar lehtë, mund të jepet edhe për konsum sipas dëshirës, pa shkakuar probleme me tretjen. E rëndësishme është që viçat gjatë gjithë ditës duhet të konsumojnë qumësht. Pas javës së tretë të jetës, qumështi duhet të reduktohet, me qëllim që të motivohet konsumi i ushqimeve të thata si koncentratet dhe bari.

Nga Praktika për Praktikën

Problemet iniciuan zgjidhje të reja

Franz Riegler, këshillues për të ushqyerit në Schaumann International dhe bashkëthemelues i Austria Praemix shpk, duke ju referuar dhe një studimi amerikan, në revistën "ELITE", thekson se viçat, të cilëve në fazat e para të rritjes ju mundësohet konsumi sipas dëshirës, "ad libidum", kur rriten, rezultojnë me një volum të dyfishtë të indit të gjendrave të gjirit. Kjo praktikë e teknikës së të ushqyerit, në shumë ferma qumështi brenda dhe jashtë Austrisë u aprovua dhe rezultati ishte shumë i qartë: shmangia e problemeve që vijnë si pasojë e kalimit nga kulloshtra në qumështin normal.

Si funksionon konkretisht kjo teknikë?

Në ditën e parë viçat marrin 6 - 8 litra kulloshtrë.

Mjelja fillon menjëherë pas lindjes, paralel me kohën kur nëna kujdeset dhe lëpin viçin. Qumështi jepet menjëherë pas lindjes, në momentin që lopa fillon përkujdesjet e para për viçin. Përvoja ka treguar se viçat, që kalojnë një gjysmë ore me lopën, pijnë më mirë. Në rast se lopa jep shumë pak qumësht, i jepet kulloshtrë e ngrirë. Ushqyerja edhenë rastin kur jepet e ngrirë, bëhet përmes kulloshtrës që është testuar më parë. Nëse kulloshtra nuk i përmbush kriteret e cilësisë, atëherë ushqyerja bëhet vetëm me qumësht të ngrirë. Cilësia e kulloshtrës varet nga kujdesi ndaj lopës gjatë periudhës së tharjes.

Për këtë fazë të rëndësishme të jetës së viçave, SCHAUMANN ka zhvilluar produkte inovative, si p.sh SHAUMACID, i cili që nga dita e dytë e jetës aplikohet për fermentimin e kulloshtrës. Raporti i përzierjes së ujit me Shaumacid është 5:1. Kjo përzierje mund të zgjasë për disa javë. Përzierjes i shtohet 15 ml qumësht. Në fillim përgatitet përzierja, që të trashet sa më mirë, i hidhet qumështit në kovë dhe më pas përzihet me një rrahëse. Viçat marrin, në tre javët e para të jetës, 15 litra qumësht çdo ditë. Sasia e qumështit të konsumuar përsëritet dyherë çdo ditë dhe në këtë mënyrë qumështi ftohet, fermentimi bëhet i domosdoshëm. Pasi viçi bëhet tre javësh, dhënia e qumështit zvogëlohet deri në 5 litra. Ushqyerja me qumësht vijon për 7-8 javë dhe qumështi fermentohet deri ditën e fundit. Kur janë dy ditësh, viçave u jepet një përzierje koncentratit me ujë, katër ditësh, u jepet bar i freskët. Përvoja ka treguar, që sasi të mëdha të racioneve me qumësht, e nxisin më herët të ushqyerit me koncentrate. Nga të ushqyerit, sipas dëshirës me qumësht, ka më pak diarre. Edhe n.q.s ndodh të ketë, ajo do të zgjasë më pak. Zhvillimi i mirë i viçave vërehet menjëherë që në fillim, ndërsa zhvillimi i gjendrave të qumështit, do të vijet re në periudhat e mëvonshme të rritjes.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

26. HEQJA E BRIRËVE TE VIÇAT

Përpunuar nga Rexhep Peposhi

Dr. Michael Hulek, veteriner dhe ekspert i trajtimit të thundrave në Austri, këshillues i QFPB

Heqja e brirëve te viçat duhet të shoqërohet me narkozë dhe qetësuesit përkatës.

I. Pyetje dhe përgjigje:

1. Në cilën moshë mund t'u hiqen brirët viçave?

Heqja e brirëve bëhet në periudhën ndërmjet javës së 2-të dhe të 6-të pas lindjes. Në javën e dytë sythi i bririt fillon të bëhet i prekshëm dhe i dukshëm. Veterineri i injekton Xylazin, qetësues për dhimbjet. Tek viçat më të mëdhenj se 6 javë duhet bërë patjetër anestezi e përgjithshme ose ajo lokale nga veterineri.

Viçat duhet të jenë të shëndetshëm, duhet të mësohen me mjedisin përreth dhe me grupin.

Konsultat me veterinerin mbi rregullat e kujdesit të kafshëve janë të nevojshme.

2. Përse duhet të jepet bashkë me qetësuesin edhe një preparat kundër dhimbjeve?

Xylazina është një qetësues që i injektohet kafshës në mënyrë që të qëndrojë e palëvizur gjatë procedurës. Efektii preparatit kundër dhimbjeve zgjat vetëm për një kohë të shkurtër. Përdorimi i një preparati josteroidal (NSAID) kundër infektimit të plagës është i domosdoshëm për dhimbjet afatgjata nga heqja e brirëve, që shoqërohet me rritjen e frymëmarrjes, dridhjes së veshëve, kruarjes së kokës, lëvizjes në mënyrë të vazhdueshme të bishtit.

Viçat vuajnë më pak dhe konsumojnë më shumë ushqim.

3. Pse zona rreth sythit të bririt duhet pastruar nga qimet?

Sythi i bririt bëhet i dukshëm tek viçat që në javën e 2-të të jetës dhe për të patur një pamje sa më të qartë, pjesa rreth sythit duhet pastruar nga qimet. Qimet pengojnë procesin e djegies.

4. Pse maja e shufrës së nxehtë duhet të pastrohet sa më mirë për çdo proces të heqjes së brirëve?

Sterilizimi i shufrës për djegie garanton shpërndarjen e njëtrajtshme të nxehtësisë.

5. Përse pas heqjes së brirëve duhet përdorur një spraj i posaçëm?

Pas procesit të heqjes së brirëve duhet përdorur një spraj për të mbuluar dhe për të dezinfektuar zonën e trajtuar kundër papastërtive dhe insekteve. **Blue Spray** me përmbajtje antibiotikësh është mjaft efektiv dhe sugjerohet të përdoret. Rekomandohet dhe përdorimi i një spraji me përmbajtje jodi ose alumini siç është **Silver Spray**. (Shitjet – Austria Praemix)

6. Pse viçat duhet të pozicionohen shtrirë me gjoks në tokë dhe duhen mbajtur në grupe të veçanta?

Pozicioni me gjoks shtrirë në tokë është mjaft i përshtatshëm për sistemin e qarkullimit të aparatit tretës të viçave, për të reduktuar rrezikun e gazrave. Viçat e shëndetshëm duhet të mbahen të ndarë dhe në kashtë të pastër, për të shmangur dëmtimet ose ndotjen nga viçat e semurë.



Fig. 1: 10-15 minuta para procedurës viçave u injektohen qetësues.

II. Udhëzime për heqjen e brirëve

1. Përgatitja:

Programi fillestar:

- Të përgatitet lista e viçave të shëndetshëm, të moshës 2 deri në 6 javësh.
- Të përcaktohet takim me veterinerin për të kaluar në anestezi viçat dhe të blihet qetësuesi tek farmacia veterinare.

Materialet:

- ♦ Shiringa dhe gjilpëra
- ♦ Qetësues kundra dhimbjeve (NSAID)
- ♦ Furnizimi me energji elektrike, zgjatues kablllo
- ♦ Gërshërë ose makinë rroje
- ♦ Shufër hekuri me kokë me djegie krejtësisht të pastruar
- ♦ Spraj blu, spraj alumini ose jodi



Fig. 2: Pas heqjes së qimeve, sythi i bririt është mjaft i dukshëm.



Fig. 3: Pas heqjes së qimeve, sythi i bririt është mjaft i dukshëm.

2. Kryerja e procesit:

- ♦ Të bëhet injektimi i qetësuesve nga mjeku veteriner
- ♦ Të bëhet injektimi i menjëhershëm i anestezikëve
- ♦ Të pritët 10-15 minuta deri në dhënien e efektit të dëshiruar
- ♦ Heqja e qimeve me gërshërë rreth sythit të bririt
- ♦ Zgjedhja e madhësisë së kokës me djegie sipas asaj të sythit të bririt
- ♦ Fiksimi dhe rregullimi i kokës së viçit nga një person i dytë
- ♦ Të pritët derisa të arrihet temperatura maksimale e kokës me djegie
- ♦ Të vendoset koka me djegie për 5-10 sekonda deri në formimin e një kanali 4-5 mm të thellë rreth sythit të bririt. (Kujdes: Mbas 15 sekondash ekziston rreziku i dëmtimit të trurit)
- ♦ Përdorimi i sprajit blu, sprajit të aluminit ose të jodit
- ♦ Vendosja e viçave të sapo dalë nga kjo procedurë në gjendje të palëvizshme dhe të ndarë nga të tjerët deri në rikuperimin e tyre

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

27. PLANI I PIRJES TE VIÇAT E QUMËSHITIT DERI NË SHKËPUTJE

Përpunuar nga Rexhep Peposhi



Zakonisht rritja e shëndetshme e viçave zgjat deri në dymbëdhjetë javë

Për një rritje “normale” dy javore nevojiten 55 L kulloshtë - ose qumësht i plotë, 470 L qumësht i ftohtë, 80 deri 110 kg starter (koncentrat për vica) dhe rreth 50 kg bar ose kashtë. Plani i pirjes dhe ushqimit:

Mosha në javë	L/Vakt	Ujë	Koncentrat viçash (Starter)	Bar
2	2.5	Sipas dëshirës	Sipas dëshirës deri rreth 1.5 kg	Sipas dëshirës
3	3.0			
4	3.5			
5	4.0			
6	4.0			
7	3.5			
8	3.0			

Në javët e para të jetës (rreth 40L në javët e para të jetës). Dhënia e kulloshtës së parë 2L. Menjëherë pas lindjes dhënia e „KALBI VITAL”

Në javën e dytë fillon dhënia e koncentratës për vica (starter). Vicit duhet ti ofrohet bar i thatë cilësor dhe kashtë sipas dëshirës gjatë gjithë fazës së rritjes. Koncentrati i vicave (starteri) duhet të ofrohet gjatë gjithë periudhës së rritjes d.m.th. deri sa konsumi ditor të arrij 1,5kg koncentrat / ditë.

Në javën e funditsia e pirjes 2 litra çdo vakt reduktohet deri në zero litra.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

28.KULLOSHTRA PËR VIÇA TË SHËNDETSHËM

Përpunuar nga Dardan Grajçevci



Kulloshtra: Një furnizim i mjaftueshëm me kulloshtrë është thelbësor për shëndetin dhe zhvillimin e viçit të porsalindur. I porsalinduri duhet të ketë konsumuar të paktën tre litra kulloshtrë jo më vonë se dy orë pas lindjes.

Rreth 1/3 e të gjithë viçave në Europë kanë një furnizim të pamjaftueshëm të imunoglobulinave, pra niveli i përgjithshëm i proteinave në serum nën 52 g / l ose nivelet e imunoglobulinës në serum nën 10 g / l. Rezultatet e një studimi në të cilin pesha specifike e kulloshtrës u përcaktua duke përdorur një "kolostro-metër" çuan në deklaratat e mëposhtme: Matja me kolostro-metër lejon vetëm nxjerrjen e konkluzioneve të pjesshme në lidhje me përmbajtjen imune, meqënëse pesha specifike përcakton vetëm përmbajtjen e proteinave të kulloshtrës dhe nuk riprodhon atë të imunoglobulinave.

Kulloshtra e lopëve me një maksimum prej dy viçash ka një peshë specifike më të ulët se ajo e lopëve me disa laktacione. Këto ndryshime vijnë kryesisht nga përqendrimi i ndryshëm i përbërësve të qumështit dhe jo nga përqendrimi i ndryshëm i imunoglobulinës.

Cilësia e kulloshtrës nuk ndikohet nga periudha e thatë. Nëse qumështi "rrjedh" gjatë periudhës së thatë, cilësia e kulloshtrës është më e keqe. Viskoziteti dhe ngjyra e kulloshtrës nuk lejojnë që të nxirret ndonjë konkluzion në lidhje me cilësinë e tij. Sezoni ka ndikimin më të madh në kulloshtrë: pesha specifike ose përmbajtja e proteinave është më e ulët në verë.

Niveli i imunoglobulinës G mbetet i paprekur. Njerëzit ushtrojnë ndikimin më të madh në transmetimin e imunoglobulinës tek viçi: Për shkak të përmbajtjes më të lartë të imunoglobulinës te lopët me prodhim të lartë, vihet re efekti i hollimit, ku kulloshtra ulet me 3.7% në orë. Viçi mund të marrë vetëm një sasi të kufizuar qumështi pas lindjes, kjo varet nga përqëndrimi më i lartë i mundshëm i antitropave.

Higjiena në prodhimin e kulloshtrës ndikon drejtpërdrejt në përmbajtjen e mikrobeve dhe zhvillimin e diarresë tekviçat e porsalindur. Gjithashtu është provuar një efekt negativ i konsumimit të sasive më të mëdha të kulloshtrës - tre litra dhe më shumë - si dhe administrimi i kolostrumit përmes një tubi në rumen ("zhytje") mbi shpejtësinë e zbrazjes së abomasumit dhe transferimit të imunoglobulinës. Teste të shpejta përmes gjakut kryhen zakonisht në stalla për përcaktimin e furnizimit me imunoglobulinë të viçit.

Një studim tjetër vendosi në vëmendje praktikën joadekuate të të ushqyerit. Arsyeja për këtë është një sondazh i 102 fermave në Ishujt Britanikë, sipas të cilit më pak se 30% e viçave në një moshë prej tre javësh arritën të kishin më shumë se 700 g shtim të peshës ditore. Në këtë kontekst, u tregua se në një fermë të specializuar nëmbarshtimin e viçave, kryesisht viça të gjenetikave të ndryshme, u sëmuren shumica e viçave me një peshë të ulët trupore. Gjithashtu, u bë një zbulim i mëtejshëm: prognoza për një kurim të plotë të "gripit të viçit" ose të njëbronkopneumonie enzootike ishte edhe më i pafavorshëm.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

29. CILËSIA E KULLOSHTRËS ËSHTË VENDIMTARE

Përpunuar nga Kristian Maka

Kulloshtra është me rëndësi jetike për viçin e porsalindur. Dhënia e menjëhershme ka rëndësi të veçantë. Cilësia e kulloshtrës ndikohet prej ushqimit, sistemit të mbarështimit, si dhe nga shëndeti i lopës.

Dhënia e kulloshtrës duhet të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, sepse cilësia dhe përthithja e saj në zorrë bie menjëherë pas lindjes.

Brenda 3 orëve të para të jetës viçi duhet të pijë 1.5 deri në 2 litra kulloshtrë.

Pas 3 orëve e në vazhdim duhet të konsumojë edhe njëherë sasinë prej 1.5 deri në 2 litra.

Nëse viçi nuk ka marrë kulloshtrë pas 12 orësh, atëherë e gjithë sasia prej 4 litrash, e ndarë në dy porcione, duhet të jepet me anë të sondës.

Në orët e para të jetës, sasia që viçat mund të pijnë është rreth 1,5 deri në 2 litra. Nevojat ditore të viçit për qumësht arrijnë gjatë këtyre ditëve nga 10% deri 12% të peshës trupore. Për këtë arsye në këtë periudhë është më mirë që qumështi të jepet tre herë në ditë sesa dy herë.

Kjo mënyrë duhet të zbatohet veçanërisht në ato ferma, në të cilat shfaqen më shpesh simptomat si diarreja.

Mbrojtja nga mikrobet patogjene, shkaktarë të sëmundjeve

Viçi i porsalindur, vetë nuk është i aftë të mbrohet aktivisht nga bakteret patogjene që shkaktojnë infeksione. Në fillim të jetës së tij, viçi është në varësi të plotë nga konsumi i kulloshtrës dhe i lëndëve mbrojtëse që përmban ajo.

Përmbajtja më e lartë e imunoglobulinës në kulloshtrë është direkt pas lindjes, por ajo bie shumë shpejt. Për më tepër imunoglobulina depërton muret e zorrëve vetëm në orët e para pas lindjes dhe arrin deri në gjak duke mbrojtur kështu viçin nga mikrobet patogjene të sëmundjeve.

Cilësia e kulloshtrës

Gjatë periudhës së tharjes, në gjirin e lopës, përqëndrohen antitropa, si dhe elemente të tjerë të qumështit dhe gjakut. Këto përftohen në 4 deri në 6 mjeljet e para pas lindjes. Përbërja e qumështit të kulloshtrës ka ndryshim të dukshëm nga qumështi i qarkulluar (Tabela 1).

Në shumicën e rasteve, kulloshtra e lopëve, të cilat japin më pak se 8,5 litra në mjeljet e para, ka përqëndrim më të lartë të imunoglobulinës, se ajo e lopëve me sasi më të lartë qumështi në mjeljet e para. Në përgjithësi ndodh që lopët më të vjetra kanë kulloshtrë më të mirë, se lopët më të reja.

Përveç kësaj, përparësi duhet t'i jepet kulloshtrës së lopëve që kanë ndenjur më gjatë në tufë, sepse ato kanë fituar antikorpe të veçanta në stallë. Prandaj, lopët barrëse duhet të lihen në tufë gjashtë ose tetë javët e fundit para lindjes, në mënyrë që të mësohen dhe përshtaten me ambientin.

Periudha e tharjes duhet të jetë gjashtë deri në tetë javë. Në rast se periudha kohore është më e shkurtër apo më e gjatë, si pasojë do të kemi një cilësi më të dobët të kulloshtrës. E rëndësishme është që thithat të mos kenë mundësi derdhjeje gjatë kohës së tharjes, përndryshe kulloshtra që para lindjes do të derdhet dhe viçi nuk do të ketë mundësi të pijë. Lopët që e kanë gjirin e irrituar sidhe ato që milen para kohe kanë një cilësi të dobët të kulloshtrës.

Tabela 1

Lënda përbërëse	Kulloshtra (menjëherë pas lindjes)	Qumështi i qarkulluar
TS (%)	22	12
Ynyrna (%)	6,5	3,7
Proteina (%)	23,1	3,5
Karbohidrate (%)	2,1	4,8
Vitamin A (IE)	12.000	700
Vitamin D (IE/g yndyrma)	0,9 – 1,8	-
Vitamin E (µg/g yndyrma)	84	15
Antitropa (%)	8	0,09

Evitimi i stresit

Përkujdesja dhe shëndeti i lopës mëmë ndikojnë tek viçi i palindur si dhe te cilësia e kulloshtrës. Kjo do të thotë që gjatë kësaj periudhe është i rëndësishëm evitimi i stresit. P.sh. nëse gjatë kësaj periudhe, një lopë ka stres nga i nxehti, konsumon më pak ushqim.

Ruajtja e rezervave

Kulloshtra me cilësi të lartë, sidomos ajo e lopëve më të vjetra, që nga laktacioni i tretë, duhet të ruhet si rezervë në gjendje të ngrirë (jo më shumë se një vit) kështu ajo mbetet në dispozicion në rast nevoje.

Kulloshtra duhet të shkrijë në temperaturë maksimale 40°C, në të kundërt e humbet efektin e saj mbrojtës pasi Immunoglobulinat mund të dëmtohen.

Vetitë e kulloshtrës

- ◆ Presioni i duhur, bën që kulloshtra të dalë me lehtësi
- ◆ Krijon imunitet pasiv nëpërmjet përmbajtjes së lartë të Immunoglobulinës (lëndë mbrojtëse)
- ◆ Furnizimi me lëndë ushqyese me rëndësi jetike si pasojë e përmbajtjes së lartë në proteina, Immunoglobulinë e veçantë, lëndë minerale dhe vitamina.
- ◆ Ndikime lokale ndaj mikrobeve të ndryshme patogjene, në zorrë.
- ◆ Mbrojtja pasive e kulloshtrës rritet gradualisht, ndërkohë që aktivizimit të mbrojtjes imunitare i duhet kohë të krijohet. Viçi fiton imunitet vetëm pas rreth katër javëve të para të jetës.

Për më shumë informacion:



QF PB Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

30.KËSHITU PËRFITOHET NGA RRIJTJA E VIÇAVE TË VEGJËL

Përpunuar nga Kristian Maka



Kostoja e rritjes së viçave është e lartë. Por si përmirësohet përfitimi? Numri i saktë i viçave, lindja e viçit të parë në moshë të re dhe një ecuri e mirë e viçave është vendimtare për suksesin.

Bazuar në rezultatet e studimeve të vitit 2015 mbi tufat (Dhoma e Bujqësisë Schleswig- Holstein), kostot totale të rritjes, mesatarisht për 502 ferma të analizuar, kapin një vlerë prej 1.652 Euro. Kostot direkte rezultuan 1.242 Euro për mëshqerra në lindjen e parë në një moshë 29 muajshe, rezultate të cilat mund të përmirësohen.

Numri i viçave dhe moshë në lindjen e parë

Sa më i lartë numri i kafshëve të remontit, aq më shumë mëshqerra nevojiten. Kur numri i kafshëve të remontit rritet ndjeshëm mbi 40%, atëherë pasardhësit nuk mjaftojnë për zëvendësimin e tyre (tabela 1). Kur rritet moshë e lindjes së parë, duhet të rritet dhe kontigjenti i kafshëve për remont. Kjo do të thotë më shumë kapacitet në stallë, më shumë ushqim, më shumë ngarkesë pune. Ulja e moshës në lindjen e parë redukton kostot e rritjes. Studimet ndërkombëtare tregojnë gjithashtu, se mëshqerrat në një moshë lindjeje të parë ndërmjet 24 dhe 28 muaj kanë një rendiment më të lartë se lopët që lindin më vonë.

Tabela 1: Situata në fermë

100 lopë	47 viça femër/vit	
50% viça femër/50 % viça meshkuj	5% Shkalla e dështimit gjatë rritjes	
5% humbjet në viça rreth periudhës së pjelljes	370 ditë periudhë mes dy pjelljesh	
Shkalla e skartimit në %	Kafshë të nevojshme në vit	Numri i viçave që do të mbahen moshë e lindjes së parë (muaj)
24	26	28 30 32
25	26	52 56 61 65 69
30	32	64 69 75 80 85
35	37	74 80 86 93 99
45	47	94 102 110 118 125

Mëshqerrat në këtë moshë lindjeje të parë japin në 305ditë laktacioni afërsisht 10.350 kg qumësht. Mëshqerrat në moshë lindjeje të parë ndërmjet 28 dhe 30 muaj kanë një prodhimtari pak më të lartë. Megjithatë te këto kafshë investohet mesatarisht tre muaj më shumë në rritjen e tyre.

Në vitet e fundit Hülsenberg (stacioni kërkimor i Schaumann) uli mesataren e moshës së lindjes së parë nga mbi 29 muaj në afërsisht 25,5 muaj. Është e rëndësishme të theksohet, që gjatë periudhës së kullotjes kafshët që mund të insemenoheshin, u insemenuan dhe muajt e verës nuk u llogaritën në moshën e lindjes së parë.


Intesiteti i rritjes

Në momentin e lindjes, lopët duhet të jenë në fazën e duhur të zhvillimit (tabela 2). Nëse duhet të realizojmë pjelljen e parë në një moshë më të hershme, duhet të synojmë një rritje intensive të viçit.

Në Hülsenberg u praktikua me sukses pjellja e parë në një moshë më të re. Periudha 2-javore e kullotës mbyllet me produktin "Kalbi Milch Premium Spezial". Krahas këtij produkti u ofrohet shtesë dhe Kalbi Flocs në sasi të vogla. Në 5-6 javët e para viçat ushqehen me "Kalbi Milch Premium Sweet". Si fillim, paralelisht me këtë ata marrin "ad libitum Kalbi Flocs", që shoqërohet me një ushqim për rritjen e viçave, i cili përmban "Kalvicin Pro". Pas shkëputjes viçave u ofrohet racion ushqimor i përzier i lopëve me qumësht për një periudhë afërsisht 10-mujore. Racioni i përzier, i cili është i pasur me të gjitha vlerat ushqimore, përmbush më së miri kriteret për zhvillimin e duhur. Nën një vit viçat peshojnë afërsisht 370 kg. Në muajin e 15-të fillon inseminimi në Hülsenberg. Për kafshët që peshojnë pak inseminimi fillohet afërsisht dy muaj më vonë.

Tabela 2. Ndikimet e rritjeve të ndryshme ditore në moshën e lindjes së parë (pesha finale: 700kg)

Efektet e rritjes ditore në moshën e lindjes së parë



Viçat në Hülsenberg fillojnë të kullosin pasi kanë mbushur 10 muaj. Në këtë mënyrë sigurohet zhvillim optimal në vitin e parë, me një rritje ditore afërsisht 900 gr, sepse në periudhën që dalin në kullotje është shpesh e vështirë të arrihet një rritje ditore mbi 500 gr.

Kostot e e rritjes

Studimet e dy viteve të fundit treguan një kosto totale prej 1.150 euro/kafshë. Kostot direkte arritën afërsisht vlerën 800 euro/viç. Kostot indirekte (p.sh kostote punës, kostote ndërtesës, kosto të tjera) arritën një vlerë prej 350 euro. Shifrat tregojnë se pavarsisht intensitetit më të lartë për shkak të shkurtimit të kohës së zhvillimit, kostot e zhvillimit mund të reduktohen.

Raportet gjithashtu theksojnë se shitja e kafshëve të remontit, ka kuptim vetëm në momentin kur çmimi i mëshqerrave në treg është relativisht i lartë.

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

31.PËRPUNIMI I QUMËSHTIT NË FERMË

Përpunuar nga Kristian Maka

Fermerët që mbajnë lopë, dhi, dele... mund ta përpunojnë dhe tregtojnë qumështin në produkte të ndryshme. Kjo ndodh sepse çdo fermë është e regjistruar si subjekt i biznesit me numrin identifikues NIPT. Si çdo subjekt i biznesit ushqimor, ai i nënshtrohet dispozitave të ligjit për ushqimin.

Siguria ushqimore është një nga parimet më të rëndësishme të të gjitha kërkesave ligjore. Çdo subjekt i biznesit ushqimor duhet të sjellë në treg vetëm produkte të sigurta. Ai është përgjegjës për sigurinë e produkteve në zonën e tij. Produktet duhet të jenë të gjurmueshme. Garantimi i kësaj forme sigurie arrihet nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të një sistemi vetëkontrolli.

Sistemi i vetëkontrollit

"Udhëzues për fabrikat e përpunimit të qumështit në fermë" mund të shërbejë si një ndihmë për krijimin e një sistemi vetëkontrolli.

Udhëzuesi përmban të gjitha kërkesat që duhet të plotësohen:

1. Listat kontrolluese për pajisjet e ambienteve
2. Modelet për planet e pastrimit dhe dezinfektimit
3. Planet e kontrollit të insekteve/parazitëve
4. Informacion mbi praktikën e mirë të prodhimit

- ♦ Proçeset e prodhimit
- ♦ Informacion mbi magazinimin
- ♦ Informacion mbi testimin e produktit të përshkruar

Nëse ky udhëzues plotësohet me ndërgjegjie dhe nëse zbatohen masat, atëherë kemi një sistem të mirëfilltë vetëkontrolli.

Në vijim veçojmë dhe shpjegojmë disa pika të rëndësishme:

Kërkesat për ambientet - ruajtja e qumështit

Qumështi duhet të ruhet në dhomën ftohëse derisa të transportohet në dhomën e përpunimit.

Përpunimi i qumështit

Përpunimi bëhet në një dhomë të veçantë të përpunimit – e ndarë me hapësirë nga prodhimi dhe ruajtja e qumështit. Kjo hapësirë anash pajisjes duhet të jetë e konsiderueshme, për të lejuar akses të lehtë dhe hapësirë të mjaftueshme magazinimi. Muret anësore, dyshemetë dhe tavanët duhet të jenë të pastër, të dezinfektuar dhe të mirëmbajtur. Zona për pastrimin dhe dezinfektimin e duarve duhet të jetë në një hapësirë të veçantë.

Maturimi i djathit

Ky proces realizohet në një dhomë të veçantë, në kabinete ose kontejnerë maturimi – në varësi të proçesit.

Sistemi i ftohjes

Kur bëhet fjalë për higjienën, ftohja luan një rol të rëndësishëm për qumështin dhe produktet e qumështit.

- ♦ Qumështi duhet të ftohet gjithmonë në një temperaturë prej 6 °C ose edhe më pak, sa më shpejt që të jetë e mundur. Përfshihet rasti kur qumështi përpunohet brenda katër orëve ose nëse është maturuar paraprakisht gjatë prodhimit të djathit.
- ♦ Zinxhiri i ftohjes nuk duhet ndërprerë gjatë transportit të qumështit apo produkteve të tij.

Pastrimi dhe dezinfektimi

Pastrimi dhe dezinfektimi i pajisjeve, mjeteve ndihmëse të përdorura, enëve të përpunimit, makinerive të përpunimit, si dhe të gjitha zonave të punës, duhet të kryhet me agjentë pastrimi dhe dezinfektues të krijuar enkas për këtë qëllim. Pastrimi dhe dezinfektimi kryhen (sipas planit) jashtë orarit të prodhimit dhe shpëlarja me ujë të pijshëm, në varësi të mjetit të përdorur, është shumë e rëndësishme.

Shëndeti dhe higjiena personale

- ♦ Të gjithë personat që janë në kontakt me produktet ushqimore duhet të jenë të shëndetshëm. Kushdo që vuan nga të vjellat, diarre ose simptoma të tjera duhet të bëjë pushim.
- ♦ Uniforma e veshjes duhet të jetë personale për çdo punonjës, me ngjyrë të hapur. Kapja e flokëve dhe vendosja e një kapeleje është e rëndësishme.

- ♦ Higjiena personale është esenciale (Larja e duarve)


Kontrollet e produktit

Produktet e qumështit duhet të inspektohen rregullisht për sigurinë ushqimore dhe kriteret e higjienës së procesit. Në rastin e sasive më të vogla të përpunimit dhe rrezikut të ulët të higjienës, kërkohet me ligj një herë në vit testimi i produktit me rrezikshmëri më të lartë. Specifikimet e sakta, tabela që liston kriteret që duhen ekzaminuar dhe renditja e produkteve sipas rrezikut mund të gjenden në udhëzues. Testimi i produktit kryhet në laboratorë të specializuar. Çertifikatat e testimit të produktit duhen ruajtur. Natyrisht që çdo mangësi e identifikuar gjatë vetëinspektimit, duhet të korrigjohet menjëherë.

Dokumentimi

Për ta bërë sistemin e vetëkontrollit të kuptueshëm për të huajt, duhet të dokumentohen:

- ♦ Të dhënat e funksionimit dhe prodhimit (nëse janë të disponueshme)
- ♦ Të dhënat për cilësinë e ujit të pijshëm për burim vetjak
- ♦ Dokumentet e produktit me argumente kritike kontrolli (p.sh. nga udhëzimet)
- ♦ Protokolli i gabimeve
- ♦ Checklistat për hapësirat, planin e pastrimit dhe dezinfektimit (plotësim/aktualizim çdo vit), formulari për kontrollin e instekteve/parazitëve në rast nevoje
- ♦ Rezultatet laboratorike (analiza e qumështit të papërpunuar, analiza e produktit)
- ♦ Rekomandohen regjistrime të vazhdueshme si pjesë e vetëmonitorimit dhe përshkrime të produkteve.



Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

32.VIÇA TË PËRGATITUR MIRË PËR STINËN E FTOHTË TË DIMRIT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Në fermat e prodhimit të qumështit, sëmundjet dhe humbjet e viçave ndikojnë negativisht në ekonominë e tyre. Kostot e larta për medikamente, kontrollet mjekësore dhe shpenzimet për përkujdesje çojnë në humbje të konsiderueshme financiare.

Edhe pse shkalla e sëmundshmërisë në muajt e ftohtë dhe të lagësht të dimrit rritet, kjo nuk do të thotë se është shkaku i vetëm i sëmundjes së viçave. Sëmundjet tipike sezonale janë ato të frymëmarrjes, sidomos gripi i gjedhit. Gripi është një faktor dytësor dhe prek më së shumti viçat e dobët dhe të prekur nga diarreja e hershme.

Shëndeti i mirë i zorrëve

Shëndeti i mirë i zorrëve është konsideruar si një themel i rëndësishëm për rritjen e suksesshme të viçave. Produkte me faktorin SSR (siguri/ shëndet/ rritje), të programit për viçat të Schaumann, mbështesin shëndetin e aparatit tretës.

Schaumann ofron një gamë të gjerë produktesh si zëvendësues të qumështit, komponentë dhe produkte speciale, të cilat kanë si synim përmirësimin e shëndetit të zorrëve që në fazat më të hershme të jetës. Gripi i gjedhit shpesh herë shfaqet në moshën nga 4 deri në 8 javë. Në këtë periudhë viçat përballen me „Sistem imunitar të ulët“ (Fig. 1) e cila bëhet më e dukshme nëse janë bërë gabime në fazën e të ushqyerit me kulloshtrë.


Furnizimi me kulloshtrë me sasinë, cilësinë dhe kohën e duhur, është themeli bazë për rezistencën e viçit. Kulloshtra me një cilësi të mirë, përftohet vetëm nga lopët të cilat gjatë periudhës së tharjes janë ushqyer në mënyrë optimale.

Përmbajtja e imunglobulinës në kulloshtrë dhe furnizimi i menjëhershëm pas lindjes me vitaminë A, përmirësohet ndjeshëm përdorimin e produktit Kalbi Vital dhe Kalbi Farm.

Pas fazës së ushqyerjes me kulloshtrë, pasurimi i qumështit në ditët e para me imunglobulin me veprimlokal, mund të sigurohet nëpërmjet produktit Kalbi-Start Super. Gjithashtu mund të përdoret dhe një zëvendësues qumështi si Kalbi Milch Plus Protect, me përmbajtje të probiotikut Provita LE.

Plotësimi me energji

Gjatë ushqyerjes së viçave në stinën e dimrit shpesh herë anashkalohet fakti se temperaturat e ulëta rrisin kërkesën për energji. Nevoja për rregullimin e temperaturës mund të shkojë deri në 35%.



Zëvendësuesit e qumështit si Kalbi Milch Classic ose Kalbi Milch Plus Protect janë vetëm dy nga mundësitë e shumta, që ofrohen për të përmbushur kërkesat në këtë situatë. Një rritje e sasisë nga 125 g zëvendësues qumështi/litër në 150 g/litër ose ushqime të lëngshme shtesë, mund të mbulojë nevojat shtesë të viçit.

Zëvendësuesit e qumështit me faktorin SSR përmbajnë kombinime të substancave aktive, të cilat mbështesin veçanërisht shëndetin e zorrëve. Probiotiku Provita LE, komponent me përmbajtje fibrash speciale dhe acide yndyrore speciale, janë kombinime të testuara prej vitesh.

T´i kushtohet vëmendje klimës në stallë

Përveç motit të ftohtë, viçat përballen me kushte të tjera të këqija si rryma e lartë e ajrit me nivele të larta të lagështisë. Situatën e përkeqësojnë rrymat e ajrit në stalla me ventilim të gabuar ose mbyllja e të gjitha dyerve dhe dritareve, rritja e nivelit të gazrave të dëmshme dhe lagështia e ajrit.

Mikrobet patogjene gjejnë kushte të përshtatshme për të dëmtuar viçat e pambrojtur. Gjatë stinës së dimrit duhet të merren masa të veçanta për procesin e rritjes. Ruajta e ambientit të thatë, të pastër, ruajtja nga korentet e ajrit, janë disa nga pikat kyçe që duhet t´i kushtohet vëmendje në këtë periudhë delikate për viçin.

Këto janë vetëm disa nga sfidat që përballen fermerët në stinën e dimrit dhe që mund të kompensohen nga viçat e shëndetshëm deri në një gradë të caktuar. Produktet e Schaumann ndikojnë pozitivisht në shmangien e diarresë në viçat e vegjël dhe ndihmojnë fermerin të rrisë viça të shëndetshëm.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

33. EVITIMI I HUMBJEVE TË VIÇAVE

Përpunuar nga Kristian Maka



1. Thithja e ndërsjellë tek gjedhi

Viçat e qumështit - problemi i thithjes së gjirit te lopët e qumështit

Humbjet e mëdha nga një menaxhim jo i mirë në stallat e viçave shkaktohen nga shumë faktorë. Njëri prej faktorëve është thithja tek viçat, tek gjedhi për mbarështim dhe tek lopët. Kjo sjellje mund të haset në masë në disa ferma dhe është një tregues i problemeve në menaxhimin e tufës.

Zanafillën e saj e ka që prej fazës së pirjes së gjirit. Dhënia e qumështit si ushqim eviton thithjen e gjirit. Shkak për këtë është Laktoza (sheqeri i qumështit). Për aq kohë sa viçi merr qumësht, ai është shumë i motivuar për të thithur. Një viç thith qumështin e nënës 10-12 herë në ditë, gjithsej 20 - 60 min në ditë. Në qoftë se viçave gjatë fazës së rritjes u jepet më pak ushqim, atëherë atyre u krijohet edhe deficiencë në thithje.

Stresi

Thithja konsiderohet si një refleks i lindur dhe jo vetëm. Thithja dhe lepirja e dyanshme vjen edhe si pasojë e stresit. Një viç i shëndetshëm është kureshtar, plot jetë dhe gjithmonë në kërkim të së resë. Ai e zbulon ambientin e tij duke lepirë. Në qoftë se viçit nuk i sigurohet vazhdimisht ushqim dhe ujë, atëherë pajisjet e stallës dhe pjesë të trupit të viçave të tjerë bëhen pre e lepirjeve dhe thithjeve.

Shpesh ky zakon i keq merret nga moshatarët. Nga ky zakon preket kryesisht gjedhi, i cili nuk ka mundësi kontakti me botën e jashtme dhe ndodhet në një stallë pa dalje në kullota.

Faza e largimit të zakonit

Direkt pas shkëputjes së gjirit, instikti i thithjes bëhet akoma më i fortë. Prandaj në fazën e shkëputjes shfaqet thithja e ndërsjellë tek ripërtypësit.

Gjatë një studimi u konstatua se racionimi i ushqimit së bashku me kohën e vënë në dispozicion për ushqyerje, luajnë një rol vendimtar. Një zëvendësim i silazhit të misrit me koncentre dhe sanë të cilësisë së mirë u siguron kafshëve një kohë më të gjatë ngrënieje dhe ripërtypjeje dhe pakëson rrezikun e thithjes tek kafshët e tjera. Përveç të tjerave, ky zakon lidhet edhe me mungesën e energjisë.

Nevoja për energji e viçave të shkëputur do të ishte më mirë të sigurohej nga koncentratu sesa nga silazhi i misrit. Viçat e shkëputur kanë nevojë për një premiks me përmbajtje të theksuar kalciumi dhe mikroelementesh, por me sasi të vogël fosfori.

Pasojat

Pasojat janë të ndryshme si acarimet, ndryshimet e qimes dhe diarreja. Duke thithur kërthizën rritet rrezikshmëria e acarimit të saj, si pasojë e një infeksioni bakterial. Llapa e veshit si dhe pjesa e brendshme e tij mund të acarohen në rastin kur kafshët thithin veshët e njëri-tjetrit. Nëpërmjet lepirjes të ndërsjellë, në aparatit e tretjes së kafshëve mblidhen qime, të cilat bashkë me jargët formojnë një topth. Ky topth mund të shkojë nga 15 - 20 cm tek kafshët më të rritura duke shkaktuar dëmtime të aparatit tretës, kapsllëk, madje deri edhe ngordhjen e tyre. Simptomat e diarresë shpesh shkaktohen edhe nga ngrënia e shtresës së kashtës si dhe e jashtëqitjes.

Dëmtimet e gjirit të shkaktuara nga thithja, zakonisht vihen re që në laktacionin e parë. Lopët e laktacionit të parë me çerek gjiri "të verbër" (tre kanale qumështi), me acarime akute ose kronike të gjirit si dhe një lopë që thith të tjerat e mbajtur në padok mund të shkaktojnë dëme të rënda ekonomike.

Masat paraprake

E vetmja mundësi që t'u hiqet ky zakon kafshëve, marrë shkas dhe nga efektshmëria në praktikë, janë hundëset. Krahas evitimit të simptomave duhet të merren edhe masa të tjera parandaluese:

- ♦ Koha e thithjes për çdo konsum të racionit ushqimor duhet të jetë rreth 10 min.
- ♦ Pas pirjes viçat veçohen 10 – 30 min, derisa të jetë larguar pak ky zakon i thithjes.
- ♦ Mundësia e qëndrimit në padok.
- ♦ Ushqim i cilësisë së lartë dhe ujë i pastër (që nga java e dytë e jetës).
- ♦ Përdorimi i koncentratit (pas javës së dytë të jetës).
- ♦ Shmangia e humbjeve të energjisë në fazën e shkëputjes.
- ♦ Vëzhgimi në vazhdimësi i ecurisë së viçave.

2. Humbjet e viçave ulen me anë të higjienës në stallë

Një problem tjetër është mungesa e higjienës në stallë. Mbajtësi i jashtëqitjes dhe shpërndarja nga shkëmbyesit e qumështit vështirësojnë marrjen e masave higjienike në stallë.

Çfarë duhet bërë për të evituar humbjet e viçave?

Menaxhimi i higjienës:

- ♦ Përgatitja e një plani pastrimi dhe dezinfektimi.
- ♦ Përdorimi i mjeteve të pastrimit kundër yndyrës si dhe uji i nxehtë.
- ♦ I këshillueshëm është një pastrim i ndërmjetëm si dhe dezinfektimi i viçave me mjete dezinfektuese, si p.sh. mjet dezinfektues Endosan Forte S NEU, ose Organosept NEU, në periudhën e majmërisë.
- ♦ Pastrim çdo ditë në vendet e ushqimit dhe jashtëqitjes, si dhe çdo javë të bëhet dezinfektimi i tyre me anë të mjeteve dezinfektuese (p.sh. ato të Schaumann).
- ♦ Të dezinfektohen çdo ditë, pas çdo përdorimi, enët e pirjes, salla e ushqimit të viçave të majmërisë dhe të mbarështimit. Të merren parasysh mjetet për dhënie e zëvendësuesit të qumështit.
- ♦ Rreth 100 gr pluhur higjienik, Profi-Streu në bokset e viçave ul akoma më shumë numrin e mikrobeve dhe përmirësohet higjiena.

Marrja e masave kundër diarresë:

Një problem specifik i higjienës në mbajtjen e viçave është shfaqja e simptomave të diarresë, të shkaktuara nga Kryptosporidet. Mund të arrihet në një dehidratim masiv të viçave me diarre.

Viçat e infektuar sekretojnë mikrobet patogjene jetëgjata (Oozysten infektuese) dhe infektojnë stallën.

Masat e efektshme për luftimin e Kryptosporideve janë:

- ♦ Pastrimi sistematik dhe dezinfektimi me 3% Endosan Forte S NEU me kohë veprimi një orë
- ♦ Realizimi i pastrimit me ujë të ngrohtë me mbi 60°C dhe lënia për një periudhë të gjatë për t'u tharë, pasi në lagështirë mikrobet patogjene jetojnë akoma më gjatë
- ♦ Boshatisja e stallës sipas konceptit: gjithçka brenda – gjithçka jashtë
- ♦ Veçimi i menjëhershëm në një godinë tjetër i kafshëve të sëmura
- ♦ Gjithmonë në fillim të bëhet trajtimi i kafshëve të shëndetshme dhe pastaj i atyre të sëmura. Veshjet duhet të ndërrohen ose të dezinfektohen menjëherë pas kontaktit me kafshën e sëmurë
- ♦ Në rastet kur origjina e infeksionit të lopëve prej Kryptosporideve është e njohur, viçi duhet larguar menjëherë pas lindjes prej lopës

Kalbivital

Pasta për viça me shije që shërben për rritjen e vitalitetit që në javët e para të jetës. Kombinimi i Immunglobulinës (pluhur veze) me PROVITA LE përforcon ndikimin e Klostrumit tek viçat e posalindur dhe stabilizon florën e zorrëve në situatat e stresit si p.sh. në rastet kur viçi ndërron stallë. Vitaminat A, D, E dhe C forcojnë imunitetin si dhe nxisin vitalitetin.

Përdorimi:

- ♦ 10 ml direkt pas lindjes
- ♦ 5 ml në ditën e dytë të lindjes
- ♦ Në rastet kur ka shqetësime të zorrëve dy ditë rresht nga 10 ml
- ♦ Viçat që pijnë direkt tek lopa mëmë duhet të marrin 15 ml në ditët e para të jetës

Kalbivital:

- ♦ Përmirëson shtesën ditore
- ♦ Redukton dëmtimet e aparatit tretës
- ♦ Përdorim individual, i thjeshtë dhe ashtu si duhet



Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

34. AD LIBITUM PËR VIÇA TË SHËNDETSHËM

Përpunuar nga Kristian Maka



Një numër i madh studimesh dhe përvojash praktike gjatë viteve të fundit tregojnë se të ushqyerit intensiv i viçave me qumësht është jo vetëm i favorshëm në planin afatshkurtër, por gjithashtu ndikon në performancën e mëvonshme dhe stabilitetin metabolik të lopëve të qumështit për një kohë të gjatë.

Shpesh gjatë rritjes së viçave aplikohet përdorimi i sasive sa më ulëta të qumështit, në mënyrë që ata të ktheheshin shpejt në ripërtypës. Megjithatë, këto rekomandime për të ushqyerin, të cilat ishin mjaft të zakonshme deri para disa vitesh, nuk korrespondojnë me kërkesat aktuale të viçave për energji dhe proteina.


Rezultatet e të ushqyerit Ad- Libitum:

- Zhvillim më i mirë, shtim më i lartë ditor në peshë dhe rezistencë më e lartë ndaj sëmundjeve
- Konsumi i ushqimit të koncentruar nuk zvogëlohet si pasojë e konsumit të lartë të qumështit, por rritet për shkak të sasive të mëdha të qumështit, nuk ka më tendencë për diarre
- Nuk dallohet asnjë vonesë në zhvillimin e rumenit
- Kostot për sasi më të larta të qumështit janë ulur, për shkak të punës më të vogël dhe më pak probleme me thithjen e ndërsjellë

Parakushte për të ushqyerit Ad libitum

- Qumështi duhet të acidifikohet kur përdoret si pije ad libitum
- Qumështi duhet të jetë gjithmonë i disponueshëm për viçin, kovat nuk duhet të jenë kurrë bosh
- Kovat duhet të mbulohen (mizat)
- Ofrimi i ushqimit të koncentruar, sanë dhe ujë

Plani 8-javor



Fundit i ushqyerjes Ad-Libitum

Ky grafik tregon një konsum më të lartë të qumështit nga viçat e ushqyer ad- libitum krahasuar me viçat e ushqyer në mënyrë restriktive.

Acidifikimi i qumështit me acid formik

Për të acidifikuar qumështin, acidi i koncentruar duhet të hollohet. Hollimi duhet të përgatitet në një enë plastike pasi është gërryes.

Duhet të respektohen hapat e mëposhtëm:

- Një litër acid formik 75% (kujdes, është shumë gërryes! Përdorni veshje të përshtatshme, syze mbrojtëse dhe doreza!) hollohet me 9 litra ujë. Acidi duhet të hidhet në ujë.
- Nga ky hollim shtohen 10 – 20 ml për litër pije nga kolostrumi i dytë ose i tretë.
- Në vijim 20 – 30 ml për litër.
- Kur shtoni acid, qumështi nuk duhet të jetë më i ngrohtë se 30 °C.

- ♦ Përziejeni shumë mirë kur shtoni holluesin.
- ♦ Si rezultat i këtij acidifikimi, qumështi arrin një vlerë pH prej 5.5. Nëse konsumi është shumë i lartë, duhet zgjedhur një vlerë pH pak më e ulët – 5.3
- ♦ Nëse konsumi është shumë i ulët – zgjidhni një vlerë pH pak më të lartë – 5.8
- ♦ Mund të konsumohet menjëherë. Pas acidifikimit të plotë brenda 2 deri në 3 orësh, mund të ruhet deri në një javë.



Kontrollimi i qumështit të acidifikuar me një matës pH është më i besueshëm sesa testimi me shirita ngjyrues

Pijet e tharta (të ftohta)

Pijet e tharta janë qumësht paksa i acidifikuar që mund të pihet edhe i ftohtë. Acidifikimi mund të bëhet me acide organike (p.sh. acid formik, citrik, acetik, aditivë të gatshëm etj.) ose me kos (acid laktik natyral).

Qumështi i acidifikuar tretet më lehtë, sepse qumështi tashmë është "tretur paraprakisht" nga shtimi i acidit. Ulja e vlerës së pH të qumështit do të thotë gjithashtu se patogjenët e diarresë në stomak dhe zorrë, si E. coli, janë në gjendje të përhapen më pak. Në praktikë pijet e tharta, për problemet e diarresë janë më të efektshme.

Të ushqyerit në dimër:

- ♦ Në dimër, pjesë të ndryshme të pirëses ose pjesa e mbetur e qumështit mund të ngrijnë. Në dimër, ofroni qumësht të acidifikuar dhe të ngrohtë.
- ♦ Gjatë vakteve ofroni vetëm sasinë e qumështit të ngrohtë, që viçi mund të konsumojë brenda një ore (rreth 4–5 litra) dhe më pas hiqeni kovën.
- ♦ Nëse sasia e qumështit të konsumuar në vaktet normale është shumë e vogël, ushqejini viçat edhe në mesditë.

Pse viçat duhet të ushqehen me më shumë qumësht:

- ♦ Qëllimi i të ushqyerit për ta kthyer viçin në ripërtpës nuk duhet të ekzistojë.
- ♦ Ushqyerja Ad Libitum ose ushqyerja me qumësht duhet të jetë sa 20% e masës trupore të kafshës në ditë.
- ♦ Përdorimi i programit metabolik – që rezulton në performancë më të lartë si te meshkujt ashtu edhe te femrat është një investim në të ardhmen.
- ♦ Të ushqyerit jo Ad Libitum, por në mënyrë të kufizuar me qumësht krijon një ndjenjë të përhershme urie.

- ♦ Ushqimi i fortë nuk arrin të tretet mjaftueshëm në muajin e parë të jetës, trajnimi i viçave për të ripërtpur përmes reduktimit të sasisë së qumështit nuk korrespondon më me praktikat aktuale të rritjes së viçave.

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

35.SËMUNDJET QË SHKAKTOJNË HUMBJE TË VIÇAVE - PARANDALIMI DHE KONTROLLI

Përpunuar nga Kristian Maka

Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes te viçat dhe lopët e reja- krahas simptomave të diarresë - pavarësisht vaksinave të reja dhe metodave më të mira të ekzaminimit diagnostikues, janë sëmundjet më të rëndësishme të tufës gjatë fazës së rritjes.

Lloje të ndryshme virusesh, bakteresh dhe faktorë të shumtë të mbarështimit dhe të të ushqyerit mund të përfshihen në zhvillimin e sëmundjes. Gripi i gjedhit konsiderohet një sëmundje shumëfaktoriale. Llojet e virusit të zbuluar këtu janë të pranishme në shumicën e fermave. Vetëm përmes faktorëve të pafavorshëm mjedisorë, si ndryshimi i klimës në stallë, këta patogjenë çojnë në simptoma akute.

Gripi i gjedhit fillon me një infeksion viral të vetëm ose të përzier, i ndjekur nga një infeksion dytësor bakterial pas 3–5 ditësh. Patogjenët bakterialë, kryesisht Pasteurella, gjenden gjithashtu në mukozën e traktit të sipërm respirator të bagëtisë së shëndetshme. Në këto kushte të favorshme, patogjenët bakterialë mund të përparojnë drejt mushkërive si rezultat i infeksionit të mëparshëm me virus, i cili çon në dëmtim të drejtpërdrejtë të qelizave të traktit respirator dhe dëmton funksionet mbrojtëse lokale. Patogjenët viralë të gripit shumëfaktorial të gjedhit dhe sëmundjet e mundshme të pavarura të frymëmarrjes janë renditur në figurën 1.

Pas infektimit, viçat fillimisht shfaqin sekrecione të ujshme të hundës, frymëmarrje të përshpejtuar, kollë dhe temperaturë deri në 41°C. Pas 3–5 ditësh, natyra e rrjedhjes së hundës ndryshon, bëhet gjithnjë e më viskoze dhe përmban përzierje purulente. Infeksioni dytësor bakterial ka filluar. Ajo çon në bronkopneumoni purulente dhe një sëmundje të përgjithshme të rëndë. Në shumë raste, fermerët vetëm në këtë stad të sëmundjes vërejnë se viçat e tyre janë të sëmurë.

Përmirësoni klimën në stallë

Një luftë e synuar kundër sëmundjeve të frymëmarrjes kërkon kontrolle gjithëpërfshirëse në fermë. Kjo përfshin vlerësimin e strehimit dhe të ushqyerit, ekzaminimin e kafshëve të sapo sëmura me simptoma sipërfaqësore dhe dërgimin e mostrës për ekzaminim të mëtejshëm në laboratore speciale.

Mosbalanca në rritje dhe të ushqyerit, janë faktorët më të zakonshëm shkaktarë për infeksionet akute të frymëmarrjes. Një rrezik i veçantë është klima e pafavorshme e stallës. Hapësira ajrore shumë e vogël, shpejtësia e lartë e erës, shkëmbimi i pamjaftueshëm i ajrit dhe rryma e gabuar e ajrit kanë një efekt jashtëzakonisht negativ në shëndetin e viçat.



Fig 1: Marrja e një tamponi nazal në fazën fillestare të sëmundjes për të demonstruar një proces akut infeksioni.




Fig 2: Viç me rrjedhje mukopurulente nga hunda. Infeksioni sekondar bakterial ka ndodhur.




Fig 3: Rrjedha e pafavorshme e ajrit në një hambar viçash. Shumica e viçave përpiqen të shmangin rrymën e ajrit të ftohtë që vjen nga dritarja.

Cilësia e të ushqyerit është gjithashtu vendimtare. Zëvendësuesi i qumështit i përdorur duhet të jetë i përshtatshëm si për grupmoshën ashtu edhe për regjimin ushqimor.

Kryeni diagnozën e duhur

Simptomat dominuese të sëmundjes bëhen gjithnjë e më të ngjashme me kohëzgjatjen dhe përparimin e sëmundjes, kështu që një diagnozë mund të bëhet vetëm në fillim të sëmundjes duke u bazuar në simptomat klinike. Në princip, të gjitha sëmundjet e traktit respirator mund të zbulohen duke marrë qeliza nga mukoza e hundës duke përdorur një "tampon të gjatë nazal" (Fig 1). Nëse dyshohet për një infeksion ekzistues BVD (bovine viral diarrhe), duhet të merren edhe mostra gjaku.

Një rezultat negativ i testit nuk do të thotë domosdoshmërisht se nuk ka pasur infeksion. Shkalla e zbulimit zvogëlohet me kohëzgjatjen e sëmundjes.

Në rastin e sëmundjeve infektive të listuara këtu, patogjeni primar (virusi) mund të izohet vetëm në fazën fillestare të sëmundjes. Trajtimet paraprake, ndonjëherë ndërhyjnë në zbulimin e patogjenit. Për shkak të infeksionit dytësor bakterial, pas 3–5 ditësh nuk pritet asnjë rezultat pozitiv i testit virologjik.

Meqenëse shumë burime gabimi mund të çojnë në rezultate negative të testit, në këto raste në varësi të rëndësisë së sëmundjes si dhe përhapjen në tufë, rekomandohet që eksaminimet të përsëriten. Nëse patogjeni i dyshuar nuk zbulohet, nuk mund të arrihet kurrë apriori në përfundimin se ai është i parëndësishëm. Luftimi i një sëmundjeje të tufës kërkon bashkëpunimin e fermerëve dhe ekspertëve (veterineri i fermës, konsulentë). Ai konsiston në trajtimin e kafshëve të sëmura, vaksinimet dhe masat shoqëruese.

Masat shoqëruese dhe trajtimi

Përmirësimi i kushteve të rritjes, veçanërisht teknologjia e ventilimit dhe ushqimit në stallë, mund të merren përsipër nga vetë fermeri.

Infeksionet dytësore bakteriale mund të lehtësohen me anë të antibiotikëve. Terapia mbështetëse me antibiotikë duhet t'i japë organizmit të infektuar me virus mundësinë që të mbrohet më mirë me sistemin e tij imunitar dhe të zhvillojë substanca specifike mbrojtëse (antitropa).

Planifikoni siç duhet programet e vaksinimit

Zhvillimi i reaksioneve specifike mbrojtëse kundër infeksioneve virale mund të nxitet nga vaksinimet. Vaksinimet janë të përshtatshme për profilaksi, metafilaksi dhe vaksinimin emergjent. Në rendin e listuar, efektiviteti bie në mënyrë drastike.

Profilaksia (parandalimi) do të thotë që një program vaksinimi kryhet kur kafshët e fermës nuk janë në një gjendje shëndetësore të dyshimtë dhe janë të shëndetshme. Një vaksinim metafilaktik kryhet nëse patogjeni është i pranishëm në tufë, por ende nuk janë vënë re simptoma të sëmundjes. Vaksinimi emergjent kryhet te kafshët e sëmura dhe përdoret vetëm për të kufizuar dëmtimin. Mund të ndalojë përhapjen e infeksionit, por nuk mund të rregullojë efektet e sëmundjes në mushkëri. Vaksinimi zakonisht fillon si një vaksinim emergjent, ku metafilaksia zë vendin e dytë. Fatkeqësisht, vaksinat profilaktike përdoren rrallë.

Vaksinimi kundër infeksioneve virale të rrugëve të frymëmarrjes duhet të fillojë në fund të verës. Vaksinat që fillimisht mund të administrohen në mënyrë intranazale janë me përfitim të madh për viçat. Të gjitha programet e imunizimit kërkojnë dy vaksinime primare dhe mund të nevojitet edhe një dozë përfunduese shtesë.

Programi i saktë i vaksinimit për infeksionet virale duhet të konsultohet ndërmjet fermerit dhe veterinerit të tij.

Luftimi i sëmundjeve infektive të frymëmarrjes kërkon një vlerësim kritik të kushteve të stallës dhe marrjen e mostrave me qëllim zbulimin e patogjenëve. Programi i kontrollit në fermë bazohet në rezultate dhe konsiston në korrigjimin e situatës (veçanërisht të klimës në stallë) dhe masave specifike të vaksinimit. Programet e vaksinimit si masë e vetme janë gjithmonë të pakënaqshme në efektivitetin e tyre. Nëse rastet e sëmundjes vazhdojnë të shfaqen edhe pas fillimit të programit të kontrollit, duhet të merren masa të reja diagnostikuese për të kërkuar patogjenë të tjerë.

Tabela 1: Agjentët patogjenë, shkaktarë të kompleksit të gripit të gjedhit

Patogjenë polifaktorial të gripit të gjedhit:
<ul style="list-style-type: none"> • Parainfluenza 3 Virus (PI 3) • Bovines Adenovirus (BAV) • REO-Virus • Rhinovirus 1 dhe 2 • Bovines Coronavirus (BCV)
Patogjenë të pavarur
Sëmundjet:
Synzytial-Virus (BRSV)
<ul style="list-style-type: none"> • Bovines Herpesvirus 1 (BHV 1) • Bovines Virusdiarrhoe-Virus (BVDV)

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al